



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 12, 19 DHE 26 SHTATOR 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 12.,19. I 26. SEPTEMBRA 2013. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012,
5. Shqyrtimi i raportit vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për mbikëqyrjen e buxhetit të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së,
10. Formimi i Komisionit ad hoc për shqyrtimin e aplikacioneve lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së,
11. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.

Dnevni red

1. Vreme za deklaracije izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Radio Televizije Kosova za 2012. godinu,
5. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o stanju u Civilnoj službi Republike Kosova, za 2012. godinu,
6. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Kosovske agencije o statistikama, za 2012. godinu,
7. Razmatranje Izveštaja Komisije za unutrašnje poslove i bezbednost, o nadgledanju budžeta institucija za bezbednost Republike Kosova,
8. Razmatranje Izveštaja Komisije za zdravstvo, rad i socijalno staranje , o nadgledanju sprovođenja Zakona o profesionalnom osposobljavanju i zapošljavanju lica sa ograničenim sposobnostima,
9. Razmatranje Vladine Komisije za privatizaciju 75% akcija PTK-a,
10. Formiranje Ad hok komisije za razmatranje aplikacija za izbor članova Borda RTK-a,
11. Izbor jednog (1) člana Nezavisne komisije za medije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,
Mirë se keni ardhur në seancën e parë plenare të sesionit vjeshtor! Besoj që keni pushuar dhe keni energji pozitive për ta filluar sesionin e ri vjeshtor.

I hap punimet e seancës plenare të sesionit vjeshtor të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare. Vazhdojmë pikën e parë të rendit të ditës.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, diskutimi në emër të grupeve parlamentare 5 minuta, në emër të deputetëve 3 minuta. Fjalën e ka kërkuar deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Pas këtij pushimi, natyrisht që shumë nga ju keni ardhur të relaksuar. Gjithashtu edhe shumë nga qytetarët e Kosovës e kanë pasur rastin të pushojnë dhe të relaksohen, por edhe shumë qytetarë të Kosovës nuk kanë ditur të pushojnë dhe s'kanë pasur agjendë pushimi, një pjesë të burgosur për motive lufte dhe një pjesë me shqetësime për ta pritur shqiptimin e dënimeve dhe të aktgjykimeve të padrejta siç paragjykojnë në opinionin tonë, por edhe te unë personalisht.

Nuk kanë mundur të pushojnë edhe nga shqetësimet, të cilat kanë qenë shumë të padrejta, sepse askush më shumë se ata nuk kanë pasur të drejtë të pushojnë dhe të relaksohen gjatë kësaj kohe të pushimit, por të përfshirë nga një valë e arrestimeve, nga një valë e ngritjes së aktgjykimeve, natyrisht që edhe ata personalisht, edhe familjet e tyre, edhe shokët e bashkëlloftëtarët e tyre nuk kanë mundur të jenë të qetë dhe të bëjnë agjenda pushimi.

Një pjesë e tyre, edhe pse në burg, nuk kanë mundur të pushojnë, sepse ethet e shqetësimet e gjithë atyre shkronjave në letrën e bardhë padrejtësisht ua kanë prishur edhe gjumin, ua kanë prishur edhe qetësinë, ua kanë ndarë edhe kënaqësinë me familjet e tyre, të cilët kush më tepër do ta meritonte të kundërtën.

Gjithashtu, opinionin ynë e di që më datën 17 pritet një aktgjykim për motive lufte i një procesi të përsëritur, të stërpërsëritur, dhe pas një verdikti nga një gjyqtar i shkollës prestigjioze të Anglisë të Britanisë së Madhe, i cili kishte bërë dhe kishte marrë një vendim lirues një herë, por padrejtësisht. Me gjasë, ndoshta edhe do të vërtetohet kjo më 17 në rastin "Kleçka" siç tani quhet nga të akuzuarit, kryesisht nga Malisheva.

Ne si opinion, si qytetarë, edhe si familjarë, presim që më datën 17, drejtësia edhe një herë ta thotë fjalën e vërtetë dhe të saktë, ashtu siç do të duhej dhe ashtu siç pritet.

Unë personalisht nga kjo foltore nuk dua të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Skender Hyseni, në emër të Grupit.

SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës tërheq vërejtjen se në Kosovë po zë fill, ka filluar të zërë rrënjë një sklerozë politike - harresë, dhe një mungesë akute kontinuiteti në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës.

Më ka nxitur ta ngre këtë çështje kërkesa e ripërsëritur. Po them, e ripërsëritur kohëve të fundit nga kryeministri dhe ministri i Jashtëm për zëvendësimin e Rezolutës 1244 dhe për përfundimin e misionit të UNMIK-ut.

Është për keqardhje që ripërsëritet një kërkesë e tillë dhe nuk është insistuar që kërkesa fillestare, e bërë qysh më 2 gusht të vitit 2010, pas mendimit të GJND-së, të materializohej.

Pastaj ka, të nderuar deputetë, një kontradiktë të thellë ndërmjet kërkesës për zëvendësimin e Rezolutës 1244, në njërën anë, dhe betonimit të kësaj rezolute në fusnotën fatkeqe, të cilën LDK-ja vazhdon ta konsiderojë si gabim të madh strategjik, të bërë nga institucionet e Kosovës.

Në fusnotë, kjo rezolutë rivendosur me vullnetin e Kosovës dhe kërkesa menjëherë që kjo të përmbyllet është pak jokontradiktore, por totalisht e dëshmon një mungesë kontinuiteti akut në politikën e jashtme dhe në politikën e Kosovës, në përgjithësi.

Vetë procedurat e anëtarësimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, që do të ishte një hap krejt i natyrshëm, pas mendimit të GJND-së, kërkon që kjo rezolutë të përmbyllet.

Teksti i Rezolutës 1244 nuk përmban asnjë dispozitë sa i përket përfundimit të saj, sepse Këshilli i Sigurimit nuk ka marrë vendim për shfuqizimin e saj.

Prandaj, Kosova duhet të insistojë, në rend të parë, që rezolutën dhe referencën e Rezolutës 1244 në fusnotë ta heqë, sepse kjo është dhe do të vazhdojë të jetë një postbllok gati i pakalueshëm në rrugën e Kosovës edhe drejt anëtarësimit në OKB, edhe drejt një marrëdhënieje kontraktualiteti më të fuqishëm, më të ndjeshëm, më përmbajtjesor me botën.

Në paragrafin 19 të Rezolutës 1244, Këshilli i Sigurimit ka vendosur që prania ndërkombëtare civile dhe e sigurisë në Kosovë të krijohet për një periudhë fillestare, mbajeni në mend, prej 12 muajsh, dhe pastaj mund të vazhdojë derisa Këshilli i Sigurimit të mos vendosë ndryshe.

Këshilli i Sigurimit asnjëherë nuk ka vendosur ndryshe. UNMIK-u vazhdon të operojë në Kosovë, UNMIK-u vazhdon t'i paraqesë raportet periodike në Këshillin e Sigurimit, dhe sërish po e përsëris, ky rol i UNMIK-ut është përforcuar me pranimin që ne me vullnetin tonë i kemi bërë fusnotës dhe referencës që ajo fusnotë e përmban në Rezolutën 1244.

Është e domosdoshme një dispozitë, përkatësisht një rezolutë shfuqizuese e re e Këshillit të Sigurimit për ta përfunduar misionin UNMIK-u. Ju keni me dhjetëra shembuj, misionet e OKB-së në Irak, ta zëmë. Po ashtu kanë filluar me një rezolutë të ngjashme me atë si në Kosovë. Mirëpo, Këshilli i Sigurimit në kohë të caktuar ka aprovuar rezoluta të reja, që i kanë përmbyllur ato misione.

Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës, në vend se të bëjë spektakle publike, pse është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Jo, koha ka kaluar, 5 minuta janë. Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar,
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Ajo që e ka karakterizuar verën që po e lëmë pas ka qenë vazhdimi i negociatave me Serbinë, të cilave nuk po u shihet fundi.

Kompromiset dhe koncesionet që po i bën Qeveria jonë nuk kanë të ndalur. Dhe, Qeveria jonë ka arritur që me Serbinë t'i bëjë të negocueshme madje edhe çështjet më ekskluzive të brendshme, siç është ajo e zgjedhjeve lokale.

Në njërin nga rundet e fundit të negociatave në Bruksel, kryeministri Thaçi u mor vesh me Daçiqin edhe për përdorimin e simboleve të shtetit të Kosovës.

Duke dashur që t'i ikë përgjegjësisë që e ka lidhur me këtë vendim, kryeministri ia hodhi përgjegjësinë KQZ-së, duke thënë se çështja e dukjes së fletëvotimeve i përket këtij institucioni.

Dhe, ashtu që faji i vërtetë të relativizohej edhe më shumë, u tha se puna e fletëvotimeve është çështje dizajni me të cilin merret KQZ-ja.

Nuk ka dyshim se heqja e simboleve shtetërore nga fletëvotimet është sjellë nga Qeveria jonë, pas negociatave me Daçiqin. Ne e dimë që simbolet e Kosovës kanë qenë të imponuara.

E dimë farë mirë që ato nuk e paraqesin siç duhet historinë dhe aspiratën e kombit shqiptar, që e përbën popullin shumicë në Kosovë. Ne e dimë shumë mirë se ato janë prezantuar si kompromis me bashkësinë ndërkombëtare. Por, këta zyrtarë qeveritarë, të cilët kanë bërë madje edhe fushata denigruese dhe propagandë të pashembullt kundër atyre, të cilët kanë qenë kritikë dhe nuk janë pajtuar me simbolet e Kosovës, janë pikërisht këta që po i shesin këto simbole në rastin e parë, kur po u jepet mundësia.

Dhe, mbi kompromisin e parë me bashkësinë ndërkombëtare, tash po ndërtohet një kompromis tjetër shtesë, kësaj radhe me Serbinë.

Pavarësisht nëse kemi apo nuk kemi vërejtje në përmbajtjen e simboleve të Republikës, pavarësisht nëse ato duhet të ndërrohen, gatishmëria e kësaj Qeverie për t'ia bërë qejfin Daçiqit dhe për t'i hequr simbolet shtetërore nga fletëvotimet e zgjedhjeve lokale e përbën një dobësi të madhe të kësaj Qeverie dhe një tregues se deri ku mund të shkojë ajo me lëshime ndaj Serbisë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Më shumë se 70 njerëz, qytetarë të Kosovës, vetëm gjatë këtij viti kanë vdekur nëpër rrugët e Kosovës. Në të njëjtën kohë, më shumë se 70 skandale kanë kërcitur gjatë këtij viti vetëm nga Qeveria e Kosovës.

Të gjitha këto lajme realisht po ndikojnë dhe po vazhdojnë të ndikojnë në humbjen e besimit të qytetarëve për një ditë më të mirë. Në të vërtetë, qeverisja e sotme e Kosovës nuk po përputhet me kërkesat dhe me nevojat e qytetarëve të Kosovës, por po ashtu nuk po përputhet as me kapacitetet dhe me mundësitë që i ka Kosova.

Nëse ndalemi veç te aksidentet e shumta në trafik që kanë ndodhur gjatë këtij viti dhe sidomos gjatë këtyre muajve të fundit, është tepër e qartë se qeverisja nuk ka qenë në krye të detyrës së saj. Jeta e qytetarit të Kosovës është mbi të gjitha dhe kështu duhet të jetë përgjithmonë.

Ne si Aleancë nuk kemi dilema në rëndësinë që duhet t'i kushtohet sigurisë së qytetarit të Kosovës dhe në këtë vazhdë kemi kërkuar një varg veprimesh nga Qeveria e Kosovës për t'i parandaluar vdekjet e shumta që ka ndodhur në trafik në këtë vit dhe realisht ky vit ka qenë i paprecedent në aspektin e numrit të madh të njerëzve që kanë vdekur në trafik nëpër rrugët e Kosovës.

Fatkeqësisht, këto veprime nuk ka ndodhur dhe definitivisht, ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Infrastrukturës duhet që sa më shpejt të raportojnë në Kuvend të Kosovës për atë se çfarë ka ndodhur dhe pse ka ndodhur ky numër kaq i madh i vdekjeve në trafik, i aksidenteve të përgjithshme dhe, definitivisht, vetëm një qeverisje e paimpërsuar nuk merret sot me këtë çështje. Edhe një herë po e them, e kam thanë edhe

në prill të këtij viti në Kuvend, në seancë, Këshilli Kombëtar i Sigurisë në Trafik, për shembull, nuk është mbledhur edhe më tutje. Është jashtëzakonisht e çuditshme se si këto gjëra kanë ndodhur gjatë këtij viti. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua ta ngre shqetësimin tim për telashet që po i përjeton një njeri virtual në përpjekje për ta zbatuar programin edukativo-shkencor të organizuar dhe i cili do të veprojë në katër sesione, ku sesioni i parë është kozmologjia, planatoriumi dhe observatori, demonstrimi se si miqësohet në mënyrë bashkëkohore me mjete audiovizuele.

Planatoriumi e ka një rëndësi të madhe në njohjen e kozmosit nga afër, e jo si deri më tani nëpërmjet imagjinatës.

Përveç kësaj, planatoriumi është edhe si një shans i mirë i zhvillimit të turizmit. Duke qenë i vetmi në Ballkan, do të thithë numër të madh të turistëve.

Këtë mrekulli po e pengojmë vetë ne me sistemin tonë kompleks, në të cilin ky njeri nuk po mund ta gjejë rrugën pothuaj përplot katër vjet që të na afrojë një përvojë të tillë.

Fjala është për profesor doktor Jahja Kokaj, shkencëtar botëror në fushën e fizikës dhe astronomisë, i cili me gjithë përpjekjet që këtë përvojë hyjnore ta përçojë deri te brezat e rinj për t'i dhënë jetës së tyre optimizmin dhe korrigjimin e të menduarit ekzistues negativ, i cili bën të pamundur një zhvillim të gjithëmbarshtëm dhe integrim garues në Evropë apo në globalizimin botëror.

Për ta sensibilizuar këtë çështje, më 23 gusht 2013, në Gjakovë, nën organizimin e Qendrës Edukative Shkencore “Kozmosi dhe Njeriu”, të binjakëzuar me shoqatën e intelektualëve “Jakova”, nën udhëheqjen e kryetarit profesor doktor Jahja Koka, në kuadër të sesionit të katërt, u mbajt tryeza shkencore me temën me titull “Vlerat kozmologjike dhe njerëzore”, me ç’rast në mënyrë shkencore u zbërthe baraspesha mahnitëse ndërmjet kozmosit dhe njeriut.

Vlen të theksohet fakti se kureshtja për një organizim të kësaj natyre u verifikua me pjesëmarrje të shumtë intelektuale.

Unë nga këtu kërkoj ndihmë për vazhdimin e ndërtimit të qendrës “Kozmosi dhe Njeriu” dhe i lus institucionet tona që projekteve që sjellin dije dhe eksperiencë të reja t’u thjeshtësohet rruga deri në realizimin e tyre dhe të rreshtohen si projekte me prioritet. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Milivoje Stojanović.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala predsedniče Skupštine!

Poštovani predsedniče Skupštine,

Članovi vlade,

I poštovani poslanice,

I ako je još daleko do početka zvanične predizborne kampanje, zakazane za lokalne izbore 3. novembra, neke parlamentarne strane su već sada počele kampanju, i moram ka ka-
žem da sam veoma zabrinut sa načinom na koji prilaze svojim biračima.

Proces izbora mora biti najdemokratski čin iznošenja mišljenja kao i izbora predstavnika i političkih opcija, koje će pojedinac da glasa. I niko nema prava da utiče na slobodu volju birača.

U prethodnim danima, svedoci smo početka jedne prljave kampanje, koja se vodi prema nekim političkim subjektima i pojedincima, a koja nažalost dolazi od nekih parlamentarnih stranaka i ljudi koji su najodgovorniji u funkcijama danas na Kosovu.

Kao primer daću samovolju gradonačelnika Parteša, koji je fizički napao Gavрила Ničića iz Pasjana, i kome su nanete teške telesne povrede. Samo zato što je rekao da neće da glasa za SLS. Da tu nije kraj, imamo i dešavanja oko donacije opštine Parteš, koju je dobio Zvonko Kostić iz Donje Budrige, a koju su hteli da mu oduzmu samo za to što neće da glasa za SLS, i zato što želi da se uključi u aktivnosti nekog drugog političkog subjekta.

Zbog svih tih pritisaka opštinskog rukovodstva u opštini Parteš, Zvonko Spasić je napustio svoju kuću i odselio se trenutno u Srbiju.

I na kraju, imamo najnoviji događaj od juče, 11 septembra, kad je napadnut kandidat za gradonačelnika opštine Klokot, Srećko Spasić. Kako saznajmo iz sredstva informisanja, njega su napali članovi SLS, i naneli mu ozbiljne telesne povrede, zbog čega je morao da bude zbrinut u gnjilanskoj bolnici.

Sa ove govornice apelujem na sve političare, na sve političke subjekte, na nadležne organe da proces koji je ispred nas bude transparentan i da omogućimo svim biračima da iskažu slobodnu volju na lokalnim izborima.

A istovremeno pozivam nadležne organe i EULEX da najozbiljnije uzmu u razmatranje žalbe i sve tužbe koji su građani podneli, kako bi se zaustavila...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta.

AGIM KULETA: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Shumica e çështjeve të brendshme të Kosovës, të pazgjidhura e të rëndësishme, janë çështje për të cilat nuk vendoset dot pa Serbinë. Dhe atë, jo në kuptimin e bashkimit të

mendjeve për të arritur zgjidhje më të mira, por në kuptimin e ballafaqimit të interesave në funksion të arritjes së kompromiseve.

Megjithatë, edhe pse mund të duket, kjo nuk është e mjaftueshme për të dëshmuar mungesë pavarësie për Kosovën. Kjo dëshmon diçka tjetër. Dëshmon se Kosova, në fakt, është e pavarur nga Serbia, por e kemi një qeveri të varur tmerrësisht nga ajo.

Dhe, kjo u dëshmua jo më larg se para katër ditësh, kur u arrit marrëveshja për telekomunikacionin. Aq e madhe u tregua etja për ta negociuar me Serbinë edhe këtë çështje të brendshme, sa për ta arritur këtë u shkel pa asnjë hezitim edhe mbi një dokument të Kuvendit të Kosovës, siç është rezoluta, dhe mbi një dokument ndërqeveritar të kësaj fushe, siç është memorandum i bashkëpunimit ndërmjet ministrive përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë.

Prandaj, me këtë rast, unë dua ta denoncoj para jush, të nderuar deputetë, këtë shpërfillje që Ekzekutivi i bën vendimit të organit, pjesë e të cilit jemi të gjithë ne.

Po ashtu, këtë marrëveshje do ta denoncoj edhe për një çështje tjetër. Për legjitimitimin e veprimit ilegal të derisotëm të operatorëve serbë në Kosovë dhe vazhdimin të lejes për operim të mëtutjeshëm. Dhe, kjo nuk është çfarëdo shkelje, të nderuar deputetë! Kjo është shkelje e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht, nenit 119, pika 2, ku thuhet: “Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme”.

Ndërsa, sa i përket përmbajtjes së saj, sipas asnjërit kriter, pra politik apo ekonomik, kjo marrëveshje nuk është më pozitive sesa respektimi i rezolutës për kodin +355.

Në aspektin politik, pra të shpëputjes së Kosovës nga Serbia edhe në këtë fushë, nuk mund të themi se kemi ndryshim të situatës. Thirrjet ndërmjet Kosovës e Serbisë do të konsiderohen si thirrje lokale, ndërsa kufiri ndërmjet palëve konsiderohet administrativ.

Në aspektin ekonomik, shikuar nga dy perspektiva, zgjidhja e bërë është më e papërshtatshme sesa shfrytëzimi i kodit +355. Sipas perspektivës afatshkurtër, humbjet do të vazhdojnë derisa të ndahet kodi për të cilin janë marrë vesh palët, e kjo do të marrë shumë kohë.

Dhe, sipas perspektivës afatgjate, lëvizja e madhe e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë në vendet përkatëse bën që një kod i përbashkët të jetë më i leverdishëm ekonomikisht.

Duke pasur parasysh këto rrethana, në vend se të vazhdohet pa humbur kohë me zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit, ku parashihet shfrytëzimi i kodit +355 nga Kosova, Qeveria e Kosovës e përfshin, pa kurrfarë nevojë, edhe këtë çështje të brendshme në negociata me Serbinë, kur dihet që bazë e marrëveshjes ndërmjet palëve është kompromisi. Dhe, pyetja e pashmangshme këtu është: Çfarë arsye kishte Kosova për një kompromis...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, Agim! Thuaje edhe fjalinë e fundit. Unë kam mirëkuptim për të pavarurit. Vazhdojani fjalën edhe pak!

AGIM KULETA: Dhe, pyetja e pashmangshme këtu është: Çfarë arsye kishte Kosova për një kompromis të tillë me Serbinë, kur e kishte të hapur mundësinë e bashkëpunimit me Republikën e Shqipërisë? Kjo është vërtet paradoksale! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Alma Lama. Ju lutem, respektojeni kohën!

ALMA LAMA: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,
Çështja për të cilën dua të flas sot është konflikti artificial që Qeveria e Kosovës e ka krijuar me shtetin fqinj, Maqedoninë.

Për mendimin tim, ky është kryekëput një konflikt i krijuar për fushatë elektorale për të shitur patriotizëm, e për ta kthyer në vota pastaj këtë patriotizëm, ndërkohë që pasojat e këtij konflikti i vuajnë qytetarët e thjeshtë.

Kemi ministra që për interesa personale janë të gjendje t'i hedhin në erë raportet me fqinjët.

Kjo Qeveri befàs bëhet e ashpër me Shqipërinë dhe me Maqedoninë, ku gjithashtu qeverisin shqiptarët. Por, rri si pulë e lagur në raport me Serbinë, e cila e ka vërshtuar tregun e Kosovës me mallra të subvencionuara, në shkelje të plotë të marrëveshjes së CEFTA-s, e po kështu edhe me mallra të kontrabanduara.

Reciprociteti me Maqedoninë, që po na shitet, nuk është gjë tjetër, veçse reciprocitet elektoral. Ka mundur të bëhet shumë më herët. Masa të tilla nga Qeveria së Kosovës kanë mundur të merren përditë, sepse tregu i Kosovës përditë është vërshtuar nga mallrat të subvencionuara edhe nga Maqedonia.

Por, ky konflikt e ka edhe një dimension tjetër, atë të përplasjes së shqiptarëve në rajon, duke e dhënë mesazhin negativ se ne nuk mund të merremi vesh me njëri-tjetrin. Ama kur vjen puna me Serbinë, me të nënshkruajmë marrëveshje përditë.

Për mendimin tim, nuk është mençuri të krijosh konflikte. Mençuri është t'i zgjidhësh ato. Dhe, zgjidhja nuk mund të bëhet duke u prononcuar nëpër media. Në fakt, në rast se do të kishte pasur vullnet për të zgjidhur një konflikt të tillë ai do të ishte zgjidhur jashtë kamerave dhe jashtë propagandës elektorale.

Çështja e dytë që dua të ngre këtu lidhet me dy ligje që janë shumë-shumë të rëndësishme për dy kategori të shoqërisë: Ligji për skemat pensionale dhe Ligji për viktimat e luftës,

ku përfshihen edhe gratë e dhunuara. Kanë kaluar të gjitha afatet ligjore që ky Kuvend do të duhej t'i kishte miratuar ato.

Unë i bëj thirrje Kuvendit të mos i bllokojë këto projektligje, pasi të dyja kategoritë, gratë e dhunuara gjatë luftës dhe pensionistët, meritojnë një trajtim më dinjitoz nga institucionet shtetërore. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dua t'i uroj të gjithë nxënësit, prindërit dhe Ministrinë e Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor dhe për herë të dytë dua ta adresoj të njëjtin shqetësim timin dhe të shumë prindërve për çantat shkollore të stërngarkuara me libra. Në emrin tim dhe të shumë prindërve tjerë dua ta falënderoj Ministrinë e Arsimit dhe Qeverinë e Kosovës që tani e pesë vjet vazhdon të dhurojë libra falas për nxënësit të shkollave fillore, me çka ka lehtësuar dukshëm buxhetin e shumë familjeve në Kosovë.

Duke ndarë mirënjohjen për shumë veprime të qëlluara të Qeverisë së Kosovës në sferën e arsimit, dua të theksoj shqetësimin tim, por edhe shumë prindërve të tjerë, që ka të bëjë me rritjen e peshës së çantave të fëmijëve shkollorë, e cila nga viti në vit po ngarkohet, po bëhet çdoherë e më e rëndë dhe kjo është një çështje serioze për shëndetin e nxënësve dhe brengë për prindërit dhe mësimdhënësit.

Sipas standardeve të përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, ngarkesa fizike të fëmijët nuk guxon të kalojë 10% të peshës trupore. Si pasojë e mbingarkesave të çantave të nxënësve, po krijohen deformime të shtyllës kurrizore të fëmijët, i njohur si problem shëndetësor 'skoliosis idiopatik'.

Devijimi i shtyllës kurrizore, apo 'skoliosis idiopatik' ose e fituar përbën një problem shëndetësor shqetësues për nxënësit, pasi, sipas disa hulumtimeve të kryera në shkolla, është konstatuar se rreth 40% e nxënësve kanë disbalancë muskulore për shkak të qëndrimit apo posturës së keqe dhe kanë devijime të shtyllës kurrizore për shkak të mbingarkesës së çantave, gjë që paraqet një problem shqetësues për shëndetin e fëmijëve tanë.

Duke ditur se problemet e skoliozës nisen të shfaqen më së shpeshti në moshën 10 deri 15-vjeçare, si prindër, si deputetë dhe profesionistë i kësaj fushe, dua të sensibilizoj në institucione shtetërore, Ministrinë e Arsimit, drejtoritë komunale të arsimit, drejtoritë e shkollave, mësuesit, prindërit për edukimin e fëmijëve që ata të kujdesen për posturën e tyre në vazhdimësi për t'i shmangur problemet e shtyllës kurrizore gjatë rritjes.

Qëllimi është sensibilizimi rreth rritjes së shëndetshme të fëmijëve tanë, që të kemi fëmijë të arsimuar, por edhe të shëndetshëm.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministria e Arsimit, bashkë me drejtoritë e shkollave dhe profesionistët shëndetësorë të kësaj fushe të kësaj fushe duhet ta hartojnë një strategji të përbashkët për ta parandaluar problemet e deformimeve të shtyllës kurrizore te fëmijët. Fillimisht duke bërë ekzaminime të duhura me anë të kontroleve mjekësore, pastaj është i nevojshëm një bashkëpunim i mirëfilltë për preventivë shëndetësore me prindër dhe arsimtarë për edukimin e fëmijëve rreth qëndrimit dhe bartjes së çantave, me qëllim të shmangies dhe deformimit të shtyllës kurrizore.

Është e padiskutueshme që pesha e çantave duhet të revidohet, të jetë më e lehtë. Ministria e Arsimit duhet të mendojë për një planprogram të ri bashkëkohor, një planifikim profesional edukativ, duke u mundësuar nxënësve që një pjesë të librave të mos e bartin në shtëpi, por ta lënë në raftet e klasave, duke e harmonizuar orarin nga mësimdhënësit.

Duke bërë ndërgjegjësimin për rëndësinë e zvogëlimit të peshës së çantës shkollore dhe të qëndruarit që duhet, ne ua kursejmë fëmijëve tanë dhimbje trupore...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Zonja dhe zotërinj,

Më 28 shkurt 2013 është mbajtur debati parlamentar lidhur me kompensimin e pensionistëve të Kosovës për kontributet e dhëna deri në vitin '99.

Debati përfundoi me votimin e rekomandimeve, pa vota kundër, dhe kërkoj nga Qeveria ta formojë në afat dyjavor komisionin profesional, si dhe ta mbledhë dokumentacionin e nevojshëm, të ofrojë këshilla juridike falas për të gjithë pensionistët që kërkojnë kompensim për kontributet e dhëna pensionale, duke iniciuar raste edhe në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në pyetjen parlamentare me shkrim drejtuar ministrit të Punës, e kuptova se komisioni është formuar më 25 mars dhe ka filluar funksionimin më 5 prill.

Gjithashtu u tha se komisioni në fakt mbledh statistika për numrin e pensionistëve, e që ishin 88 901 deri në dhjetor të vitit '98.

Komisioni e përgatit dokumentacionin për organizimin e sistemit pensional deri në vitin '99, pjesa tjetër e përgjigjes ishte identifikimi i bazës ligjore të Federatës së Jugosllavisë, të aplikueshme deri në vitet e '90-ta.

I nderuar ministër,

Unë përsëri ju kam kërkuar informatë lidhur me punën e komisionit, gjë të cilën ende nuk e kam marrë.

Është e qartë se ky komision profesional është duke punuar totalisht diçka tjetër, që ndoshta juve ju duhet për biseda me Serbinë, por në asnjë mënyrë nuk është duke e kryer detyrën, të cilën ia ka dhënë Kuvendi i Kosovës.

Për pensionistët e Kosovës, të cilët nuk marrin pensione nga '99-ta, nuk ka nevojë që ky komision ta zbulojë bazën ligjore, pasi atë bazë ligjore e ka dhënë Gjykata e të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Për shkak se ekziston baza e fuqishme ligjore, Strasburgu e ka obliguar Serbinë ta paguajë çiftin Grudiq dhe ta përgatisë komisionin e vet qeverisës që t'i kthejë pensionet e papaguara për mbi 60 mijë pensionistë kosovarë.

Ky komision qeveritar i Serbisë ka caktuar afate, për ç'gjë kemi tërhequr vëmendjen dhe debati i 28 shkurtit dhe kemi kërkuar urgjencë.

Pensionistët rregullisht kontaktojnë dhe kërkojnë që komisioni dhe Qeveria jonë t'u dalë në ndihmë ashtu siç i ka udhëzuar Kuvendi i Kosovës, e jo të humbë koha e pensionistëve që të zvarriten nëpër dyert e zyrave, t'i paguajnë matrapazët për t'ua nxjerr pensionet dhe me të drejtë u takon, e që me të padrejtë kjo Qeveri po e pengon.

Zoti kryeministër dhe zoti ministër i Punës, kryejeni detyrën tuaj, të cilën jua ka rekomanduar Kuvendi dhe ndihmojini pensionistët tanë që me dinjitet t'i marrin ato që u takojnë me të drejtë, e që Strasburgu, në këtë rast edhe Serbia, ua ka pranuar.

KRYETARI: E përfundojmë pikën e parë të rendit të ditës - Koha për deklarime jashtë rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë janë parashtruar 3 pyetje parlamentare. Pyetja e parë, deputetja Hykmete Bajrami nuk është këtu. Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Kryeministri nuk është këtu, deputete dëshironi ta lexoni pyetjen?

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Me një vendim të kryeministrit zotit Hashim Thaçi është emëruar zonja Jasmina Vasiq zëvendësministre e Forcës së Sigurisë në vend të ish-zëvendësministrit të mëparshëm, Slavisha Filipoviq.

Siç e kam thënë disa herë në këtë Kuvend, Zoti Filipoviq është kapur duke dërguar informacione mbi armatimin e FSK-së në një parti politike në Beograd, gjë që e komprometon figurën e tij. Ky veprim përbën vepër penale të spiunazhit. Është komprometuese për këtë zyrtar, i cili pavarësisht se veprimi i tij është zbuluar në këtë ministri, është bërë edhe publik, ai ka vazhduar të qëndrojë në detyrë për disa muaj me radhë.

Edhe dokumentet që i kanë shkuar Komisionit për Siguri në Kuvendin e Kosovës dëshmojnë se informacionet e dekonspiruara nga ai kanë qenë të një rëndësie të madhe.

Prandaj, pyetja ime për kryeministrin e Kosovës është kjo: Cili është motivi i largimit të zotit Slavisha Filipović nga detyra e zëvendësministrit të FSK-së? A lidhet ky largim me skandalin e spiunazhit që e përmenda më sipër?

KRYETARI: Edhe pyetja tjetër është nga deputetja Alma Lama, për ministrin Enver Hoxhaj. Doni ta bëni pyetjen, deputete?

ALMA LAMA: Si duket, edhe ky ministër po i shmanget përgjegjësisë së mbikëqyrjes parlamentare. Megjithatë, unë do ta bëj pyetjen.

Sipas deklaratave të disa zyrtarëve të ndryshëm të Qeverisë së Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme dhe ajo e Punës po bëjnë përpjekje për të nënshkruar një marrëveshje punësimi sezonal me shtetin e Katarit.

Qeveria e Kosovës, sipas këtyre zyrtarëve, është duke bërë përpjekje maksimale, siç thonë ata, që ta dërgojë kontingjentin e parë të punëtorëve në Katar në fillim të vitit 2014.

Është e qartë se marrëveshja është në procesin e negocimit, së paku është kështu raportuar nga mediet.

Detajet e këtij lloji punësimi nuk janë specifikuar ende dhe më 7 gusht, me kërkesën e ministrit të Jashtëm, zotit Enver Hoxhaj, Kabineti i ministrave e shtyu fillimin e këtyre negociatave me arsyetimin për shkak të nevojës për disa sqarime shtesë.

Prandaj, pyetja ime për ministrin e Jashtëm është kjo: Çfarë përmban draft-marrëveshja e cila po negociohet, cilat do të jenë kushtet e punës për punëtorët e Kosovës dhe cili do të jetë numri i përfituesve të kësaj marrëveshje, nëse nënshkruhet? Për çfarë lloj vende punësh bëhet fjalë? A do të jenë gratë edhe vajzat përfituese dhe çfarë garancish jep shteti i Katarit se do të respektohen të drejtat e punëtorëve nga Kosova?

E bëj këtë pyetje, duke pasur parasysh raportimet e vazhdueshme në lidhje me skllavërinë, e cila aplikohet ende në shtetin e Katarit për punëtorët që vijnë nga vendet e ndryshme të botës.

Prandaj, dua t'i tërheq vëmendjen ministrit të Jashtëm që edhe në rast se nuk vjen herën tjetër, kur unë sërish do ta bëj këtë pyetje, që të mos bëjë marrëveshje, të cilat do t'i çonin punëtorët e Kosovës me duart e tyre drejt skllavërisë. Faleminderit!

KRYETARI: Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit, neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Deputete, ministri i Punës do të përgjigjet. Urdhëro, ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Poštovani zamenici premijera,

Poštovani ministri,

Dame i gospodo,
Narodni poslanici,

Tačno da ta inicijativa je pokrenuta u vezi Katara. To je, podsetiću još jednom, inicijativa koja došla možda pre još godinu ipo dana, kada smo se ja i gospodin ministar rada u Kataru seli, i da je tu jedna ideja došla da je moguće da određeni broj radnika, ukoliko to naravno jeste u skladu sa zahtevima koji su na tržištu radu u Kataru, da budu eventualno angažovani.

Ono što smo do sada uradili samo, samo kažem uslovno rečeno, autorizacija Ministarstva za rad da može da inicira pregovore, po kojima prva runda pregovora da bude u Kataru. Mi još nismo bili u jednu zvanično posetu tamo. Kad budemo otišli prvi put, naravno, sve ono od - šta je njima, koja radna snaga im je eventualno potrebna, i šta bi mogli mi njima da ponudimo, do zakona koji se tiču, koji eventualno mogu da budu zaštita za naše radnika tamo, koje eventualno bi mi mogli da pošaljemo, a mi pre toga analizirali, i zajedno sa Ministarstvom za rad Katara bi uskladili te našu ponudu i tražnju.

Vrlo je bitno da naglasim ovde da absolutno sve ono što ste pročitali u nekim od članaka, to su bili privatne kompanije, koje se sami organizovale, a podstiču vas da možete proveriti da je Albanija uradila isto tako organizovano kao što mi hoćemo preko institucija, i da do sad nisu imali nijedan problem. I vi poverite sami, Albanija do sad nije imala nijedan problem, a radi dosta dobro sa Katarom.

Tako i mi ćemo utvrditi sva pravila, oni će biti garant kao Ministarstvo za rad, a mi se s truge strane ćemo naravno, ukoliko bude došlo do sporazuma, moći da ponudimo radnicima da ukoliko žele, i ukoliko ugovori o radu budu u skladu sa zakonima u Kataru, a takođe i ovde, mi ćemo im onda eventualno preporučiti da mogu da budu angažovani. Ali opet kažem ništa do sad konkretno nije urađeno, osim što je usvojena autorizacija ovlašćena od ministarstvo da može da inicira pregovore.

Verovatno će put do finalizacije biti dug, ali ipak ovo jeste jedan početak koji mislim, po meni, da je dobar, jer ćemo mi nadgledati svaki korak eventualnog pravila sporazuma, i tražićemo garancije od Ministarstva za rad iz Katara da će sve biti absolutno po zakonu. Hvala!

KRYETARI: Deputete, pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Më sa duket Ju dhe Qeveria nuk i keni marrë fare seriozisht raportimet e medieve në lidhje me situatën atje.

Në fakt, shkrimi i fundit që ka dalë dhe të cilit ju po i referoheni është vetëm i fundit. Po të hulumtoni pak më shumë, do të shikoni disa dokumentarë dhe shkrime të ndryshme që ka bërë BBC-ja, për shembull, me vite në lidhje me mënyrën se si disa shtete të Gjirit i trajtojnë punëtorët që vijnë nga vendet e tjera. Në fakt, i trajtojnë si skllevër. Jo vetëm për orët e gjata që i detyrojnë të punojnë, jo vetëm për shfrytëzimin maksimal fizik, por edhe

duke u marrë dokumente, duke i trajtuar në mënyrë krejtësisht jodinjitoze, duke mos i lënë të largohen etj., dhe ky është një realitet, të cilin ju nuk mund ta mohoni, pavarësisht nga dëshira për të punësuar njerëz.

Në fakt, kjo Qeveri duhet të bëjë përpjekje për të hapur vende pune këtu në Kosovë, e jo për t'i degdisur njerëzit, të cilët nuk kanë shumë informacione për vendet që skllavërinë e kanë hequr para 50 vjetësh, si edhe me ligj.

Unë e di që Katari ka bërë disa përpjekje për të dhënë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Čitao sam sigurno mnogo više o tome, jer sam stvarno bio zainteresovan, ali neću da ulazim u rasprave oko toga. Naravno da Kosovo treba da obezbedi uslove za rad ovde, ali u međuvremenu dok ekonomija Kosova ne može da ima kapacitete koji bi mogli da absorvuju ovu našu radnu snagu, mi moramo da nađemo šanse, mi moramo da skrivimo mogućnosti.

Jedno mogu da garantujem, šta god bude, bilo koji pomak, bilo koji korak napred, absolutno će biti u skladu sa zakonima, pre svega Katara, jer smo ih već identifikovali i analizirali, i svaki korak koji budemo mi uradili, absolutne će biti u skladu sa zakonom i zaštitu prava radnika bilo po našim zakonima, bilo po međunarodnim konvencijama, koje sigurno mogu da garantujem.

Probleme su imali oni radnici, koji su otišli svojevolljno, ne na organizovan način kao što mi želimo da uradimo, i kad su se zadesili tamo, naravno da ti špekulanti, ili tih ljudi koji se bave tim stvarima mogu da se ponašaju svima kako god. Zato sam naglasio, garant u ovom slučaju nama za eventualni dogovor je Ministarstvo za rad Katara. To je institucija država, koja će svu odgovornost zaštita radnika da preduzme na sebe. Više od toga stvarno mislim da u ovom slučaju nam i ni treba, ukoliko oni pruezmu maksimalnu odgovornost da će radnici biti tretirani po zakonu. Hvala!

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 25 dhe 31 korrik 2013.

Të pranishëm janë 80 deputetë.

Nëse nuk ka vërejtje, atëherë konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 25 dhe 31 korrik 2013.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012

Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë publike, Qeverisje lokale dhe Media dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Arsim. Urdhëro!

(Ndërhyrje)

Rendi i ditës... Nuk është lajmëruar kurrkush.

(Ndërhyrje)

Unë e kam me shkrim, po kërkesa duhet të vijë nga ju e jo nga unë.

Mirë, fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Kryetar,

Ne i kemi dorëzuar tek ju dy shkresa dhe kryetari i Komisionit për Mbikëqyrje financiare, zoti Ali Sadriu e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar për rend të ditës dhe pikërisht për këtë pikë.

Do të doja që t'ia jepni fjalën zotit Ali Sadriu.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: Unë jam i obliguar, nëse kërkon, përndryshe, unë e kam raportin e komisioneve dhe të dy raportet flasin ndryshe.

Urdhëro, fjalën e ka deputeti Ali Sadriu, në emër të Komisionit dhe të Grupit. Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu, regjia.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Po më habit fakti që thatë se nuk ka kërkesë me shkrim. Unë ju thash kërkesën juve personalisht, para se të fillojë edhe ajo është e vulosur dhe e nënshkruar.

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike propozon që seanca këtë temë ta radhisë në një nga seancat e radhës. Arsyeja është sepse këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me një raport të një viti. Problematika me RTK-n është problematikë e tre vjetëve, që Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, në bashkëpunim edhe me vendimet e Kuvendit, ka pasur një serë komunikimesh me ta.

Për t'u shqyrtuar ky raport do të duhet që të jenë raportet e vitit 2010, 2011 dhe të vitit 2012. Konform kërkesës së Kuvendit që ka nxjerrë vendim dhe Kryesia e Kuvendit më vonë merr edhe një vendim tjetër, ka kërkuar një plan veprimi prej RTK-së. Plan i veprimit ka ardhur, është analizuar në komision, është analizuar edhe në Zyrën e Auditorit Gjeneral. Është mirë që deputetët t'i kenë këto tri dokumente dhe ne propozojmë që seancës së radhës t'i bashkëngjitet një dosje e tërë e kësaj problematike.

Mos të harrojmë, se kemi të bëjmë me një institucion i cili ka problem me pasurinë, nuk e ka të regjistruar, nuk gjenden pajisjet aty ku duhet të jenë. Këto janë vlerësime të auditorit, jo tonat dhe mbi të gjitha, ka problem me pagesat përmes padisë gjyqësore që ia bëjnë operatorët ekonomikë. Meqë Kuvendi është financuesi kryesor, unë do të doja të mos ngutemi, por ta analizojmë në bazë të fakteve dhe dokumentacionit që ekziston.

Dhe, nuk kemi asnjë nguti, që diçka e tillë të mos ndodhë, të shtyhet për seancën e radhës dhe deputetët t'i kenë të gjitha këto dokumente para vetes, para se të marrin çfarëdo vendimi. Faleminderit!

KRYETARI: Për hir të opinionit unë tash dua të them që unë i kam rekomandimet e komisionit dhe kam një kërkesë në emër të komisionit nga kryetari, data është 12.9.2013. Nuk e di nëse vërtetë kjo është kërkesë e Komisionit a e Grupit Parlamentar. Kryetari i komisionit realisht kur të nënshkruajë si kryetar i Komisionit, duhet me qenë vendimi i komisionit.

Unë jam dakord, që çështjet të diskutohen si duhet, po kjo me letra, unë po flas për me letra, është kështu qysh po them unë. Megjithatë, vendimi...

(Ndërhyrje)

Ju lutem, të gjithë e dimë këtë. Unë po flas me letra. Unë si kryetar i Kuvendit, nuk kam të drejtë të nënshkruaj vendime, që janë të seancës pa e pyetur seancën. Edhe kryetarët e komisioneve vendimet duhet të jenë të komisioneve dhe pastaj e vënë firmën dhe flasin në emër të komisioneve.

Në emër të Grupit keni të drejtë të kërkonit dhe urdhëro kryetar Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Unë e thash edhe në fillim, po e përsëris, ne në emrin e Grupit Parlamentar të LDK-së, që ua dhashë edhe me shkrim, kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga kjo seancë, për arsye që i përforcon edhe ato që i tha kryetari i komisionit.

Ne si grup parlamentar kërkojmë, që të hiqet nga rendi i ditës, sepse nuk plotësohen kushtet edhe formale për shqyrtim të një raporti të tillë. Prandaj, kjo është kërkesa e Grupit Parlamentar të LDK-së.

KRYETARI: Unë me letra, me atë që e thamë jam në rregull. Ju keni të drejtë ta bëni si grup dhe është mocioni juaj dhe unë nuk kam gjë kundër, nëse seanca vendos që ta shtyjme për një seancë tjetër ose për një kohë tjetër.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Fjalën e ka Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si grup parlamentar pajtohemi për ta radhitur në një rend dite tjetër këtë pikë të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Nga “Vetëvendosje” - Visar Ymeri, cili është mendimi i Grupit tuaj?

VISAR YMERI: Kryetar,

Edhe ne jemi, dakord që kjo pikë të radhitet në një prej seancave të radhës, pra të mos diskutohet sot, për shkak të mungesës së informatave që i përmendi edhe kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave. Natyrisht që kjo çështje po e tregon dhe po e dëshmon edhe njëherë se sa ka nevojë që i tërë ky institucion, puna e tij, e veçanërisht menaxhimi i financave që e ka bërë RTK-ja përgjatë tre vjetëve, të hetohet në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Unë edhe njëherë po them, s’kam gjë kundër, po realisht raporti i komisionit flet diçka tjetër. Në emër të Aleancës e ka fjalën Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës pajtohet që ky raport të shqyrtohet në seancën e radhës dhe njëkohësisht deputetët të pajisen me më shumë informata shtesë, që janë kërkuar vazhdimisht.

KRYETARI: Mirë, në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh rekomandimet të cilat vijnë nga komisionet parlamentare dhe rekomandimi i kryetarit për mbikëqyrje financiare, prapëseprapë Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re përkrah, që puna e komisioneve parlamentare të kompletohet në bazë të Rregullores së punës dhe të vijë një raport i tillë për RTK-në, kur e dimë se RTK-ja ka shumë probleme, siç u cek edhe më parë.

Ne përkrahim, që të kompletohet i gjithë materiali dhe të vijë në seancën e radhës, kur të vendoset në Kryesinë e Kuvendit.

KRYETARI: Në emër të SLS-së, Sasha Milosavleviq e ka fjalën, kryetari.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!

I mi se takode slažemo da se ova tačka dnevnog reda odloži za neko od narednih sednica. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, Milivoje Stojanović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: I mi smo saglasni da se ova tačka dnevnog reda odloži za neko od sledećih sednica.

KRYETARI: Mirë. Fjalën e ka deputeti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë në cilësinë e kryetarit të Komisionit Funkcional, që në fillim pajtohem me të gjitha grupet parlamentare, që ky raport të jetë më i plotë, por dua të shpjegoj vetëm për hir të opinionit që Komisioni Funkcional e shqyrton raportin e punës, raportin financiar e shqyrton Komisioni për Financa, ndërkaq Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e shqyrton pjesën tjetër të raportit. Dhe, kjo të jetë për të gjitha institucionet e pavarura, sepse për dikë po bëhet njëfarë matje e dyfishtë.

Ne këtë pikë të rendit të ditës e kemi pasur edhe më herët, e kemi shtyrë pikërisht për këtë çështje dhe kjo nuk ka qenë dashur të vijë sot, pa u plotësuar me raportet tjera. Por, mos të harrojmë se të njëjtën ditë kur është shty kjo pikë e rendit të ditës, e kemi pasur raportin e punës të Komisionit të Pavarur të Medieve dhe atë e kemi kaluar si raport pune dhe askush nuk e ka kërkuar raportin financiar ose raportin e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Prandaj, fola me qëllimin e mirë që kjo të bëhet për të gjitha agjencitë e pavarura dhe jo vetëm në mënyrë selektive. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vendimi është i juaji në të gjitha raportet, në tri raportet, ka qenë për miratim dhe diku më 15 korrik 2013. Këto janë raportet e komisioneve.

Kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike Ismet, cila është kërkesa juaj e saktë, se dikush tha për seancën e radhës? Urdhëro! Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Kryetar,

Unë e thash dhe po e përsëris, kërkesa jonë është që të hiqet nga rendi i ditës, të shtyhet dhe të vijë në seancë kur të kompletohet, jo në seancë të radhës, sepse ku e dimë ne që bien apo jo... të shtyhet dhe të silllet në rend të ditës atëherë kur është i kompletuar ajo që po kërkohet edhe nga grupi parlamentar edhe nga komisioni përkatës.

KRYETARI: Do të thotë, mocioni i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike është, që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës dhe të kthehet në seancë, kur të

kompletohet. Sipas kërkesës së grupit parlamentar, votojmë ose votojmë një votim formal.

Kush është për? Mirë, shumica janë.

A ka kundër? Janë nja tri, katër vota, pesë vota kundër. Shumica absolute e heq nga rendi i ditës. Prezentë ishin 82 deputetë me prezencë fizike, 88 me prezencë elektronike. Kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për kur të kompletohet. Por, kërkoj që vërtet komisionet ta kompletojnë sa më shpejtë, ta sjellin në miratim këtë raport.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i raportit vjetor për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012

Raportin vjetor për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Idriz Vehapi për arsyetimin e raportit me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17.7.2013, shqyrtoi raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet raporti vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Arsyetim

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka shqyrtuar raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012 dhe ka vlerësuar se raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Ndonjë komision tjetër s'e ka kërkuar fjalën. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratik e ka fjalën deputetja Xhevahire Izroku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar edhe këtë raport mbi gjendjen e Shërbimit Civil brenda vitit 2012.

Pra, ne si Kuvend brenda gjashtë muajve po shqyrtojmë tri raporte radhazi mbi gjendjen në shërbimin civil. Dhe, duke ditur faktin se brenda muajit maj ne diskutuam dhe aprovuam raportin për vitin 2011, pastaj menjëherë na erdhi edhe për vitin 2012, edhe pse jemi gati në fund të vitit 2013. Por, ne gjithashtu kemi debatuar në këtë Kuvend edhe për rezultatet e monitorimit të zbatimit të ligjit, që dolën nga Komisioni Funkcional. Besoj që gjithë kjo është një gjë e mirë, pasi ne kemi nevojë edhe të punojmë shumë, por edhe të debatojmë shumë, për gjendjen e Shërbimit Civil në vendin tonë.

Administrata Publike është dhe mbetet një arsye shumë e madhe, që të gjitha institucionet të përkushtohen në profesionalizimin dhe përgjegjësitë, që dalin nga ky aparat shumë i rëndësishëm i shtetit.

Ky Kuvend ka nxjerrë ligje që rregullojnë shumë mirë funksionimin e Shërbimit Civil në vend, duke aprovuar Ligjin për Shërbimin Civil, por edhe ligjet tjera, të cilat e bëjnë një pako shumë të rëndësishme për funksionalizimin e Shërbimit Civil në vend, pra Ligjit për pagat, por edhe Ligjin për administratën shtetërore.

Ne po flasim për një gjendje, në të cilën Ministria e Shërbimeve Publike jep një raport të detajuar për Shërbimin Civil gjatë vitit 2012 dhe në këtë drejtim për departamente të cilat i japin një rëndësi të veçantë Shërbimit Civil në vend dhe ndihmojnë që të kemi një ngritje të cilësisë dhe një zhvillim të mëtutjeshëm të Shërbimit Civil. Pra, këtu kemi Departamentin e Administratës së Shërbimit Civil i cili ka një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e Shërbimit Civil, duke pasur obligim hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave, që rregullojnë Shërbimin Civil dhe sistemin e pagave për nëpunësit civilë.

Shërbimi Civil në vend përkrahet edhe nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, ky është një institucion për të cilin edhe si Komision Funkcional jemi duke punuar në bërjen me ligj, pra të këtij institucioni.

Gjatë vitit 2012 në kuadër të përkrahjes së Shërbimit Civil, ky institucion ka realizuar programe të veçanta për nëpunësit e të gjitha kategorive në vend. Krejt kjo për të arritur një ngritje të kapaciteteve dhe zhvilluar trajnime në ata sektorë, që është parë që vendi ynë ka nevojë. Institucioni tjetër, që ka luajtur një rol të fuqishëm mbi Shërbimin Civil është edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Ne e dimë se ky institucion është një kategori kushtetuese dhe në bazë të të dhënave që kemi dhe rezultateve që vijnë, domethënë nga raportet e fundit, shihet që nëpunësit civilë në vend kanë arritur që të krijojnë një besim në këtë institucion të pavarur, pra ankesat dhe numri i rritur i ankesave tregon që nëpunësit civilë e kanë një adresë të qartë dhe të

sigurt ku mund të adresojnë ankesat e tyre në rast të padrejtësive, apo të proceseve të cilat nuk shkojnë mirë.

Sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil ne kemi afërsisht 20 000 nëpunës civilë në vend dhe që janë të ndarë në 4 kategori. Duke ditur faktin se Kosova nuk ka mundur të krijojë krejtësisht një shërbim të ri civil, pra ne edhe trashëgojmë nëpunës të cilët realisht po edhe në pushtetin lokal, po edhe në nivelin qendror kanë një moshë afërsisht afër pensionimit, nuk mund të themi se mund të jemi krejtësisht të kënaqur, pra me arsimimin e nëpunësve civilë në vendin tonë. Afërsisht në bazë të të dhënave që kemi dhe në bazë të raportit, kemi 46% të nëpunësve me arsimim të mesëm, kemi 41% me arsimim superior dhe arsimim të lartë vetëm 10%. Sigurisht, që nuk është një gjendje e cila na kënaq neve përfaqësuesve të këtij Kuvendi, por as institucioneve, mirëpo, kjo është një gjendje reale.

Gjatë vitit 2012, zbatimi i procedurave të legjislacionit të Shërbimit Civil është udhëhequr nga parimi i respektimit të mundësive të barabarta për komunitete dhe gjini.

Po ashtu, sipas këtij raporti, por edhe raporteve tjera, që kemi marrë, shihet se në Shërbimin Civil këtë vit, pra kemi deri këtë vit kemi të punësuar vetëm 86 persona me aftësi të kufizuar dhe ne mendoj që nuk duhet të jemi të kënaqur, pra në këtë drejtim, mirëpo mundësitë e deritanishme kanë qenë të tilla. Sigurisht, që ne si deputetë do të inkurajojmë të gjitha institucionet që në këtë drejtim të punojnë pak më shumë. Ne kemi edhe si kriter por, edhe në rrugën e vështirë të integriteteve, patjetër që duhet të tregojmë një përkushtim edhe më të madh në këtë drejtim.

Po ashtu, në vitin 2012 është arritur progres në çështjen e barazisë gjinore, në favor të gjinisë femërore dhe kjo është një aspekt pozitiv, që e vlerësojmë, kur kemi 500 e mbi të punësuar, pra në favor të gjinisë femërore. Dhe, gjithashtu vlerësojmë edhe përparësinë e të të punësuarve nga komunitetet jo shumicë, që në këtë rast për të punësuarit në vitin 2012 i kemi 23 nëpunës, pra më shumë në favor të komuniteteve jo shumicë.

Viti 2012 shënon progres edhe në zbatimin e dispozitave tjera të legjislacionit për Shërbimin Civil. Vetëm gjatë vitit 2012 IKAP ka trajnuar gjithsej 2327 nëpunës civilë nëpër 104 kurse të trajnimit, të cilat kanë zgjatur gjithsej 280 ditë trajnimi.

Gjatë raportit, por edhe gjatë punëve që kemi parë edhe vetë si deputetë, shihet që niveli lokal ka nevoja shumë më të mëdha për trajnim. Dhe, në këtë drejtim institucionet, Qeveria dhe Ministria së bashku me IKAP ka hartuar programe të veçanta, pra vetëm për nivelin lokal, por në këtë drejtim nuk ka munguar përkushtimi edhe për nëpunësit që punojnë në organe të pavarura, kompani publike, e tjerë.

Shihet që ka pasur një përkushtim të veçantë në aspekt të rekrutimit të nëpunësve civilë në kategoritë e drejtuesve të lartë, ku më shumë kemi lëvizje, pra rekrutime brenda institucionit dhe këtu shihet që përkushtim institucionet kanë pasur që në pozita të larta të vendosen persona të cilët kanë tanimë një përvojë të mirë në drejtim dhe në menaxhim të Shërbimit Civil.

Zëvendësimi i kontratave të punës me akte emërimi ka vazhduar edhe në vitin 2012. Sipas raportit, por edhe raportit të kaluar që kemi pasur mbi monitorimin e ligjit, shihet që afërsisht është në përfundim e sipër, pra shumë pak institucione kanë mbetur, që nuk e kanë realizuar këtë proces shumë të rëndësishëm për nëpunësit civilë, zëvendësimin e kontratave me akte të emërimit.

Institucionet të cilat nuk e kanë realizuar, shihet që kanë marrë vërejtje nga Ministria dhe nuk do t'i përmend me emra, por sigurisht që në vazhdimësi deri në fund të vitit, ne do të kemi raporte të tjera, të cilat presim që të përfundojë ky proces i rëndësishëm, pra zëvendësimi i kontratave të punës me akte emërimi.

Vlerësimi i performansës së nëpunësve civilë - në raport shihet që është një arritshmëri prej 80% e punëve. Pra, nëse me të vërtetë duhet besuar në vërtetësinë e këtij lajmi, është një lajm i mirë nëse kanë arritur që të kenë një performansë kaq pozitive nëpunësit civilë, shihet që është një rezultat pozitiv, nëse është 80% pra është një lajm pozitiv, është një lajm i mirë.

Në bazë të të gjitha të dhënave që kemi për Shërbimin Civil në vitin 2012 në Kosovë, është një lajm pozitiv që ka një zhvillim shumë të mirë dhe ka një motiv që të arrihet më tutje përgjegjësi e lartë në profesionalizimin e nëpunësve civilë në sektorin në administratën shtetërore, por, sigurisht që duhet punë shumë edhe në sfidat, të cilat dalin nga raporti.

Me gjithë këto sfida edhe vërejtjet eventuale, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do të votojë për dhe i jap mbështetjen raportit. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

Të nderuar ministra,

Zëvendësministra,

Të nderuar kolegë,

Edhe ne në Grupin Parlamentar të LDK-së e kemi analizuar raportin mbi gjendjen në Shërbimin Civil dhe brenda raportit vërehet një azhurim më i shpejtë këtë herë i raportit, se sa i raportit paraprak dhe një tentim që nëpërmes aprovimit të strategjisë së ligjeve dhe të akteve nënligjore t'i kontribuohet çështjes.

Por, unë do të flas në tri pika, tri çështje, që nuk i ka adresuar raporti, ngase edhe në raportin e progresit, pastaj edhe në dokumentet e studimit të fizibiliteti, vërehet një ngecje e madhe në administratën shtetërore të Kosovës dhe kërkohet një reformë.

Ndërsa edhe në vetë raportin e Ministrisë dhe të këtij raporti ne as që i shohim ato vizat fillestare, se kah do të shkojë Kosova në ato ndryshime, në ato reformime, për të sanuar në gjendje të rëndë, realisht që është në administratë.

Në rend të parë, familjarizimi dhe politizimi i administratës është aq i madh sa që ajo është shndërruar në një sëmundje të rëndë dhe po e rrezikon në tërësi. Ka kohë që të rinjtë tanë që konkurrojnë nuk shpresojnë kur të vazhdojnë të konkurrojnë edhe nuk fillojnë të lexojnë para se të shkojnë në intervistë, por këqyrin të gjejnë ndonjë lidhje, ngase i kanë humbur shpresat se në ndonjë konkurs do të kërkohet të punësohet më i miri.

Pra, edhe në këtë raport edhe më tutje ne akoma nuk po shohim se cili është roli i Ministrisë në këtë çështje. Ministria nuk është agjenci, ka përgjegjësi dhe duhet ta ushtrojë pra rolin e saj kudo që ndodhin këto fenomene në Kosovë në tërësi.

Edhe tek rekrutimet, ne kemi rastin e aq abuzimeve, aq të mëdha me konkurs dhe është shumë shqetësuese. Kemi tani rastin e fundit, ndoshta në shumë vende në Kosovë, por minimum komunën e Mitrovicës e di, pas shpalljes së konkursit për drejtorë, është anuluar dhe konkurrentëve për drejtorë iu ka thënë, aq sa vota fiton, aq do të përzgjidhesh. Domethënë, tani drejtorët tanë nuk kërkohet që të jenë profesionistë dhe ta menaxhojnë shkollën mirë, por do të shihet se me sa vota të PDK-së ata peshojnë, për të na i edukuar e menaxhuar shkollat tona. Dhe, Ministria nuk duhet të jetë indiferente, kjo do të duhet t'i adresojë këto fenomene primitive dhe shumë shqetësuese.

Edhe sot e kësaj dite Ministria nuk e ka të përpunuar sistemin e të dhënave, pra në sistemin e pagesave. Akoma flitet se do të bëhet sot, do të bëhet nesër dhe unë ju siguroj dhe çuditem se si mund të futen në sistemin e pagesave njerëzit që nuk kanë kaluar nëpër sistemin, pra në konkursin publik.

Bëhen manipulime, veprime, merren me tre muaj, pastaj me konkurs intern punësohen njerëzit, futen në sistem të pagesave, ndërsa Ministria thotë - ne në një të ardhme do t'i bëjmë dosjet veç e veç për secilin të punësuar dhe do ta shikojmë. Dhe, kjo tregon një mungesë vullneteve dhe një kaos në përgjithësi edhe në shumë fusha të tjera të jetës sonë, po edhe këtu në Ministri.

Prandaj, unë do të kisha kërkuar nga ministri që sa më shpejtë të krijohet kjo qendër e të dhënave dhe në detaje, për çdo të punësuar, nëse edhe para dhjetë vjetëve është punësuar, duhet ta ketë dosjen dhe të sigurohet se sipas cilave procedura është punësuar, sipas cilit konkurs publik, bile ato minimumin. Ne nëpër panele nuk mund të ndikojmë, dihet se si punësohet, së paku, ta krijojmë një bazë elementare të rregullsisë.

Ndërsa, është jashtëzakonisht shqetësuese që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës që është domethënë një organ kushtetues e me të cilin ishte dashur Ministria ngushtë të punojë, akoma sot e kësaj dite kemi vendime, diku rreth edhe pse ka rënë ai numër nga 40% diku në 29, rreth 30% vendime të Këshillit të Pavarur nuk mbikëqyren. Dhe, a e di çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë kaos në sistemin tonë shtetëror.

Njerëzit bredhin rrugëve edhe pse i kanë fituar të gjitha lëndët, të gjitha kontestet. Dhe, le të na thotë ministri në cilat raste ka udhëhequr procedurë disiplinore konform ligjit ndaj zyrtarëve që thotë të kam qitur prej pune e s'dua të të kthej në punë. A ka më primitive, a ka më antiligjore, se sa zyrtari i thotë njeriut: - e ke fituar kontestin në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe nuk të kthej në punë? Ka raste që kanë fituar edhe në gjykatë. Prandaj, duhet pritur derisa gjykata ta dënojë një zyrtar dhe ta kthejë dikë në punë, pas nja katër vjetëve, atij t'i shqetësohet familja, t'i shkatërrohet dinjiteti, për ta kthyer në punë.

Prandaj, i nderuar ministër, vetëm nëse thuhet edhe tri raste që janë kthyer në punë, shumë është për këtë shtet, shumë është për këtë vend. Prandaj, ju lutem, ligjin e keni përpara, zbatoheni.

Nuk po flas tani shumë edhe tek ajo që është më se e domosdoshme dhe që diskutohet, do të thotë për performansën, pastaj sistematizimi i vendeve të punës. A di sa është i madh-institucionet e Republikës së Kosovës, që thonë: - kështu na ka lënë UNMIK-u dhe kështu kemi vazhduar.

A duhet ende të themi: "Na ka lënë UNMIK-u me kaç punëtorë, ne s'kemi sistemim të vendit të punës, nuk e dimë vlerën e një vendi të punës, një shërbyesi civil", për t'ia mandatar ato 6 apo 8 orë dhe për ta parë a i duhen këtij institucioni 100 apo 200 të punësuar. E njëjta gjendje është edhe në nivelin lokal. Kemi komuna ku u shërbehet 250 qytetarëve, kemi komuna ku u shërbehet 350 qytetarëve. Ky është dallim shumë i madh, sa që dikush kur merr e analizon komunën e Mitrovicës, për shembull, dhe komunën e Fushë Kosovës, ti ke përshtypje që je në tri shtete, se jo në dy shtete.

Kjo është çështje, që nuk duhet të lejohet, duhet të krijohet një normë. Gjithkund ka norma, duhet të ketë normë edhe në të punësuar e jo numri i të punësuarve në këto pesë vjetët e fundit ka shkuar, kush kënd e ka pas lidhje. Një komunë ka pasur lidhje të forta, i ka fituar 15 të punësuar, ose një Ministri, ose një institucion i pavarur. Dhe, kjo vërtet tepër po na dalin të mira raportet ndërkombëtare, çfarë e kemi gjendjen dhe sa është i vogël vullneti i Ministrisë për t' u marrë me këto. Dhe, Ministria nuk duhet të jetë vëzhgues.

Ministria, de facto duhet të jetë lideri këtyre proceseve, ani pse indirekt disa institucione nuk i përgjigjen si Ministri, mirëpo është Ministria e Administratës Shtetërore, që ka nevojë t'i plotësojë ligjet, e bëjnë plotësimin e ligjeve, po diçka që quhet elementare, institucioni i konkursit, depolitizimi, defamiljarizimi, pastaj performansa, këto janë çështje, që nuk duhet të negociohen me kompetenca ose jo kompetenca.

Votimi ose jo votimi - unë mund të them: ta votojmë formalisht, i mbyllim sytë sikur në shumë gjëra tjera ose të mos e votojmë dhe ministrit t'ia japim një afat duke mos e konsideruar të vetmin përgjegjës dhe të vetmin kompetent për ta ndryshuar këtë gjendje dhe brenda një afati të shkurtër së paku të kish ardhur me një listë të veprimeve të parapara për të thënë, se unë kam një ide, kam një vizion për reformën dhe reforma duhet të shkojë në pikën e parë, pikën e dytë, depolitizimi, kështu është përvoja, luftohet kësisoj, familjarizimi kësisoj, performansa kësisoj, mëditjet që u bënë kërdi, pastaj

pagesat jashtë orarit të punës - shko në Komunë i gjen 200 duke ndenjur, pasdite 10 punojnë, mbyten dhe ia jep edhe dy rroga. Ej, çka është kjo, çka është ky sistem?

Prandaj, edhe një herë unë e përkrah pjesën e parë të veprimeve strategji, ligj, akte nënligjore për të avancuar, mirëpo nëse themi Kosovës i duhet reforma dhe Kosova ka obligim t'i bëjë këto ndryshime pozitive për të demonstruar si shtet se po i konkurren mirëfillti fuqizimit dhe një shërbimit të mirëfilltë civil, unë mendoj se kemi shumëçka për të bërë.

Dhe, tani votimi del formal a ta votoj dhe a të mos e votoj. Unë e di qysh i ndihmoj Kosovës nëse nuk e votoj, prandaj unë po besoj se Grupi Parlamentar i LDK-së me qëllimin më të mirë nuk do ta votojë sot këtë raport, por do t'i japë mundësi në cilëndo seancë të ardhshme pas një raportimi të ministrit, që ta ndryshojë mendimin e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mendoj që keni pasur shumë paqartësi në deklaratimet e juaja, zoti Ferati dhe nuk është mirë që të akuzohet në këtë rast Partia Demokratike për drejtorë, sepse drejtorët i emërojnë drejtoritë e komunave dhe jo Ministria, drejtorët e shkollave. E në të gjitha drejtoritë komunale dhe kryetarët e komunave në këtë rast, janë shndërruar në shefa të drejtorëve të shkollave, të cilët përdoren pastaj edhe në fushatat elektorale, janë shefa të shkollave ose shefa të procesit të votimit. Këto çështje duhet evituar dhe duhet rregulluar me ligj, po them gjithçka që po ngrini dhe po ju apeloj edhe ministrive në këtë rast edhe deputetëve, që vërtet t'i harmonizojmë ligjet dhe të funksionojmë siç duhet edhe në Mitrovicë edhe në Fushë-Kosovë.

(Ndërhyrje: Sadri Ferati:...)

Po, po, e thatë zoti Ferati, në rregull. Zoti Ferati e ke fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit!

Unë plotësisht përputhem me atë që ju dhatë si konstatim në fund e këtë edhe unë e kisha qëllimin dhe unë e thash që përgjegjësia e Ministrisë duhet të jetë gjithëpërfshirëse, pavarësisht se a i përgjigjet direkt apo indirekt. Dhe thash, duke mos e përjashtuar mundësinë edhe në vendet tjera, por së paku për një rast jam dëshmitar, nëse ka edhe raste të tjera edhe më shqetësuese është situata, por ajo që unë po pajtohem, anulimet e konkurseve në disa raste dhe tash në prag dhe jo në mënyrë të ligjshme kur ka përfunduar konkursi dhe thuhet se aq sa vota peshon aq do të jesh konkurrent, kjo është vërtetë nuk duhet të tolerohet.

Nëse ka raste më shumë, siç e thatë ju, edhe më brengosës është problemi dhe unë po pajtohem me juve, që duhet pra të gjithë të bëjmë. Dhe thash, nuk është ministri i vetmi ai i cili duhet, pra të bëjë veprime, por është lideri i këtij procesi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues dhe të nderuar deputetë!

Nuk ka dyshim se Administrata Publike dhe Shërbimi Civil profesional përbëjnë njërën nga hallkat kryesore për mirëfunksionimin e duhur të institucioneve shtetërore.

Prandaj, një analizë e plotë mbi gjendjen në këtë sektor është më se e nevojshme për të krijuar një pasqyrë më adekuate për funksionimin e këtij sektori të organizimit tonë institucional. Por, raporti që po diskutojmë sot paraqet vetëm një përshkrim formal të kësaj sfere dhe si i tillë nuk arrin që t'i adresojë disa nga sfidat kryesore të Shërbimit Civil.

Ky raport tregon fillimisht vetëm për disa nga rregulloret që janë miratuar deri më tani, me qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore, mirëpo nuk ofron të dhëna të detajuara mbi efikasitetin e këtyre rregulloreve. Ndërkohë, dihet se në një raport të mëhershëm që ka bërë Komisioni Parlamentar për Administratë Publike lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit civil, si brengë kryesore ka adresuar çështjen e kolizionit që ekziston ndërmjet akteve nënligjore dhe rregulloreve të kësaj fushe me Ligjin për Shërbimin Civil. Me këtë rast nuk ofrohet asnjë informatë se a ekzistojnë përpjekje për të tejkaluar këtë dualizëm legjislativ.

Ndër vërejtjet kryesore që kanë ekzistuar më pastaj deri më tani lidhur me Administratën Publike është pikërisht se disa nga këto rregullore që janë miratuar kanë krijuar edhe bazën për interferime dhe subjektivizëm politik mbi objektivitetin profesional që duhet ta ketë administrata publike.

Kur është puna te Instituti i Kosovës për Administratë Publike, raporti përpos që përmend ekzistencën e këtij Instituti dhe bazën administrative mbi të cilën ai funksionon, si i tillë nuk ofron asnjë informatë tjetër mbi punën e tij.

E njëjta situatë vlen edhe për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. Në raport vetëm tregohet se ky Këshill është një institucion kushtetues dhe siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që respektojnë Shërbimin Civil, mirëpo siç dihet raportet e këtij këshilli që ky Kuvend i ka miratuar çdo vit, kanë adresuar çështje të ndjeshme për këtë sektor që nga rekrutimi jo objektiv i nëpunësve për këtë sferë e deri tek avancimi hierarkik, proces ky që nuk bëhet sipas meritës e në mënyrë objektive apo edhe moszbatimi i Ligjit për Shërbimin Civil lidhur me zëvendësimin e kontratave të punës në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil me shkresë emërimi apo akte emërimi.

Dhe, ajo që është më kryesore qëndron në moszbatimin e vendimeve të këtij Këshilli nga ana e zyrtarëve të lartë të administratës civile. Pra, mungon të paktën një shpjegim formal, se përse ndodh kjo përplasje.

Çështje tjetër, që përbën majën kulmore të dështimeve në këtë sferë mbetet kualifikimi i të punësuarve në Shërbimin Civil, ku siç dihet ende më se 46% të stafit të kësaj sfere janë vetëm me shkollë të mesme. Dallimet gjinore vazhdojnë të mbeten një sfidë tjetër në këtë drejtim, ku dihet se vetëm 36,2% janë femra nga 63,8%, që janë meshkuj.

Pra, pabarazitë dhe dallimet gjinore në këtë sektor, siç shihet nga këto paraqitje statistikore, janë ende tejet të theksuara dhe me mungesë shprese për përmirësim. Ndonëse raporti thekson se krahasuar me vitin 2011 në vitin 2012 ka përparim në këtë sferë ku është arritur progres në çështjen e barazisë gjinore, mirëpo kur flet tek pjesa e rekrutimit të Shërbimit Civil si nga jashtë ashtu edhe nga brenda, raporti tregon se ky rekrutim për moshën 18 deri në 35 vjet është bërë 14% për meshkuj dhe 9,4% për femra. Pra, edhe në rekrutim ekzistojnë këto dallime.

Ndërkaq, në moshën 35 deri në 50 vjet sa i përket përqindjes janë rekrutuar 25,7% meshkuj dhe vetëm 14,1% femra, kurse për moshën 50 deri në 65 vjet janë rekrutuar 26,8% meshkuj dhe 9,9% femra, statistika këto që tregojnë për një disbalancë të madhe sa u përket çështjeve gjinore dhe që situata nuk po vjen duke u përmirësuar.

Po ashtu, në raport tregohet se si shumë nga institucionet e nivelit qendror nuk e kanë kryer përshkrimin e punës sipas Rregullores në fuqi dhe ajo që është më brengosëse disa nga këto institucione kanë për bosht të veprimtarisë së tyre pikërisht çështjet që kanë të bëjnë me sferën juridike. Këto dështime strukturore të institucioneve qendrore kanë të bëjnë edhe me mos shndërrimin e kontratave të punës në akte emërimi sipas Rregullores në fuqi, transformim ky të cilin janë të obliguar që ta bëjnë.

Një përshkrim tejet formal dhe pa përmbajtje në raport qëndron edhe sa i përket fondit për kuadro. Aty tregohet numerikisht vetëm numri prej 204 veta i stafit të administratës publike, që kanë përfutur ndoshta privilegje të majme nga ky fond, por nuk tregohet se cilët sektorë specifikë kanë përfutur nga ky fond dhe se sa është realizuar me objektivet investimi në këtë sferë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto që u thanë, këtë raport e konsiderojmë ende jo të plotë, gjysmak dhe që nuk ofron informata të duhura për gjendjen në Shërbimin Civil. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu në emër të AAK-së e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Një shërbim civil i pavarur, profesional dhe i qëndrueshëm është garanci e fuqishme e funksionimit të shtetit, pavarësisht rrethanave dhe situatave të ndryshme. Kjo do të duhej të ishte kështu, në realitet është krejt ndryshe.

Raportin të cilin e kemi sot para vetes për ta shqyrtuar e i cili ka ardhur pra brenda vitit kanë ardhur dy raportet edhe për vitin 2011 edhe për vitin 2012. Ky raport gjatë analizës që i kemi bërë ne si grup parlamentar, kemi parë që ka shumë përshkrime, por me gjithat unë do të hyj ta bëj një analizë të të dy raporteve. Çka vërehet që nuk i kontribuon në fakt të gjitha rekomandimet që kanë ardhur nga raportet e progresit për një administratë publike, e cila do të duhej të bënte reforma, këtu ka ndodhur e kundërta.

Pra, unë shoh që është një administratë e politizuar, pikërisht nga Qeveria, normal. Pra, në vitin 2011 ose në raportin e vitit 2011 në total numri i pozitive sipas strukturës organizative është 17 mijë e 968, ndërsa në raportin e vitit 2012 janë 19 mijë e 114 duke ia shtuar edhe 410 nëpunës nga komunat: Zubin-Potok, Leposaviq dhe do të thotë, kjo shifër tregon që nuk flitet për reformë në administratë, por përkundrazi për të punësuar militantë partiakë.

Gjatë monitorimit që i kemi bërë ne si komision Ligjit për Shërbimin Civil kemi hasur në të gjitha, qoftë në nivelin lokal nëpër komuna apo edhe në nivelin qendror, kemi pasur shumë ankesa pikërisht për Ligjin për shërbyes civilë dhe vazhdimisht kam kërkuar dhe po kërkoj edhe tash nga ministri që urgjentisht të bjerë në ndryshim, plotësim-ndryshim Ligjin për shërbyes civil, nga se ligji aktual i cili ka numër enorm të akteve nënligjore e që shumicën e rasteve kemi parë që janë në kundërshtim njëra me tjetrën dhe që ende nuk janë nxjerrë të gjitha rregulloret, nuk e rregullojnë funksionimin e drejt, pikërisht nuk janë në interes të shërbyesve civilë.

Këtë e kemi hasur shumë shpesh dhe po e përmend vetëm një rast. Ligji për shërbyesit civil rregullon thotë, statusin e nëpunësve civilë si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet administrative qendrore dhe komunale, duke përjashtuar kështu kategorinë e nëpunësve publikë të angazhuar në ofrimin e shërbimeve, stafin mësimor i sistemit arsimor, stafin mjekësor i sistemit shëndetësor. Pikërisht te stafi arsimor, pra e përmendi edhe kolegu në fjalën më parë që ne gjatë monitorimit e kemi parë që problemet më të mëdha dalin me drejtorët e shkollave dhe drejtorët e klinikave.

Në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës - Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i trajton drejtorët si shërbyes civilë e në realitet ligji jo. Do të thotë, Këshilli vepron në kundërshtim me ligjin. Në anën tjetër, zgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet me udhëzimin administrativ të nxjerrë nga MASHT-i, që emërohen për mandat të caktuar dhe në qoftë se ata do të ishin shërbyes civilë, sikur që i trajton Këshilli Mbikëqyrës për Shërbimin civil, i trajton si shërbyes civilë, ata nuk do të emëroheshin me mandat të caktuar, pra janë pikërisht është edhe vetë Këshilli që do të duhej të funksiononte në bazë të Ligjit për shërbyes civilë që shpeshherë merr vendime në kundërshtim edhe me ligjin.

Unë flas me fakte, kam shumë fakte. Edhe kësaj radhe vetë komunat janë të hutuara kur bëjnë përzgjedhjen e drejtorëve. Pra, duhet të vijë në plotësim-ndryshim urgjent Ligji për shërbyesit civilë dhe pastaj të dalin edhe ligjet tjera sikurse kishim dje në komision shqyrtimin e Projektligjit për IKAP-in.

Pa ardhur Ligji për shërbyesit civilë në plotësim-ndryshim, unë apeloj që ai ligj mos të vijë në Kuvend fare, sepse nga aty kërkohen shumë rekomandime, që ne veç edhe si seancë i kemi kthyer pas dhe nuk guxojmë të lëshojmë pe për të hyrë, ndoshta interesat e individëve të caktuar, për të mos thënë të politikës ose të partisë në pushtet.

Pra, në këtë raport nuk ka, në fakt miratimi apo mosmiratimi i këtij raporti, sikurse edhe shumë raporteve tjera të institucioneve, nga Kuvendi nuk po sjell asnjë gjë pozitive. A e miratojmë ne sot apo nuk e miratojmë, unë shpeshherë e kam bërë pyetjen dhe e bëj edhe

tash. Ne duhet urgjentisht të mblidhemi- çka do të bëhet me këto institucione kur nuk miratohet raporti nga Kuvendi? Në fakt, e miratojmë apo nuk e miratojmë, nuk ka sjell asnjë gjë pozitive asnjëherë te asnjë institucion dhe nuk do të sjellë as te ky institucion në këtë rast.

Në çdo institucion të Administratës Qendrore dhe komunale, kur është fjala te vlerësimi i rezultateve të punës të nëpunësve civilë, në fund të çdo viti kryhet periodikisht vlerësimi i rezultateve të punës të nëpunësve civilë, me qëllim të rritjes së suksesit të punës.

Në vitin 2011 rezulton në këtë raport pra, se rezultatet e vlerësimit të kryerjes së punës ishin si në vijim: 83,1% plotësisht të kryera, kurse në vitin 2012 rezulton të jetë më i ultë, pra 79,11%. Në vitin 2011, pjesërisht të kryera janë 16,6%, kurse në vitin 2012 në vend se të jetë në rritje vjen në zvogëlim 7,96%, kurse jo të kryera 0,3% në vitin 2011, kurse në vitin 2012 janë 12,93 për qind.

Do të thotë, në këtë rast edhe raporti i komisionit, por edhe rekomandimet e GAP-it që kanë dalë janë që urgjentisht, pra të shkohet në plotësim-ndryshimin e ligjit, thashë për të rregulluar që është ligji bazik, për të rregulluar edhe ligjet e tjera dhe njëkohësisht për të qenë shumë i implementueshëm ky ligj duhet ose të gjitha ligjet në përgjithësi duhet të kenë sa më pak akte nënligjore, për të mos krijuar edhe shumë hapësirë të manipulimeve të njerëzve në pushtet, njëkohësisht edhe të politikës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Koalicioni për Kosovë të Re, zoti Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Gjatë shqyrtimit të këtij raporti, raportit vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ne përshëndesim ministrin për progreset, të cilat e kanë pasur, për të cilat tani nuk duhet që t'i numërojmë. Gjithashtu, Ministria në këtë raport ka paraparë edhe disa sfida, të cilat i ka paraqitur dhe shpresojmë, se do të përmbushen suksesshëm.

Më lejoni pra, që ministrit dhe Ministrisë në përgjithësi dhe fushës t'ua jap disa rekomandime, sugjerime, të cilat edhe këta i kanë, mirëpo vlen shpeshherë që gjërat të përsëriten në mënyrë që të kenë një shkallë më të lartë të seriozitetit apo edhe të fitojnë një nxitje ministri dhe Ministria, që më shpejt të punojnë në këtë drejtim.

Ne dëshirojmë që administrata pra, të pësojë një reformë e cila do të përfshijë një menaxhim më të mirë dhe të ketë ndryshim apo reformë në kuadro. Ne e dimë që rekrutimi në administratë nga paslufta në çfarë forme ka ndodhur dhe e dimë që ka staf politik, staf edhe joprofesional e që këtë staf nuk e ka sjell kjo qeveri por e kanë sjellë edhe qeveritë e kaluara. Pra, në këtë drejtim ne rekomandojmë, që vlerësimet e punës të cilat bëhen në fund vit të jenë më reale dhe ato vlerësime të cilat janë negative të rezultojnë me ndryshim të stafit, sepse ne kështu shënojmë progres në administratën publike dhe jemi në shërbim të qytetarëve në nivel më të lartë. Të rekrutojmë pra staf

profesional, jo politik dhe të respektohen të drejtat e njeriut, ku kemi edhe fakte se shpeshherë apo disa herë ka ndodhur që të mos pranohen njerëz profesional, për shkak të bindjes fetare, respektivisht të femrat të cilat kanë mbajtur mbulesë.

Gjithashtu, sistemi i menaxhimit të informatave të burimeve njerëzore shpresojmë që kjo sfidë e paraqitur të realizohet më shpejtë, sepse e dimë që ky sistem do t'i ndihmojë shumë në menaxhimin e administratës publike, si dhe procedimin e shumë analizave, të cilat më pastaj do të shërbejnë për përmirësim.

Gjithashtu, shpresojmë që edhe Kodi i ri i Etikës për shërbyesit civilë të miratohet sa më parë, sepse e dimë që në mungesë të respektimit të këtij Kodi apo të dispozitave të reja, të cilat edhe do t'i sanksiononin shërbyesit civilë, e ka efektin e vet pra të mirë, i cili do të ngrinte performansën në punë.

Ne jemi dëshmitarë të asaj se shpeshherë shkojmë në zyra të ndryshme dhe shohim se në mes kolegëve ka ngacmime, ka lojëra, provokime dhe ka veshje provokuese që kjo rezulton me atë se stafi aty ka pra nivel të ulët të punës, e cila ndikon në punët të cilat ata duhet t'i kryejnë dhe në sukseset e ministrive apo komunave.

Dhe, për këtë duhet të përfshihen pra sanksionet, të cilat janë shumë rigorozë dhe në këtë mënyrë do të jepen efekt.

Gjithashtu, duhet të zbatohen vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, dhe gjithashtu jemi dakord dhe pajtohem me kolegët të cilët e përmendën edhe më parë se ka raste kur ky Këshill ka nxjerrë edhe vendime të cilat nuk janë në pajtim me ligjet për shkak se ligjet kanë kolizion mes veti dhe në këtë rast ato vendime të cilat janë të qarta dhe pa ndonjë ndërlikim me ligjet tjera të zbatohen në mënyrë drejtpërsëdrejti siç e parasheh edhe ligji.

Ne jemi të informuar pra se ministri dhe stafi i tij janë duke u angazhuar që t'i rregullojnë shumë çështje të ngritura nga ne si deputetë këtu po edhe ato të cilët i kanë evidentuar vetë dhe sigurisht që për këtë duhet kohë, por mbi të gjitha duhet vullnet i përbashkët i të gjithë faktorëve që këtë fushë ta ngremë në nivel sa më të lartë. Ne do ta miratojmë raportin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Padyshim që reformimi i Shërbimit Civil paraqet një element kyç të reformës së Administratës Publike dhe mund të themi në vitin 2009 dhe 2010 Qeveria e Kosovës ka dhënë shumë pritje në këtë drejtim dhe ka filluar një proces esencial të reformës së Administratës Publike jo vetëm me miratimin e legjislacionit të Shërbimit Civil, por edhe me miratimin e një strategjie të reformës së Administratës Publike, ku është parashtruar si

një kërkesë ndërtimi i një Shërbimi Civil profesional, të paanshëm, objektiv dhe në shërbim të qytetarëve.

Esenca e kësaj reforme është që ne kemi profilizuar qartë se çka përbën Shërbimin Civil të Kosovës dhe të nderuar kolegë, nëse ju kujtohet, para miratimit të ligjit, ne kemi pasur rreth 70 000 shërbyes civilë në Republikën e Kosovës. Ideja jonë, sidomos e imja që kam qenë bartës i këtij procesi si ministër dhe në një mënyrë e kam sponsorizuar këtë referomë të Shërbimit Civil ka qenë që të identifikohet qartë çka përmban korpusin e Shërbimit Civil dhe ne kemi arritur që të identifikojmë 20 000 shërbyes civilë për një shtet të ri, siç është Republika e Kosovës.

Të nderuar kolegë, një Shërbim Civil i paanshëm, lojal dhe i devotshëm ndaj shtetit është një standard evropian dhe është një parakusht që Kosova të avancojë në proceset e integritetit evropian, sepse pothuaj se të gjitha raportet e progresit dhe raportet e Bashkimit Evropian në Administratën Publike vendosen si prioritet në kuptimin e përparësive politike.

Do të ndalem në dy momente dhe shfrytëzoj edhe praninë e ministrit që të jap disa sugjerime. Të mos harrojmë, Ministria e Administratës Publike, kur është transformuar nga ish-Ministria e Shërbimeve Publike, është krijuar si një ministri e specializuar e cila krahas punëve tjera si mision primar ka monitorimin e Shërbimit Civil të Kosovës drejt avancimit të standardeve.

E para, duhet ta ndërrojmë filozofinë e Shërbimit Civil në Kosovë. Shërbimi Civil dhe shërbyesit civilë nuk janë transmision shtetëror apo transmision i pushtetit shtetëror, ata janë shërbyes civilë që ofrojnë shërbime publike për qytetarët. Dhe mendoj se ende kemi problem me mentalitetin e së kaluarës ku shërbyesit civilë konsiderohen si transmision i pushtetit shtetëror.

Rekomandimi im i parë për ministrin që është lider i këtij procesi të reformës është që ta mendojë shumë mirë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative, në mënyrë që shërbyesit civilë të zhvillojnë procedura administrative në shërbim të qytetarëve.

Dëshiroj ta qartësoj këtë ide, zoti ministër, sepse edhe ju keni parë praktikën më të mira të shërbyesve civilë jo vetëm në Slloveni, Estoni dhe në vende tjera, esenca është kjo. Në procedura administrative shërbyesit civilë duhet të jenë avokatë të qytetarit, avokatë të atij që i drejtohet shtetit dhe shërbyesit civil për të marrë një shërbim.

Po e zëmë, në qoftë se kërkohet një procedurë administrative, qytetari nuk duhet të obligohet me dhjetëra dokumente, me dhjetëra prova për ta argumentuar çështjen të cilën e kërkon. Tani shteti apo shërbyesi civil duhet të avokojë për të dhe mjafton një qytetar t'i drejtohet shërbyesit civil për një kërkesë administrative dhe vetë zyrtari që zhvillon procedurën administrative, duhet të obligohet që të mbledhë prova në favor të qytetarëve.

Pra, jo qytetari të obligohet me veprime burokratike, me pritje, po shteti në mënyrë të tregojë që është i gatshëm që t'i përgjigjet me kohë kërkesave të qytetarëve për shërbime administrative.

Momenti i dytë, ndërrimi i mentalitetit apo kalimi nga sistemi manual apo manofaktural i menaxhimit të shërbyesve civilë në një sistem të menaxhimit elektronik.

Duhet të uroj Ministrinë e Administratës Publike për përpjekjen e saj për të implementuar strategjinë e qeverisjes elektronike edhe pse ky projekt ka dhënë shpresa shumë më të mëdha për një përparim më të shpejtë. Thjesht ende mentaliteti i shërbyesit civil të Kosovës, mentaliteti i një punëtori në zyre, një punëtori i cili din ta çelë kompjuterin, një punëtori i cili kryesisht zhvillon procedura në formë manuale.

Tendencat evropiane janë që menaxhimi i shërbyesve civilë të jetë elektronik që të dhënat e administratës shtetërore të jenë në platforma digjitale dhe shërbyesit civilë të komunikojnë jo vetëm me qytetarin, por edhe ndërmjet veti përmes menaxhimit elektronik, pra sfidat që ne të bëjmë një balancë të atillë që 70% e punës së shërbyesve civilë dhe e procedurave administrative të zhvillohet në mënyrë elektronike derisa ne të kalojmë plotësisht në një sistem digjital të menaxhimit të shërbyesve civilë.

Marrë në përgjithësi ka vullnet, por duhet të them se edhe ka shumë ngadalësi, sidomos në procesimin e legjislacionit sekondar. Të mos harrojmë, në Konferencën e Donatorëve që tanimë është një konferencë e harruar, një numër i madh i donacioneve jo vetëm në Bankën Botërore, por edhe në projektet e tjera janë dhënë sidomos për shpejtimin e procesit të reformës së Shërbimit Civil dhe mendoj se duhet sa më shpejt të kompletohet procesi i legjislacionit sekondar në mënyrë që korniza ligjore të jetë complete.

Edhe dy momente tjera, zoti ministër është momenti i parë është çështja e IKAP-it dhe momenti i dytë çështja e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil.

Ka qenë i padrejtë hezitimi i Kuvendit që të mos përkrahë ligjin për IKAP-in, sepse neve na duhet Institut i Administratës Publike i aftë që të prodhojë kuadro për nevoja të administratës shtetërore, por sugjestionimi im për ministrin dhe për Ministrinë është që vazhdimisht të monitorojë kualitetin e kurrikulave që i ofron IKAP-i, kualiteti i trajnimeve, sepse nganjëherë ato trajnime bëhen rutinore, monotone dhe nuk janë në trendet më të reja dhe duke mos qenë gjithmonë konkurrent me kurrikula, atëherë shpeshherë mund të kemi edhe përsëritje të programeve të cilat edhe ndoshta nuk janë në trend sa i përket Shërbimit Civil. Kështu që ne duhet të forcojmë Institutin e Administratës Publike, unë kam biseduar me ministrin dhe kam parë edhe vizionin e tij ndoshta për të krijuar një Akademi që do të jetë përgjigje sa i përket nevojave të shtetit për punëtorë dhe për kuadro të Administratës Publike dhe duhet ta forcojmë, sepse ky institut është instituti kryesor që ngre gjithmonë kualitetin dhe performansën e shërbyesve civilë.

Dhe çështja e fundit, të cilën gjithmonë kemi qenë të shqetësuar me raportet e Këshillit të Pavarur të Shërbimit Civil dhe është krejtësisht e pafalshme dhe e pa kuptueshme,

hezitimi i Administratës Shtetërore për t'iu përgjigjur vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Në fakt, ky institucion kushtetues e ka rolin e një gjykate administrative në Kosovë. Ajo nuk është gjykatë klasike administrative çfarë e kanë disa vende tjera, por është një lloj organi i kontrollit të ligjshmërisë së punës së administratës, sidomos kontrollit të funksionimit të Shërbimit Civil dhe zoti ministër, mos hezitoni në mënyrë tabelore të na paraqitni institucionet të cilat nuk i zbatojnë vendimet të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, sepse nëse ato institucione janë të niveleve të larta qeveritare dhe shtetërore atëherë vërtet kjo është shqetësuese, sepse ne jemi shumë të qartë kur kërkojmë respektimin e ligjit nga qytetarët dhe kërkojmë që gjithë qytetarët t'i binden ligjit, por nuk jemi gjithaq parimor kur është në pyetje me vendimet e vet institucioneve kushtetuese sa i përket respektit të ligjeve.

Dhe, përfundimisht, mendoj se raporti duhet të përkrahet, por nuk duhet të stepen përpjekjet për një reformim më të shpejtë të Shërbimit Civil, sepse gjendja e Shërbimit Civil do të reflektojë edhe në kualitetin e raporteve evropiane sa i përket përparimeve që ka arritur Kosova në proceset e reformës së Administratës Publike. Çdo përparim i Kosovës drejt integritimeve evropiane tani po lidhet me Administratën Publike, po lidhet me atë se a kemi një Shërbim Civil të mbrojtur, a kemi një Shërbim Civil që nuk lëkundet pas zgjedhjeve parlamentare, a kemi një Shërbim Civil, i cili edhe në kohë më të rënda të krizës tregon efikasitetin dhe funksionalitetin e shtetit tonë?

Mendoj se në këtë drejtim ne kemi vizione të qarta nëpërmjet këtij legjislacioni të ri, na duhet që vërtet të kemi përditësim ndoshta të strategjisë së reformës së Administratës Publike në mënyrë që ta mbajmë të fokusuar jo vetëm vëmendjen e Qeverisë, por edhe të këtij Parlamenti për rëndësinë që e ka reforma e Shërbimit Civil në përgjegjësinë e demokratizimit të shtetit dhe shoqërisë sonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju ministra,

Lidhja Demokratike e Kosovës nuk e përkrah këtë raport, prandaj edhe do të votojë kundër.

Ne i ftojmë edhe deputetët tjerë që mos të bëhen pjesë e një raporti që nuk e tregon të vërtetën dhe nuk e paraqet realitetin sa i përket gjendjes së Shërbimit Civil në Kosovë, në fakt as nuk tenton që ta bëjë një gjë të tillë.

Ky raport nuk paraqet pra gjendjen e vërtetë, por thjesht vetëm të arriturat sa i përket miratimit të ligjeve dhe kornizës ligjore në përgjithësi, që në fakt kurrë nuk kanë qenë problemi i vërtetë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Problemi i vërtetë, ashtu siç raportohet edhe në raportet e progresit për Kosovën, edhe në Raportin për liberalizmin e vizave, është nepotizmi i skajshëm dhe militantizmi partiak i cili e ka zhytur çdo institucion të Republikës së Kosovës ku nuk respektohet asnjë kriter profesional sa u përket emërimeve apo punësimeve.

Largimet nga puna në kundërshtim me çdo procedurë ligjore, degradimet në pozita në kundërshtim me çdo procedurë ligjore, pastaj emërimet dhe punësimet në kundërshtim me këto procedura, kanë qenë të panumërta gjatë vitit 2012. Dhe ne në qoftë se e miratojmë këtë raport do të thotë se do t'i mbyllim sytë para këtyre shkeljeve të të drejtave të njeriut që u janë bërë qytetarëve të Kosovës, sepse në qoftë se largohesh nga puna në kundërshtim me ligjin, të shkelet e drejta në kryerjen e punës dhe profesionit që mbrohet me Kushtetutën e Kosovës.

Shërbimi Civil sot nuk mund të quhet i tillë, sepse është shndërruar në një shërbim të militantizmit partiak. Kjo siç e thashë, është konfirmuar vite me radhë dhe vite me radhë Komisioni Evropian nuk po sheh progres në këtë fushë, prandaj ne nuk e dimë se çfarë progresi po sheh Ministria e Administrimit Publik apo edhe të tjerët që e përkrahin këtë raport.

Ministria nuk e ka kryer detyrën e vet. Në fakt, ka aprovuar dhe ka heshtur para shumicës së këtyre shkeljeve. Ta marr vetëm një shembull, në rastet kur me ligj shumë qartë parashihet që para se të hapet konkursi i jashtëm, një Ministri e caktuar duhet të hapë konkurs të brendshëm për një pozitë, ministritë e tejkalojnë këtë kërkesë ligjore dhe Ministria e Administratës Publike i miraton këto konkurse përkundër asaj që janë në kundërshtim me ligjin. Pra në fakt ka heshtur para shkeljeve të panumërta.

Një shembull tjetër janë mbi 600 aplikues në Ministrinë e Punëve të Jashtme, të cilët që dy vjet nuk po marrin përgjigje as pozitive e as negative dhe Ministria e Administratës Publike kurrë nuk e ka ngritur zërin për një shkelje të tillë ligjore. Pra, ka shkelje të panumërta, përveç kësaj, siç e dinë të gjithë ende paguhen një numër i njerëzve të cilët fare nuk punojnë dhe nuk jetojnë në Kosovë dhe deri tani Ministria e Administratës Publike nuk është marrë me këtë çështje.

Një çështje tjetër është fondi i kuadrove i cili siç është paraqitur në raport i ka fushat e caktuara me të cilat duhet të fokusohet dhe të marrë njerëz të cilët vërtet mund të kontribuojnë në ato fusha. Lëre që nuk janë respektuar fushat, por nuk janë respektuar as kriteret, sepse njerëz me shkollë të mesme janë futur në fondin e kuadrove, derisa ata me shkollim dhe përvojë të caktuar në atë fushë janë larguar nga ky fond, por në anën tjetër edhe njerëz që ende janë vetëm në punë provuese për tre muaj, futen në fondin e kuadrove. Pra ky mu nuk mund të quhet fond i kuadrove, por është shndërruar në fond të jaranëve të ministrave apo të njerëzve që ua kanë bartur atyre posterët gjatë fushatës së kaluar. Dhe natyrisht është shndërruar në një proces përmes të cilit ministrat thjesht kërkojnë që të fitojnë më shumë vota në zgjedhjet e ardhshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, i cili u përmend nga shumë deputetë, nuk duhet këtu të kritikohet për shkelje të ligjit. Në fakt, shkeljen kryesore po e bëjnë ministritë të cilat nuk po i respektojnë vendimet e këtij Këshilli. U tha edhe më herët që njerëzit po bredhin rrugëve përkundër faktit që në mënyrë kundërligjore janë larguar nga puna apo janë degraduar në pozitë dhe këtë e konfirmon sipas kompetencave që i ka si institucion i

pavarur që i përgjigjet këtij Kuvendi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, mirëpo ministrat pa asnjë arsytim nuk i respektojnë këto vendime.

Për të gjitha këto arsye, Lidhja Demokratike e Kosovës, siç u tha nuk e përkrah këtë raport, sepse ky raport nuk e paraqet realitetin në terren, por para nesh servon një mbulesë të shkeljeve të shumta në Shërbimin Civil dhe nuk e meriton prandaj të përkrahet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Osmani! Unë jam i shqetësuar dhe i skandalizuar nga ajo që e thatë ju. Unë besoj që ju do të duhej t'i drejtoheni edhe Prokurorisë në qoftë se vërtet ka njerëz....

(Ndërhyrje)

...Jo. Unë po them po t'i dija, do të shkoja në prokurori, s'do t'ia jepje detyrë kurrkujt. Në qoftë se ka njerëz që nuk jetojnë në Kosovë dhe paguhet nga buxheti i shtetit, atëherë kjo është shumë shqetësuese...

(Ndërhyrje)

...Unë besoj që do të duhej t'i thoni edhe me emra dhe për të shkuar edhe në Prokurori dhe atë ministër që paguan rroga të tilla duhet shkarkuar, le të jetë kushdo.

(Ndërhyrje)

Po, po. E ka fjalën edhe një herë, Vjosa. Regjia, edhe një herë, ia mundësoni zonjës Vjosa fjalën.

VJOSA OSMANI: Zoti nënkryetar, ekziston një term që ne juristët e dimë shumë mirë që quhet ex officio. Prokuroria ka detyrë zyrtare që të merret me raste të cilat thuhet publikisht. Unë po flas publikisht.

E përmenda shumë mirë rastin e 600 punonjësve në Ministrinë e Punëve të Jashtme që gati çdo ditë, më falni - aplikuesve, jo punonjësve, që gati çdo ditë ka qenë në faqe të para të gazetave. Kjo është shkelje esenciale e ligjit, sepse ata njerëz kanë të drejtë në një përgjigje, qoftë edhe negative. Nuk ka gjë tjetër këtu që i duhet as Prokurorisë e as ministrit të Administratës Publike për të reaguar e as juve si nënkryetar i Kuvendit, në fakt.

KRYESUESI: Ky është detyrim. Por unë e shprehja shqetësimin jo si nënkryetar, por personalisht, unë nëse e di që një njeri merr rrogë, prapë po them dhe s'punon dhe është jashtë Kosove dhe merr pare nga buxheti i Kosovës, unë ia kisha përmendur emrin dhe e kisha çuar në Prokurori. Se Prokuroria nuk mund t'i kontrollojë 2 milionë njerëz, as 17 ministri këtu.

(Ndërhyrje)

Fjalën e ka zoti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur diskutojmë për raportet e shërbyesve civilë vërtet besoj që të gjithë ne do të duhej të brengosemi dhe t'i trajtonim këto raporte me seriozitetin më të madh jo për të bërë politikë me shërbyes civilë, mirëpo për të trajtuar raportet të cilat do të ishin në shërbim të qytetarëve dhe në interesin e drejtpërdrejt të tyre, ngase administrata është hallka kryesore dhe lidhja më e mirë e politikanëve me qytetarin.

Të gjitha qeveritë duan që administrata të jetë efektive dhe në bazë të këtij raporti shihet qartë se edhe tek ne ka nevojë për reformim të administratës me qëllim që ajo të jetë më efektive në shërbim të qytetarëve. Kur dihet se administrata është hallka kyçe mes politikanëve që marrin vendime dhe administratës e cila i vë këto vendime, më gëzon fakti që në këtë raport mbi 51% të shërbyesve civilë janë me arsim të lartë dhe superior, ndërsa ky numër do të duhej të ishte edhe më tutje më i lartë dhe të shkohet në avancimin më të lartë të shërbyesve civilë. Që administrata të jetë efektive dhe e përgjegjshme para qytetarëve duhet një reformim i saj bazuar në ligjshmëri, barazi dhe transparencë.

Në reformimin e administratës ligjshmëria është kyçe, punonjësit e administratës duhet me përpikëri t'i zbatojnë ligjet dhe të gjitha vendimet që ata i nxjerrin duhet të jenë të mbështetura në ligj. Çështje tjetër në reformimin e administratës është barazia, kur punonjësit e administratës trajtojnë një çështje ata përveç se duhet t'i referohen ligjit, ata duhet të gjithë qytetarët t'i trajtojnë njësoj. Edhe kur qytetarët kanë marrë një përgjigje negative për një çështje, ata do ta pranojnë atë më lehtë nëse e dinë se për të njëjtën çështje të gjithë kanë marrë përgjigjen e njëjtë. Transparenca gjithashtu është me rëndësi, sepse qytetarët kanë të drejtë të dinë se kush e ka trajtuar çështjen e tyre, ku është bazuar vendimi dhe të gjitha informacionet e nevojshme për rastin e tyre. Punonjësit e administratës duhet të jenë të paanshëm dhe të pavarur dhe këtu duhet të punojmë të gjithë bashkërisht që kjo të avancohet edhe më tutje.

Edhe sot këtu, por edhe enë të kaluarën ka pasur debate lidhur me politizimin e administratës, kalimit të punonjësve të administratës në politikë, por edhe anasjelltas. Edhe në vende tjera të botës edhe te ne rastet konkrete kanë treguar se kjo nuk sjell ndonjë shqetësim as për personin e as për administratën, por as edhe për politikën.

Gjithsesi në këtë sferë është me rëndësi ndërgjegjësimi i administratës, që ajo të jetë profesionale, që vendimet t'i nxjerr bazuar në ligj, të jenë të barabartë dhe transparente para të gjithë qytetarëve, ndërsa për Qeverinë mbetet punë kontinuele perfeksionimi i administratës duke e vendosur mekanizmin transparent për vlerësimin e performancës së administratës të çdo shërbyesi civil veç e veç.

Gjithsesi mbetet sfidë edhe eliminimi i dukurive negative tek punonjësit e administratës të cilët ka kohë që thirren në emër të politikanëve apo njerëzve autoritativë, por këtu

duhet rritur përgjegjësinë dhe transparencën para qytetarëve dhe gjithsecili shërbyes civil të përgjigjet veç e veç për punën e tij.

Dhe, krejt në fund, dua t'i falënderoj kolegët nga Lidhja Demokratike, të cilët e bënë një autopërkrim të bukur administratës në Komunën e Prishtinës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Në raportin i cili është paraqitur për shërbyesit civilë për vitin 2012 nga ana e Ministrisë së Administratës Publike, në përshkrim të saj na del se kemi të bëjmë do të thotë që Ministria në njëfarë forme ka nxjerr vetëm udhëzimet administrative që janë të obliguar dhe detyruesisht është nga ligji që t'i nxjerrë këto udhëzime, por konsideroj se në shumë institucione të Qeverisë së Kosovës, si në nivelin lokal e po ashtu edhe në nivelin qendror, këto udhëzime administrative dhe ky ligj nuk është kah implementohet.

Unë do të fokusohem kryesisht tek Instituti i Kosovës për Administratën Publike, që është një institucion i cili është themeluar kryesisht në vitin 2013 dhe kryesisht ka pasur të bëjë dhe ka të bëjë me trajnimin e kuadrit për shërbyesit civilë, një institucion i cili ka thithur shumë donacione nga vendet e ndryshme të Evropës dhe po ashtu nga organizatat e fuqishme financiare dhe po ashtu një institucion i cili ka shpenzuar goxha shumë buxhetin e Kosovës duke i trajnuar shërbyesit civilë, sidomos stafin e drejtorëve dhe po ashtu stafin e udhëheqësve të divizioneve, por ajo çka ka ndodhur deri më tani siç shihet mirëfilli në shumë institucione të Qeverisë së Kosovës, po thuaj se me dhjetëra kemi në shumë ministri që shumë drejtorë e po ashtu edhe shumë udhëheqës të divizioneve janë larguar nga vendi i punës pa të drejtë ligjor dhe në mënyrë kundërligjore dhe në anën tjetër Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për shërbyes civilë të Kosovës, i cili bën përpjekje dhe punën e vet në mënyrë krejt të drejtë dhe krejt ligjore, këta punonjës dhe këta drejtorë i kthen në institucione, në anën tjetër ministrat dhe institucionet të cilët janë përgjegjëse edhe pse me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës kërkohet që të kthehen në vendin e punës, këta nuk po kthehen. Dhe prapë se prapë këto i kushtojnë buxhetit të Kosovës, sepse nëse merret dikush në vendin e punës dhe në anën tjetër tjetri i cili ka qenë i punësuar dhe pret vendimin nga gjykata të cilin e kthen në vendin e punës kjo i kushton bukur shumë buxhetit të Kosovës.

Prandaj situatat e tilla të cilët janë duke ndodhur nëpër institucionet e Qeverisë së Kosovës dhe po ashtu në nivelin lokal, janë të papranueshme. Dihet mirëfilli që ne kemi të bëjmë edhe me jo shërbyesit civilë, siç janë punonjësit e arsimit, militantizmi, aktualisht është kah ndodh edhe sot për shkak se nëse nuk je në një subjekt politik të cilin e udhëheq ai kryetar komune, do të thotë ti nuk mund të jesh punëtor i një institucioni.

Prandaj, konsideroj se në Raportin e Progresit është bërë me dije mirëfilli që është njëri prej kushteve dhe është njëri prej kriterëve nga Brukseli që reforma e Administratës Publike, e cila ka filluar që nga viti 2000 – 2003, me të cilën thashë se është dhënë shumë

buxhet, janë shpenzuar shumë para edhe të Buxhetit të Kosovës, edhe donacioni i donatorëve, kjo reformë është kah shkon në mënyrë shumë të ngadalshme.

Prandaj, nëse ne kërkojmë që sa më shpejt këtë kriter dëshirojmë ta plotësojmë dhe njëkohësisht të jemi pjesë e integritit të BE-së, konsideroj se këtu duhet të merret më shumë dhe me seriozitet më të madh Ministria e cila është përgjegjëse dhe njëkohësisht unë konsideroj që këtë Ministri është dashur, pa e nënçmuar ministrin në këtë rast i cili konsideroj se është profesionalist, por është dashur të jetë njëri prej zëvendësministrave, sepse është një prej kushteve dhe një prej kriterëve të cilat kërkohen nga Brukseli që reforma e Administratës Publike duhet të ecë me hapa më të shpejtë, më të sigurt dhe njëkohësisht duke e ndalur nepotizmin, i cili është aktual si në nivelin qendror, po ashtu edhe në nivelin lokal.

Konsideroj që Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, që u tha edhe nga parafolësit, një raport i tillë më tepër është paraqitur në formën kozmetike, një raport i cili vetëm i ka paraqitur udhëzimet administrative dhe nuk ka diçka tjetër. Konsideroj që ne si Grup Parlamentar dhe si Lidhje Demokratike këtë raport nuk do ta miratojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Zoti ministër,

Tashmë u thanë shumëçka edhe nga kolegët e mi, nga Grupi Parlamentar Lidhja Demokratike e Kosovës, por më lejoni të theksoj se këtu kemi të bëjmë me një raport, i cili duhet të paraqesë pasqyrën reale të Shërbimit apo të gjendjes në Shërbimin Civil të Kosovës.

Unë mendoj se si Kuvend dhe si deputetë nuk duhet t'i mbyllim sytë para asaj që ndodh, sepse pasojat janë shumë më të mëdha se sa ne mundohemi këtu t'i miksojmë me çfarëdo raporti apo çfarëdo tendence edhe nga deputetët që i përkasin partisë në pushtet. Kjo, sepse është e dëmshme për vendin, është e dëmshme për shoqërinë në përgjithësi dhe që mund të sjellë edhe regres, jo vetëm progres që kërkohet nga ato që po i quajmë Raporti i Progresit apo nga miqtë ndërkombëtar, por kjo ka tejkaluar në një degradim të jetës shoqërore dhe të shkeljeve të drejtave dhe të individit në përgjithësi.

Këtë kur e them ne e mbështesim në shumë fakte, sepse këtu po jetojmë dhe ne përballemi edhe si deputetë edhe si qytetarë edhe si njerëz publikë me ankesat që i paraqesin qytetarët e vendit tonë, pa ndonjë dallim të theksuar edhe politik. Por dallimet politike dhe tendenca e politizimit të institucioneve ka kaluar skajshmërisht, sidomos në vitin 2012 dhe këtë duhet ta thotë ministri, duhet ta thotë Kuvendi dhe duhet ta thotë Qeveria.

Ka shumë fakte. Vetëm shikoni raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe aty mund t'i shihni institucionet të cilat e kanë shkelur ligjin dhe institucionet të cilat i kanë përjashtuar njerëzit nga puna vetëm pse nuk janë militantë të një subjekti politik, nga ai

resor apo nga ai ministër që e udhëheq atë qeveri, por edhe nga ai kryetar komune, sepse ne po e harrojmë pushtetin lokal i cili skajshmërisht ka kaluar në një privatizim të theksueshëm të kryetarëve të komunave.

Prandaj, ky është një shqetësim i përgjithshëm dhe ne nuk duhet këtu të bëjmë lojë fjalësh, por të kërkojmë rekomandime konkrete, ta ndryshojmë çështjen ndaj Shërbimit Civil në Kosovë jo vetëm legjislativ, sepse legjislativi nuk mungon, sepse ne i kemi vetëm tash në vitin 2012-2013 kur është kërkuar që të kemi aktet e emërimeve, pas akteve të emërimit po e zë vetëm një shembull, Ministria e Tregtisë, e Industrisë ka shpallur konkurs po për të njëjtin njerëz dhe tash janë në proces të gjykatave ku gjykatat e kthejnë pozitivisht në anën e punëtorit po ministria në fjalë e ka privatizuar Ministrinë e Tregtisë e Industrisë dhe domethënë nuk i respekton as vendimet e gjykatave as vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Kjo është një pjesë.

Pjesa e dytë, akoma institucionet më të rëndësishme të vendit vitale janë me ushtrues detyre. Sekretarë permanentë, drejtorë të drejtorive të caktuara, drejtorë të institucioneve shëndetësore që prekin jetën elementare të njeriut. Kush duhet përgjigjur për këto zoti ministër dhe ju Kuvend i nderuar? Prandaj ky është shqetësimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ky është shqetësimi ynë si deputetë.

Ministra të caktuar, ju vetë e përmendët, nënkryetar, se kush merr fonde. Ne kemi serbë që janë të regjistruar, marrin paga dhe jetojnë jashtë Kosove, dhe e dimë. Po ka edhe shqiptarë. Ka edhe ministra që i marrin nga dy-tri paga dhe kurrkush nuk i kontrollon. Domethënë, në mënyrën se si të ndalen dhe ia lejon ligji, ministra, zëvendësministra, domethënë anëtarë të bordeve, këshilla drejtues të universiteteve e të tjerë. Tek tash ne kemi domethënë disa tendenca të përmirësimit apo këto, por këto duhet të bëhen publike. Edhe unë jam për, të bëhen publike, por nuk po funksionon prokuroria, nuk po funksionojnë gjykatat. Skajshmërisht ne kemi arrestime të njerëzve nëpër institucione që janë dhe që duhet të jenë kredibile. Çka ndodh? Cili është reagimi i Qeverisë, cili është reagimi i atyre institucioneve? Prapë vazhdon i njëjti avaz, domethënë i miksimit dhe i mbulimit të këtyre problematikave dhe kush po pëson, po pëson qytetari i vendit. Prandaj, ne nuk kemi nevojë për raporte që ia bëjnë qejfin Kuvendit, deputetëve, por edhe vetë ministrit të caktuar. Kemi nevojë për raporte që janë korrekte, janë parimore dhe që sjellin përmirësim dhe tregojnë performansën e institucioneve të vendit.

Nuk ka neve nevojë të na tregoj performansën Komisioni Evropian apo institucionet kredibile apo njerëz që monitorojnë institucionet publike. Ne duhet të jemi vetë autokritikë dhe të tregojmë qartësisht çka po dëshirojmë dhe ku po dëshiron të arrijë Kosova. Me këtë gjendje në Shërbimin Civil, Shërbimi Civil i Kosovës është shndërruar, është shndërruar të them skajshmërisht në njerëz që vëllai-vëllanë është në gjendje ta denoncojë për hir të një militantizmi apo të ruajtjes së pozitës së vet. Dhe kjo ka ndodhur çdo ditë, kjo ka ndodhur jo vetëm që quhet shkelje elementare e drejtave të njeriut, por ka ndodhur një degradim institucional jo i rritjes së reformës së administratës publike, por një regres në Administratën Publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Pra, ministri e dëshiron fjalën në emër të Qeverisë.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Më së pari dëshiroj t'i falënderoj të gjithë deputetët për sugjerimet dhe propozimet përmbajtjesore, sepse në Administratën Publike ose në çdo shtet ka nevojë të përmirësohet gjendja.

Nga aspekti tjetër, Administrata Publike nuk është përbrenda direktivave evropiane, por duhet të jetë e gatshme t'i zbatojë të gjitha direktivat ose standardet evropiane.

Në këtë aspekt, para disa vjetësh, edhe profesori Bajram, ish ministër ka shpjeguar se janë aprovuar disa ligje themelore, por që tash kur janë bërë disa reforma, por në këtë rast, ky raport është hartuar në bazë të Ligjit të Shërbimit Civil për gjendjen, sipas nenit 6.1 ku nuk thuhet më shumë si duhet së pari të hartohet raporti. Duke u bazuar në këto, unë menjëherë kam kërkuar duke u bazuar edhe në raportin e kaluar edhe në këtë raport, së pari të ndryshohet Ligji i Shërbimit Civil jo vetëm për këtë nen, por edhe për disa nene që të sqarohet situata rreth raportit, çka duhet të raportohet.

Ky raport është raport sipas informatave prej të gjitha institucioneve, ne në Ministri vetëm grumbulluam dhe prezantuam në një mënyrë koncize, por sa është reale ajo varet prej realitetit të institucioneve të cilat kanë dërguar në Ministrinë e Administratës Publike. Por, unë mendoj që me ligjin e ardhshëm duhet ta bëjmë një raportim të obligueshëm për të gjitha institucionet që deri në fund të marsit, shembull, të dërgojnë raporte dhe pikat të cilat duhet t'i dërgojnë.

Tash gjendja në Shërbimin Civil, është vetëm një pjesë e Administratës Publike ose Administratës Shtetërore. Unë nuk desha me këtë raport të dal në Ligjin e Administratës Shtetërore ose në Ligjin e procedurave administrative i cili është në hartim dhe shumë çështje, sidomos raporti i Këshillit të Pavarur dhe Shërbimit Civil ose Ministrisë së Administratës Publike do të rregullohen dhe duhet të rregullohen, sepse në këtë rast, në ministritë ose institucione ekzistojnë, në qoftë se ekzistojnë masa disiplinore Komisioni për Ankesa, më tutje shkohet në Këshillin, pas Këshillit ankuesi i drejtohet gjyqit dhe gjyqi duhet ta zbatojë.

Ndërsa nga ana tjetër, numri i të punësuarve caktohet sipas Ligjit të buxhetit. Ministria e Administratës Publike e jep pëlqimin për organizimin e brendshëm për institucionet qendrore, ndërsa komunat e aprovojnë vetë statutin edhe numrin e të punësuarve, agjencitë e pavarura, gjithashtu, sipas aktit themelor ose sipas ligjit përkatës përcaktohet organizimi i brendshëm.

Ne jemi në fazën e përfundimit të klasifikimeve të vendeve të punës. Nga ana tjetër të gjitha rregulloret, nga Shërbimi Civil, i Administratës Shtetërore dhe pagat e nëpunësve civilë janë aprovuar, por duhet të bëhet zbatimi dhe besojmë se më 1 janar do të fillojë sistemi i ri i pagave, i cili prapë bazohet edhe në projektin e Bankës Botërore sa i përket modernizimit të sektorit publik.

Ndërsa nga ana strategjike, të planeve strategjike për të ardhmen, ne mendojmë që të krijohet një inspektim administrativ që këto vendime edhe të Këshillit, por edhe mangësitë eventuale të evitohen para se të bëhet vendimi nga Këshilli ose nga institucioni tjetër, pra mendohet të krijohet.

Gjithashtu është në procedurë ndryshimi i ligjit. Sot e kam marrë draftin e fundit të Ligjit të Shërbimit Civil dhe besojmë që do ta procedojmë së shpejti. Ligji për institutin e Administratës Publike është proceduar edhe do të kërkohet ngritja e kapaciteteve, por gjithashtu jemi në fazën e aprovimit në Qeveri edhe të Rregullores për trajnime të obligueshme që do të përfshijë të gjitha kategoritë përveç sekretarëve të përgjithshëm.

Nga aspekti i pozitës së sekretarëve të përgjithshëm prapë duhet të qartësohet situata në Ligjin e Shërbimit civil, sepse ka disa mospajtime edhe me ligjet tjera sa i përket edhe shërbimit të jashtëm, sistemit shëndetësor dhe sistemeve tjera, sidomos sistemit të arsimit ose të drejtorëve të shkollave dhe spitaleve.

Ne do të propozojmë edhe trajnimin, siç kam cekur, por gjithashtu edhe bashkëpunimin me organizatat tjera që të përforcojmë gjendjen. Gjithashtu, pas analizave tjera do të plotësohet edhe Ligji për pagat e nëpunësve civilë, por gjithashtu duhet të plotësohet edhe Ligji për Administratën Shtetërore nga aspekti i planifikimeve që institucioneve të mos u ndodhen aprovime jashtë sistemit të unifikuar të Administratës Shtetërore.

Këto janë planifikime, por ky raport është raport i cili del nga Ligji i Shërbimit Civil, janë nga raportet e institucioneve dhe unë jam i mendimit raporti duhet të jetë edhe më përmbajtësor, por gjithashtu mendoj që këto çështje duhet të rregullohen edhe me nenin e Ligjit për shërbimin civil. Unë prapë edhe një herë falënderoj për kontributin dhe të gjitha këto çështje do të mundohemi t'i përfshijmë dhe në ndryshimin e ligjeve, por gjithashtu edhe në dokumentet strategjike tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar për të diskutuar diçka shtesë, zoti Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar, faleminderit!

Sinqerisht nga kjo që e tha ministri, nëse ka qenë 100% bindja jonë që gjendja është keq, ky e ka dyfishuar ose e ka shumëfishuar me përqindje që s'mund edhe ta matësh.

Asnjë gjë që është thënë nga kolegët deputetë, veçmas të LDK-së, asnjë përgjigje të vetmen në problemet që ekzistojnë nuk e tha. Na ka përshkruar edhe një herë se ky ka obligim, një pjesë janë institucione, raporte reale ose jo reale, por pikërisht këtu është problemi. Ky duhet të tregojë, të hulumtojë dhe të punojë që ato që s'janë reale, që ne po themi s'janë reale, që janë të maskuara, t'i demaskojë edhe të marrë masa.

Asnjë të vetmen gjë nuk e ka thënë e cila do të sqaronte për të gjitha ato problematika që u thanë. As pse njerëzit që i kthen Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e nuk kthehen në punë, as pse edhe vendimet gjyqësore që i përmendi përsëri, nuk zbatohen, cilat janë marrë

masat. Asnjë absolutisht, asnjë arsyetim, asnjë shpjegim, asnjë të dhënë nuk e ka dhënë. Dhe vërtet është për keqardhje.

Unë e kuptoj ministër që është dashur ndoshta ju të flisni kësisoj, por nuk e keni thënë të vërtetën se çfarë do të bëhet në këtë drejtim që të luftohen këto dukuri, këto keq menaxhime që ekzistojnë në këto institucione.

Prandaj, jo që duhet votuar kundër, por kjo ta sforcon shumë herë, shumëfish bindjen që jemi shumë keq dhe absolutisht Qeveria jonë, në këtë rast Ministria përkatëse nuk është kah e kryen detyrën dhe për këtë duhet dhënë përgjegjësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që në sallë janë 80 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Faleminderit! Me 36 vota për, 32 kundër, 3 abstenime....

(Ndërhyrje)

Prit tash! Ju të LDK-së jeni kundër, me siguri. 32 janë me elektronikë, plus 2 bëjnë 34. A është ndokush tjetër kundër? Jo.

Për, pa kartelë 2, janë 36. Atëherë nuk e ndryshon gjendjen e votimit. Janë 32 me kartelë, 2 pa kartelë kundër, bëjnë 34 vota.

36 me kartelë dhe 2 pa kartelë, bëjnë 38 vota, kështu që rezultati mbetet i njëjtë përafërsisht.

Prandaj, konstatoj se me 38 vota për, 34 kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin vjetor mbi gjendjen e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012

Raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, zoti Idriz Vehapi, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zoti Vehapi, e keni fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Po ashtu Komisioni FunkSIONAL, në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17.7.2013, e shqyrtoi raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012 dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë rekomandim: Të miratohet raporti vjetor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012.

Arsyetim:

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 17.7.2013 ka shqyrtuar r raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012 dhe vlerësoi se raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 7, paragrafi 2.8 të Ligjit për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i rekomandim miratimin e tij.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të PDK-së, fjalën e ka zonja Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, i cili në Kuvendin e Republikës vjen për herë të parë në këtë format, pas ristrukturimit të tij dhe pas bërjes me një ligj pra të këtij institucioni, Grupi ynë parlamentar e ka vlerësuar se Raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012, vërtet tregon një angazhim shumë serioz për t’i përmbushur detyrat e veta të cilat dalin edhe nga ligji për këtë institucion.

ASK-ja ka hartuar dokumentet me rëndësi strategjike dhe planet vjetore dhe gjatë vitit 2012 ka arritur të përmbushë detyrimet duke e plotësuar pra veten edhe me legjislacion sekondar.

Në raportin e ASK-së, por edhe raportimeve të kryeshefit dhe stafit të tij edhe në Komisionin FunkSIONAL, ne deputetët kemi kuptuar se brenda kësaj periudhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, një rëndësi jashtëzakonisht të madhe gjatë vitit 2012 i ka kushtuar fuqizimit të përkushtimit të bashkëpunimit me organizata vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të ngritjes së një sistemi statistikor bashkëkohor në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe i është kushtuar rëndësi edhe vendosjes së një bashkëpunimi dhe komunikimi të mirëfilltë sa më të mirë pra me shfrytëzuesit e statistikave zyrtare.

Për herë të parë, ASK-ja ka vendosur bashkëpunim dhe komunikim në nivel të takimeve të rregullta me të gjithë donatorët e statistikave zyrtare në vend. Kjo me qëllim të një planifikimi të mirëfilltë dhe jo kaotik për realizimin e projekteve statistikore.

Me gjithë perceptimet tona rreth saktësive që dalin nga informacionet lidhur me të dhënat nga rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare dhe banesave dhe deri te publikimet e shumta të statistikave prodhuese, ky rezultat shihet se gjatë vitit 2012, nga organizatat ndërkombëtare që e kanë monitoruar dhe kanë bashkëpunuar e kanë

përkrahur dhe e përkrahin punën që është bërë gjatë asaj periudhe, pra në Agjencinë e Statistikave të Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 33 të Ligjit për statistikën zyrtare ASK-ja për herë të parë ka zhvilluar aktivitete të prodhimit të statistikave zyrtare, sipas përpunimit të veçantë të tyre që ka qenë një proces i ri dhe shumë sfidues për vendin tonë.

Në këtë drejtim, janë aplikuar standarde ndërkombëtare duke krijuar përvojë të re dhe duke vendosur një bashkëpunim të veçantë me organizatat ndërkombëtare.

Përkushtimi i ngritjes së kapaciteteve brenda në ASK ka qenë një prioritet pra gjatë kësaj periudhe dhe shihet që ka pasur jashtëzakonisht një mbështetje të madhe prej organizatave ndërkombëtare. Dhe unë këtu si deputete e shoh që me të vërtetë nëse nuk kishte pasur një punë dhe përkushtim serioz sigurisht që as organizatat që kanë asistuar brenda aty për të fuqizuar këtë institucion me ngritje të kapaciteteve nuk do të kishin afruar mbështetje. Pra, vlerësoj këtë bashkëpunim dhe e vlerësoj punën serioze të këtij stafi.

Ne po ashtu si Grup Parlamentar e vlerësojmë vizionin e ASK-së për një proces të rëndësishëm të reformimit duke krijuar njësinë e re të politikave, planifikimit, koordinimit dhe komunikimit si dhe duke fuqizuar njësinë e zhvillimit të një teknologjie të re informative për organizimin e punës në proceset e reja të orientuara, që më parë nuk kanë qenë. Pra, ASK edhe më tutje kërkon që të fuqizohet me teknologji të re, megjithatë ka bërë një përparim në këtë drejtim, pasi që ka edhe procese që asnjëherë nuk janë zhvilluar më parë në vendin tonë.

Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare, siç e thash edhe më herët, pra shihet që fuqishëm është ndërtuar në këtë periudhë dhe gjatë kësaj kohe ASK ka qenë e monitoruar dhe e fuqizuar nga institucione ndërkombëtare si EUROSTAT, pastaj nga Zyra e BE-së në Kosovë, nga Banka Botërore, nga DFD, nga SIDA dhe shumë organizata të tjera të cilat po vazhdojnë ta mbështesin zhvillimin e Agjencisë të Statistikave të Kosovës.

Gjatë vitit 2012, ASK ka organizuar dy takime me donatorë në funksion të koordinimit dhe raportimit për paraqitjen e projekteve të reja në vazhdimësi. Donatorët që e kanë përkrahur ASK gjatë viteve të mëhershme, por edhe në vitin 2012, fuqishëm mbeten, pra Bashkësia Evropiane me fondet e saj IPA, por edhe agjencitë e tjera të cilat po ashtu edhe përfaqësues të ambasadave dhe shteteve evropiane që vazhdojnë me mbështetjen e ASK-së.

Gjatë vitit 2012, njësia e IT-së ishte e fokusuar në zhvillimin e softuerëve të ri për nevojat e departamenteve prodhuese të ASK-së në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e ueb-faqes. Pra, këtu kam dëshirë ta jap një kompliment pozitiv në veçanti nga të gjitha agjencitë e tjera, ka mundësi që i gjithë opinioni të marrë informacione të shpejta dhe të sakta për krejt zhvillimet që ndodhin brenda agjencisë, por edhe proceset që përfundohen.

Normalisht se në raportin që e ka dorëzuar në Kuvend, Agjencia e Statistikave të Kosovës ka paraqitur edhe sfida të shumta me të cilat përballlet dhe mendoj që nga këto të dhëna ne kemi mundësi që të gjejmë mundësi për ta përkrahur këtë agjenci, por edhe të gjitha institucionet e tjera.

Sigurisht që mungesa e buxhetit dhe e stafit, pastaj edhe mungesa e një hapësire të mirë fizike, ka pamundësuar për të arritur kualitetin që e do ASK dhe që ne si institucion dhe si Kuvend dëshirojmë për ASK-në.

Ne si Grup Parlamentar e votojmë për dhe unë si deputete dhe kolege e deputetëve që më parë e dëgjova, shpresoj që së paku këtë raport të mos e politizojmë, por ta vlerësojmë profesionalisht, edhe pse jemi në prag të fushatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është radha e grupeve parlamentare. Në emër të LDK-së, zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Pikërisht Lidhja Demokratike e Kosovës, si subjekt opozitar, dëshiron që agjencitë e pavarura të jenë me të vërtetë të pavarura, e jo të politizuara. Fatkeqësisht, unë po theksoj qysh në fillim që edhe tendenca për politizimin e këtij institucioni ka qenë permanente nga Qeveria dhe nga Ministria, e cila, sipas kompetencave të saj, ka qenë e obligueshme që ta përgatisë bazën ligjore për funksionim të drejtë dhe ligjor të këtij institucioni.

Unë theksoj se raporti vjetor, i paraqitur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, është me një standard ndryshe dhe me këtë pajtohem, por po i tregoj deputetes nga pozita, Xhevahire Izmaqi, se pikërisht në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, ajo e ka vlerësuar punën e kësaj agjencie si të pavlerë. Domethënë është deklarata publike në mbledhjen e Qeverisë, kur është miratuar raporti vjetor, dhe tash lind pyetja se kush tenton ta vlerësojë në mënyrë të njëanshme, apo ta vlerësojë punën dhe efikasitetin e kësaj agjencie, e cila duhet të jetë me të vërtetë në shërbim të interesave të qytetarëve dhe të institucioneve publike të vendi.

Por, kolegë deputetë, Grupi Parlamentar i ka shqetësimet që kanë të bëjnë me ndërhyrjet politike në këtë institucion dhe vërejtjet tona kanë të bëjnë me shumë çështje specifike dhe që deri vonë me statistika jekomplete e të pabazuara, sidomos në statistikat ekonomike dhe llogaritë kombëtare, manipulimi me GDP-në ka qenë i vazhdueshëm për interesat e Qeverisë.

E dyta, statistikat sociale, të shtyrë sigurisht, po e them dhe një herë, nga Qeveria që të paraqesë gjendje tjetër nga ajo që është në Kosovë, sidomos te varfëria, te papunësia, te standardet e pumës, jo vetëm që nuk korrespondojnë me realitetin, por shkaktojnë edhe huti dhe regres në zgjedhjen e këtyre problemeve. Ka edhe shumë elemente që Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka identifikuar dhe dëshiron të ketë qasje ndryshe, sidomos të gjithë jemi koshientë ndaj regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare, te statistikat e bujqësisë dhe të gjitha statistikat tjera që kanë të bëjnë me standardin e jetës në Kosovë dhe zhvillimin ekonomik. Andaj, ne si Grup Parlamentar,

nuk ia japim votën pro këtij raporti, por dëshirojmë që vërejtjet tona të merren seriozisht, të kemi statistika adekuate profesionale, e jo statistika politike të interesave grupore dhe klanore. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, zonja Izmaku!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Edhe një herë i kthehem fuqishëm fjalës sime dhe mbrojtjes së raportit. Kolegu im Zemaj thekson se Agjencia e Statistikave ka pasur vërejtje nga Qeveria. Unë e marr shumë normale dhe shumë të pranueshme, e do të ishte jonormale nëse të gjitha raportet në Qeveri kalojnë pa vërejtje nga të gjithë ministrat. Pra, sigurisht në frymën e rritjes së performansës ka mundur të ketë vërejtje, mirëpo unë po thirrrem në raport dhe në mbështetjen e organizatave që kanë një pedigree të lartë në sferën e statistikave ndërkombëtare. Mendoj se sikur ta kishim parë një joseriozitet, sigurisht që ato do të ishin tërhequr dhe në këtë drejtim të ftoj ty edhe një herë ta lexosh raportin, i nderuar koleg Zemaj.

KRYESUESI: Zoti Zemaj, kundër-replikë!

ARMEND ZEMAJ: Ne i lexojmë raportet dhe i lexojmë realisht, jo për hir të interesave grupore dhe klanore. Ju pozitivë e parespektuar, vetëm brenda tre vjetëve të fundit e keni ndërruar kryeshefin e agjencisë, tre-katër kryeshefa, kur ka ardhur Fatmir Limaj, kur ka ardhur Yagcilari, kur ka ardhur Hashim Thaçi, domethënë ju keni luajtur me njerëz dhe me këtë institucion. Prandaj kjo është brenga e Lidhjes Demokratike e Kosovës. Andaj ne nuk kemi fakte tjera përpos këto çka po i themi publike dhe nuk e di ndryshe si është ndërhyrje në një institucion, kur ju aty ndërhyjnë çdo ditë. Domethënë ju keni punësuar njerëz pa kurrfarë kriteri, pa kurrfarë ligji dhe vazhdoni ta atakoni këtë institucion publik.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Nuk ka dyshim se zhvillimi i shoqërive komplekse moderne, si dhe i shteteve që i qeverisin ato, e bën të domosdoshëm përdorimin e statistikave për ta kuptuar gjendjen reale në atë shtet. Madje nuk është e rastësishme që edhe vet mocioni ‘statistika’ derivohet nga mocioni shtet, që rrjedh nga gjuha italiane, fakt ky që tregon për ndërlidhshmërinë kruciale që ekziston ndërmjet këtyre dy sferave, sepse janë statistikatat ato që i njësojnë forcat përkatëse që veprojnë në atë shtet dhe si të tilla tregojnë potencën e atij shteti në raport me vetveten dhe shtetet tjera, në një ambient konkurrencial brenda një konjunktore të caktuar.

Prandaj, në këtë kontest duhet vlerësuar edhe raportin e parë vjetor të Agjencisë të Statistikave të Kosovës, të cilin aktualisht po e diskutojmë, por ky raport na vjen në formë gjenerale, pasqyron vetëm disa nga aktivitetet kryesore që ky institucion ka realizuar në vitin e kaluar, mirëpo nuk ofron informata më të hollësishme mbi

përmbajtjen e këtyre aktiviteteve në mënyrë që të gjykojmë në mënyrë më të duhur lidhur me punën e agjencisë.

Në kuadër të veprimtarive, përmendet partneriteti ndërmjet agjencisë dhe disa institucioneve tjera, si vendore, ashtu edhe ndërkombëtare, por nuk thuhet diçka më shumë për këtë bashkëpunim. Raporti përciptazi tregon për statistikën ekonomike dhe llogaritë kombëtare që janë realizuar, statistikën sociale, statistikën e bujqësisë dhe regjistrimin e bujqësisë. Ndër veprimtaritë kryesore, ky prezantim e përfshin atë të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare, të banesave, duke treguar se vetëm është realizuar ky proces, por pa na treguar më në thellësi se si ka shkuar rrjedha e tij, e ndërkohë dihet se ky regjistrim është shoqëruar me shumë pakënaqësi dhe kritika për mënyrën se si është bërë. Ngase ky proces është dashur ta përcaktojë strukturën reale të popullsisë, bazuar në rëndësinë dhe efektet që ka regjistrimi i popullsisë, konsiderojmë se një proces i regjistrimit të popullsisë duhet ta reflektojë kontestin politik, ekonomik, social dhe historik të Kosovës.

Është thënë se ky proces është bazuar mbi ligjin aktual për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe banesave, mirëpo në të vërtetë ai është bazuar edhe mbi Pakon e Ahtisarit, neni 14, pika 1, ku thuhet se regjistrimi i popullsisë do t'i nënshtrohet vëzhgimit ndërkombëtar dhe se i lejohet Republikës së Serbisë dhe vendeve të tjera përreth ta autorizojnë regjistrimin nëpërmjet një agjencie ndërkombëtare të refugjatëve dhe personave të zhvendosur që dëshirojnë të kthehen në Kosovë. Ky nen pra paraqet një standard të dyfishtë në raport me pjesën tjetër të popullsisë të Kosovës dhe në kundërshtim me Ligjin për regjistrimin e popullsisë. Sipas këtij ligji, në kuadër të popullsisë rezidente janë përfshirë vetëm individët të cilët kanë jetuar në Kosovë për një periudhë kohore më shumë se 12 muaj para ditës së regjistrimit, ndërsa kjo ua ka mohuar të drejtën e regjistrimit si rezidentë të gjithë bashkatdhetarëve tanë, kurse e njëjta nuk vlen edhe për serbët që jetojnë jashtë dhe në Kosovë.

Po ashtu, dihet se së paku në tri vendet e rajonit: Shqipëri, Maqedoni dhe Serbi, regjistrimi është shtyrë derisa EUROSTAT-i ka qenë që ky regjistrim të mbahet në të njëjtën kohë në të gjitha vendet e rajonit, e çuditërisht dhe paradoksalisht vetëm Kosova e patë shprehur gatishmërinë që t'i hyjë këtij procesi pa kurrfarë analize paraprake se përse ndodh kjo shtyrje në vendet e tjera të rajonit.

Çështje tjetër delikate mbetet edhe prezantimi i shifrave të tyre artificiale lidhur me shkallën e papunësisë në Kosovë, pikërisht më 30 prill, një natë para një majit. Është interesat të ceket se kur vjen puna të shpërndajë të dhëna, është e vërtetë se agjencia i publikon ato në faqen e vet zyrtare, plor krahas kësaj i shpërndan ato të dhëna edhe në 380 adresa tjera të institucioneve, agjencive, ambasadave etj., por vetëm Kuvendit të Kosovës nuk ia shpërndan ato. Konsideroj se për hir të seriozitetit, të gjitha këto të dhëna statistikore që i disponon kjo agjenci duhet t'i shpërndahen edhe Kuvendit dhe përfaqësuesve të popullit, në mënyrë që ata t'i disponojnë ato të dhëna, të cilat i analizojnë trendet sociale ekonomike dhe politike në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar raportin në fjalë dhe që në fillim them se edhe ne si grup parlamentar jemi kundër këtij miratimi të këtij raporti. Ky raport është vetëm përshkrues. Unë e kam përendur edhe në komision dhe kam qenë kundër këtij raporti gjatë shqyrtimit për shumë arsye.

Një, për shkak se është vetëm përshkrues dhe nuk paraqet të dhëna të sakta dhe reale, të cilat janë në Kosovë dhe, e dyta, nga sfidat që janë prezantuar, pikërisht në këtë raport del se sfidat dhe përmbajtja e tij janë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Pikërisht edhe gjatë shqyrtimit në komision, pikërisht nga kryeshefi i kësaj agjencie, unë kam kërkuar dhe kam bërë disa pyetje dhe vetë kryeshefi ka thënë se nuk do të përgjigjet në pyetjet që i bëjnë deputetët. Pra, kjo do të thotë se sot, jo vetëm që institucionet janë të varura nga politika 100% , por kemi edhe persona që hezitojnë t'u përgjigjen deputetëve në pyetjet që janë në fushëveprimin e veprimtarisë së agjencive në fjalë. Pra, me një fjalë, jo vetëm që jemi kundër, por bëjmë apel që të punohet shumë më shumë në këtu institucione të pavarura, të cilat qytetarët dëshirojnë t'i shohin të pavarura, por që nuk janë të tilla.

Për ta treguar vetëm edhe një detaj që kjo agjenci, pikërisht Enti i Statistikave të Kosovës është shndërruar në agjenci të statistikave të Kosovës. Gjithashtu, në këtë raport përmendet se kjo agjenci i ka kryer të gjitha obligimet që dalin nga Ligji për shërbyesit civilë, kurse, në anën tjetër, në raportin e shërbyesve civilë, nga institucionet e nivelit qendror, të cilat nuk e kanë kryer shndërrimin e kontratave, që nuk e kanë kryer përshkrimin e punës sipas rregulloreve, figuron edhe Enti i Statistikave të Kosovës. Do të thotë, në shumë institucione përmendet Enti i Statistikave të Kosovës, diku Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Sot pikërisht këto institucione nuk e dinë se është miratuar një ligj dhe Enti i Statistikave është shndërruar në agjenci të statistikave. Pra, shihini dy raporte që flasin për të dhëna të ndryshme, e kjo do të thotë që raportet po bëhen vetëm përshkruese, sa për të thënë për pak minuta dhe nuk bëhet asgjë reale dhe nuk paraqet asgjë reale, nga ajo që në fakt ndodh sot në Kosovë.

Pra, edhe një herë, Grupi ynë Parlamentar e voton kundër dhe bën apel që në krye të këtyre agjencive të jenë njerëzit e përgjegjshëm, njerëzit profesionalë, që ka shumë në Kosovë, e të mos emërohen njerëz kryekëput politikë dhe i sjellin vetëm dëm Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fillim po deklaroj se Grupi ynë Parlamentar do ta miratojë këtë raport, edhe pse i ka vërejtjet e veta. Agjencia e Statistikave të Kosovës është dashur që këtë raport ta sjellë

më të detajuar. Me gjithë punën që e kanë bërë, ne shohim mungesa të statistikave, të të dhënave të tjera dhe sidomos të sfidat të cilat i kanë paraqitur, vonesa në ofrimin e të dhënave administrative nga institucionet relevante, pra duhet të cekën se cilat janë ato, mosrespektimi i Ligjit për statistikën zyrtare nga institucionet e ndryshme, duhet të cekën cilat janë ato.

Pra, edhe një numër tjetër i vërejtjeve të cilat i kemi në këtë raport, e që shpresojmë se agjencia radhëve tjera do të sjellë raport më të detajuar. Për këtë radhë, ne do ta miratojmë raportin. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Selmani, më fal se mendova që nuk je këtu. Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dëshiroj të diskutoj pak për pjesën e raportit që ka të bëjë me statistikën ekonomike dhe llogaritë kombëtare. E kemi pasur rastin që të diskutojmë për këtë problematikë dhe për nivelin e zhvillimit të statistikave gjatë hartimit të strategjisë për integritet evropian dhe atje kemi konstatuar se publikimet dhe hulumtimet statistikore nga fusha ekonomike dhe sidomos në sektorin e llogarive kombëtare nuk janë të mjaftueshme, as për kah sasia, as për kah dinamika, e as për kah përmbajtja.

Ky sektor në Agjencinë e Statistikave të Kosovës duhet të zërë një vend qendror. Por, nëse e analizoni, as për kah numri i të punësuarve nuk u është krijuar hapësira e nevojshme. As për kah struktura e njerëzve. Aty janë 4-5 veta, unë i njoh, dhe udhëheqësi i kësaj njësie dhe dy-tre tjerë janë profesionistë të mirë, janë njerëz të përkushtuar, por nuk kanë kapacitete që t'i absorbojnë të gjitha detyrat, të cilat duhet t'i kryejnë. Unë po habitem që në raport nuk është cekur ky problem. Aty thuhet se janë kryer të gjitha detyrat sipas sektorëve përkatës. Ne kemi konstatuar se pikërisht në këtë sektor ka problem të shumta.

Cilat janë ato? Problemet janë se statistikën e produktit vendor bruto publikohen me vonesë sa i përket metodologjisë së matjes së produktit vendor sipas parimit të prodhimit, sipas sektorëve të prodhimit.

Nëse sot kërkoni ta njihni strukturën e prodhimit të industrisë apo të prodhimit në Kosovë, ju nuk mund të keni të dhëna të statistikës. Nuk e dini sa kontribuon industria ushqimore, sa kontribuojnë sektorët e ndryshëm brenda industrisë dhe çfarë po ndodh me zhvillimin ekonomik të Kosovës me prodhimin vendor. Qeveria shpeshherë thotë se e ka prioritet zhvillimin e prodhimit vendor.

Por, pika e parë për të shndërruar politika të dobishme për zhvillimin e prodhimit vendor është që të ketë statistika, të shihet se sa cili sektor kontribuon. Nuk kemi! Nuk publikohen ato statistika. Edhe kur publikohen, në metodën e prodhimit e kemi vetëm industrinë si tërësi, apo ndërtimi si një sektor i veçantë, por jo përbërësit e saj, siç janë standardet statistikore evropiane. Në qoftë se ne nuk e kemi një prodhim adekuat

statistikor lidhur me sektorët e prodhimit, lidhur me zhvillimet që bëhen atje, lidhur me ndryshimet që ndodhin në ndërkohë, nuk mund të udhëheqim as politika cilësore e as vendore.

Prandaj, të gjitha këto thonë e kemi orientimin për afirmimin prodhimit vendor, e zhvillimin e eksportit e të importit, duket më tepër një retorikë e thjeshtë dhe boshe, sepse po të ishte e përqendruar Qeveria për ta zhvilluar prodhimin, në rend të parë do t'i rregullonte statistikën, se duhet ta di se çfarë po ndodh me prodhimin. Qeveria e Kosovës nuk e di se çfarë po ndodh me prodhimin. Nuk i di sektorët e prodhimit dhe nuk ka hulumtime në këtë drejtim.

Prandaj, unë po apeloj që gjatë shqyrtimit, dhe po habitem që sa lehtë me të vërtetë shkojnë disa sende edhe nëpër komisione, na po debatojmë, por duhet t'i marrim sendet në esencë dhe t'i zgjidhim, të kontribuojmë në zgjedhjen e tyre.

Prandaj, unë e ftoj edhe Qeverinë, e ftoj edhe Kuvendin, që këtë sektor ta fuqizojë, ta rrisë numrin e të punësuarve, ta rrisë cilësinë e tij, kualifikimin e tyre, ta rrisë buxhetin e tyre. Për Agjencinë e Statistikës, e cila duhet të na furnizojë me informata për ta ngritur cilësinë e qeverisjes dhe për të marrë vendime të mira harxhojmë 900 000 euro. Më falni, me 900 000 euro kurrë nuk do të bëjmë statistika të mira, por si duket dikush edhe nuk mërzhitet nëse kemi apo jo statistika të mira. Këtu është problemi.

Në qoftë se Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës nuk janë të brengosura me stadin e zhvillimit të këtij enti të kësaj agjencie, atëherë kjo do të thotë se ne nuk jemi të brengosur për cilësinë e qeverisjes. Dhe, kjo është për brengosje - trajtim që ne i bëjmë këtij raporti dhe këtij institucioni. Në këtë drejtim, unë propozoj që vërtet, sidomos këtij sektori, por edhe sektorëve tjerë, t'u jepet një mbështetje shumë më e madhe, edhe të rritet buxheti, edhe të kërkohet publikimi i statistikave të llogarive kombëtare sipas sektorëve të prodhimit, sipas dinamikave, të prodhohen edhe lëvizjet e GDP-së sipas kuartaleve, sepse ju e dini, dikush thotë po rritet GDP-ja 2%, dikush thotë po rritet 4%, dikush 5%. Statistika na i jep informatat pas një ose dy vjetësh.

Këto janë gjëra të cilat duhet të na brengosin dhe duhet t'i japim mbështetje këtij institucioni, forcimit të tij edhe ndryshimit të qasjes. Në këtë drejtim, ndoshta duhet kërkuar që të fuqizohet ky këshill. Unë e kam pasur rastin ta shohë këshillin që e ka zgjedhur kryeministri apo Qeveria, nuk e di. Këshilli Mbikëqyrës i kësaj agjencie ka mundësi të jetë shumë më i gjerë dhe më kompetent, e para, dhe e dyta, ne duhet të mendojmë seriozisht. Unë kam diskutuar edhe kur e kemi sjellë ligjin, a është zgjidhja më e mirë se kjo agjenci të jetë nën Zyrën e Kryeministrit, apo jo? Kjo çështje me të vërtetë duhet të analizohet. Ndoshta është më mirë që të jetë institucion krejtësisht i pavarur, të jetë kompetent në aspektin profesional, t'i raportojë dhe përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Domethënë ka përvoja të ndryshme, unë e hapa vetëm si mundësi nëse eventualisht diskutohet ligji në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Tani u tha edhe u bë i njohur edhe qëndrimi i Grupit Parlamentar të LDK-së. Edhe pas diskutimeve të disa deputetëve, u tha mjaft se cila është gjendja në Entin e Statistikave dhe posaçërisht u tha shumë se cili është roli dhe misioni i kësaj agjencie, që është tepër i rëndësishëm, ngase krijohen njohuri dhe të dhëna dhe makro-parametra, mbi të cilët mund të bazohet pastaj edhe vendimmarrja dhe nga të cilët ne varemi shumë për ta përshkruar gjendjen që e kemi dhe për t'i përshkruar parakushtet për atje ku duam të shkojmë.

Ndërsa unë po e prek edhe një pjesë tjetër të medaljes. Nëse ky institucion është aq i rëndësishëm dhe qasja është si e tillë, përveç që po lëndohen institucionet e pavarura, pavarësisht lidhjes horizontale që e kanë dhe veprimet e ndryshme, në anën tjetër nganjëherë, me ose pa dashje, po bëhen veprime se sikur nënçmohet fusha të cilën ata e mbulojnë, mbi të gjitha. Unë vetëm po i lexoj disa prej sfidave, të cilat ne i kemi në raport dhe nga ajo del pastaj shumë brengosëse. Nëse thuhet se sfida është mosrespektimi i Ligjit për statistikën, ose mungesa e buxhetit, e stafit, mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme profesionale, vonesat në frymën e të dhënave administrative, mosrespektimi, burimi jo i mjaftueshëm i të dhënave, mungesa e sistemit unik të IT-së, pastaj harmonizimi i prodhimit të statistikave sipas metodologjive bashkëkohore, EUROSTATI-t, ngritja e cilësisë në sasi të të dhënave statistikore deri edhe te mungesa e hapësirës fizike, kjo i tregon të gjitha.

Prandaj, edhe një arsye më e madhe që ky raport, duke mos u votuar, sensibilizuar dhe të shihet nëse këtij institucioni i kanë munguar parakushtet për funksionim të mirëfilltë brenda, dhe i mungon kaq shumë, ekstrem i mungon mbështetja e shtetit, atëherë mosmungesa e raportit vërtet kërkon përgjigje nga përgjegjësit se çfarë ne duam me këtë institucion dhe çfarë ne duam në fushën që ky institucion e mbulon?

Prandaj, unë edhe një herë po them - roli i Agjencisë së Statistikave është shumë më i madh sesa ne, në mentalitetin tonë, po e trajtojmë. Rëndësia e ndërtimit të politikave dhe vendimeve me të dhënat që kjo agjenci i prodhon, është e domosdoshme. Prandaj, nuk jemi të kënaqur me funksionimin e kësaj agjencie, por aq më parë jemi të zhgënjyer me mbështetjen që shteti ia jep asaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Selmani e ka fjalën!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Përshëndetje për ministrin dhe për deputetët,

Duke marrë parasysh se ky është raporti i parë, i cili duhet të ishte në rregull në bazë të ligjit, i cili është miratuar nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe nga Kuvendi i Kosovës në fund të vitit 2011, mirëpo prapë nuk mund të themi se e kemi një raport efektiv për arsye se për zbatimin e plotë të këtij ligji, në fakt duhet të jenë parametrat statistikorë, të cilët duhet të jenë të saktë.

U përmend edhe nga parafolësi, Armend Zemaj, që edhe vetë Qeveria ka qenë në kundërshtim me disa raporte të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Është më se e vërtetë se nuk mund të pritet diçka më e mirë kur të gjithë parametrat, të cilët duhet të jenë në këtë agjenci nuk janë parametra që i ka shteti i ri i Kosovës, ose të cilët janë marrë po nga qytetarët e Kosovës. Ndërsa çështja e politizimit të agjencive, mund të themi se çdo qeveri që ka qenë, duhet të jemi transparentë para qytetarëve, ka dëshirë t'i çojë njerëzit e vetë nëpër këto agjenci. Çka fitojmë ne nga politizimi i agjencive dhe mosforcimi i Agjencisë së Statistikave?

U tha edhe nga profesori Muhamet Mustafa që të dhënat e GDP-së, të dhënat nga ministritë, të dhënat nga plani i zhvillimit ekonomik të gjitha dalin të pasakta. Atëherë çka jemi duke i ndihmuar në bazë të ligjeve, të cilat i miratojmë në Kuvend të Kosovës. Në rast se e dëshirojmë një agjenci statistikore, e cila na jep strikt të dhënat për shtetin e ri të Kosovës, atëherë duhet t'i ndihmojmë. Çështja se kush do të punojë aty është shumë pak me rëndësi. Më me rëndësi për shtetin e Kosovës do të jetë çështja çfarë ekspertësh vendosim në Agjencinë e Statistikave, në fazën në të cilën gjendet.

Ne i japim përkrahje, mirëpo përkrahje do t'i japim edhe në mënyrë ligjore dhe në mënyrë profesionale për arsye se është agjenci e cila nxjerr shumë të dhëna dhe në bazë të këtyre të dhënave njihen statistikatat në çdo vend të botës për shtetin e ri të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po provoj të flas shkurt, në mënyrë që të mos i përsëris vërejtjet dhe shqetësimet që u ngrehën nga kolegët tjerë deputetë.

Agjencia e Statistikave e Kosovës është një institucion si shumica e institucioneve në Kosovë që po vuan nga ndërhyrja e politikës në punën e vet të përditshme. Pikërisht për këtë arsye, kryeministri është kujdesur që Agjencinë e Statistikave ta bartë nga ombrella e Ministrisë të Shërbimeve Publike në atë kohë dhe ta vërë nën ombrellën e zyrës së tij.

Qeveria jonë nuk ka strategji zhvillimore. Qeveria jonë punon ad hoc dhe nuk ka plane zhvillimore. Për këtë arsye, si duket, edhe neglizhon zhvillimin dhe përforcimin e kësaj agjencie të statistikave. Ne të gjithë jemi të vetëdijsëm se statistikatat janë bazë e një planifikimi racional dhe bazë për çfarëdo lloj zhvillimi ekonomik. Mirëpo, meqenëse Qeveria nuk është e interesuar as të ketë plan, e as strategji, si duket e ka keqkuptuar rolin e prodhimit të statistikave dhe ka vendosur që ato t'i prodhoj vetë, e të mos ia lërë as Zyrës së Statistikave.

Ne nëse sot e kritikojmë shumë Agjencinë e Statistikave, në fakt nuk jemi fer me një pjesë të stafit brenda një agjencie, që punon në mënyrë të dinjitetshme. Ne sot duhet ta kritikojmë Qeverinë për neglizhencën dhe ndërhyrjen që po i bën kësaj agjencie në punën

e vet të përditshme. Unë po përmend, të nderuar deputetë, vetëm dy raste eklatante të ndërhyrjes së Qeverisë në prodhimin e statistikave në Agjencinë e Statistikave.

E para është, nëse i shohim të dhënat për rritje ekonomike në Kosovë, qoftë nga Banka Botërore, qoftë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, dhe i krahasojmë me rritjen ekonomike që paraqitet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, kemi një dallim prej 100%. Derisa, për shembull, parashikimi për rritje ekonomike për vitin 2013 nga Banka Botërore parashihet të jetë diku 2,2%, këtë Agjencia e Statistikave të Kosovës e paraqet si 3,9%. Dhe, çfarë arsytimi ka këtu? Kjo shifër vjen drejtpërdrejt nga Zyra e Kryeministrit dhe nuk prodhohet me matjet që i bën Agjencia e Statistikave. Pse duhet të ketë divergjencë kaq të mëdha, kur edhe Banka Botërore, edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, ka plot 13 vjet që provojnë dhe kanë projekte për ngritje të kapaciteteve dhe metodologjisë kërkimore dhe metodologjisë të statistikave në këtë agjenci, mirëpo kjo shihet se është thjesht një ndërhyrje.

Rasti tjetër është i para 3 muajve, kur Agjencia e Statistikave e Kosovës doli me një deklarata se kinse papunësia në Kosovë paska rënë për 10 pikë të përqindjes.

Të nderuar deputetë,

Të bjerë papunësia 10%, i bie që 25% të të papunëve në Kosovë kanë gjetur punë. Të gjithë ne që jetojmë në Kosovë e dimë se sa po bie papunësia në Kosovë. Nëse tregut të punës në vit i bashkëngjiten 25 000 deri 30 000 të papunë dhe nëse në gjashtëmujorin e këtij viti janë krijuar vetëm 2 386 vende pune, atëherë si del që papunësia na paska rënë për 10%?

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Është për të të ardhur keq prej njerëzve që punojnë në mënyrë të dinjitetshme në këtë agjenci dhe është për keqardhje qëndrimi që Qeveria e ka karshi këtij institucioni kaq të rëndësishëm dhe ne, si deputetë, edhe pse duhet ta votojmë raportin kundër, besoj që duhet të marrim iniciativë që ta ndryshojmë Ligjin që Agjencinë e Statistikave shpejt e shpejt ta largojmë nga ombrella e Zyrës së Kryeministrit.

Le të jetë ky një institucion i pavarur, ta ketë një buxhet të dinjitetshëm dhe të punojmë të gjithë për pavarësinë e këtij institucioni, sepse vetëm kështu ne mund ta çojmë edhe institucionin përpara dhe të dhënat që dalin nga ky institucion mund të përdoren për të mirë të qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E fundit është Zonja Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Shumë gjëra u thanë në lidhje me këtë agjenci dhe për mua nuk është justifikim fakti që është i ri dhe tani duhet të bëjë gabime të qëllimshme, ose të paqëllimshme.

Çështja që duhet ta trajtoj unë lidhet me një gjë shumë të rëndësishme. Është bërë regjistrimi i popullatës në Kosovë dhe janë regjistruar, përveç numrit të popullatës, edhe

shumë e shumë të dhëna të tjera, të cilat kanë qenë nëpër pyetësor. Mirëpo, nga ajo çfarë kemi parë deri tani, shumë pak të dhëna janë përpunuar. Regjistrimet e popullatës bëhen, jo vetëm për t'i numëruar njerëzit që jetojnë në një territor të caktuar, por edhe për shumë e shumë të dhëna të tjera. Për shembull, ne sot ne nuk e dimë se çfarë të dhënash, çfarë statistikash ka për çështje të ndryshme në arsim, ta zëmë. Sa vajza i nisin studimet dhe i lënë ato, që është shumë e rëndësishme, për shembull. Apo sa është numri i njerëzve, të cilët janë analfabetë, analfabetë funksionalë? Apo cili është numri i të papunë? Cilat janë problemet e tjera të ekonomisë së Kosovës.

Të gjitha këto të dhëna janë shumë të rëndësishme, në mënyrë që të hartohen politikat qeveritare. Por, jo vetëm që nuk është bërë përpunimi i të dhënave, të cilat do të ishin shumë të rëndësishme për ne, por është edhe një problem tjetër, që unë e shoh se është shumë më i madh.

Kam informacione që ato të dhëna, të cilat po përpunohen, po manipulohen. Në fakt, të dhënat bëhen, ose statistikatat nxirren në përshtatje me atë çfarë i duhet Qeverisë në kuptimin për të manipuluar me opinionin publik. Një nga këto statistika shumë të rëndësishme, dhe kjo më vjen nga burime brenda këtij institucioni, është çështja e përqindjes së papunësisë në Kosovë, e cila është një nga shifrat me të cilat manipulohet më së shumti.

Më duket se u theksua edhe nga deputetë të tjerë, por përqindja e njerëzve të papunë është zvogëluar. Kam gjithashtu informata, të cilat gjithashtu nuk shihen në këtë raport, se stafi drejtues apo menaxherial po keqpërdor edhe paratë e donatorëve. Paratë të cilat jepen për zhvillimin e këtij institucioni shpesh përfundojnë në xhepat e menaxherëve të këtij institucioni, e kjo bëhet në kundërshtim të plotë me ligjin që e rregullon këtë institucion, por edhe me rregulloret e brendshme.

Një projekt tjetër, i cili ka dështuara plotësisht dhe që është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë, është ai i regjistrimit të bujqësisë, i cili duhet të bëhet në nëntor. Në fakt, kjo gjë do të bëhet në vitin e ardhshëm, në vitin 2014. Ky është shumë i rëndësishëm, sepse do ta ndihmonte Ministrinë e Bujqësisë për planifikimin më të mirë të buxhetit, në mënyrë që t'i ndihmonte ekonomitë familjare dhe bizneset, të cilat merren me bujqësi.

Mungesa e regjistrimit, mungesa e statistikave të sakta do të pengojë edhe marrjen e donacioneve të premtuara nga agjencitë e huaja, e po ashtu e bën të vështirë implementimin, apo dhënien e parave nga Buxheti i Kosovës në shumën prej 4,7 milionë eurosh. Natyrisht, mbase këto para do të shpërndahen, do të shpërndahen sipas zonave elektorale të cilat i interesojnë Qeverisë, e jo sipas nevojave të vërteta, por edhe duke u nisur nga koncepti i barazisë të shpërndarjes së këtyre parave.

Këto janë dy-tri gjëra të cilat desha t'i theksoj. Natyrisht që ka shumë në lidhje me këtë institucion, por ajo që mund të them është që nuk po bëhet punë serioze dhe po manipulohen të dhënat. Të mos harrojmë që në rast se një agjenci e pavarur fillon dhe prodhon të dhëna të cilat i shkojnë për shtati Qeverisë, atëherë ne kemi hyrë në një fazë

tjetër të një sistemi dhe e dimë se cilat sisteme i manipulonin të dhënat për interesat e mbajtjes së pushtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Qeveria, dëshiron dikush të flasë? Jo! Atëherë nuk ka të tjerë të paraqitur. Në sallë janë të pranishëm 69 deputetë. Përgatitemi për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Konstatoj se me 35 vota për, 29 kundër dhe dy abstenime, Kuvendi e miratoi raportin e Agjencisë të Statistikave të Kosovës për vitin 2012. Faleminderit!

Doni ta vazhdojmë, apo pauzë? Atëherë shkojmë në pauzën e drekës deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Vazhdojmë me shqyrtimin e raporteve.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për mbikëqyrjen e buxhetit të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës

Komisioni për Punë të Brendshme Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka mbikëqyrur buxhetin e institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur për miratim raportin me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës e paraqet dhe arsyeton deputeti Famir Xhelili. Zoti Xhelili, e keni fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kolegët deputetë!

Komisioni në mbledhjen e mbajtur në mars të 2012-ës ka vendosur të bëjë mbikëqyrjen e buxhetit të institucioneve të sigurisë së Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim komisioni ka formuar një grup punues, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë do të merrej me mbikëqyrjen e buxhetit të institucioneve të sigurisë, me fokus të veçantë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë e Kosovës.

Grupin punues e kanë përbërë me autorizim të komisionit: unë Fatmir Xhelili, Rexhep Selimi dhe Vjollca Krasniqi, anëtarë.

Mbikëqyrja e shpenzimeve buxhetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës është bërë me qëllim që Komisioni Funkcional Parlamentar t'i mbikëqyrë shpenzimet buxhetore të këtyre dy institucioneve, nëse këto janë bërë në pajtim të plotë

me kornizën ligjore që rregullon këtë fushë. Gjithashtu, komisioni kishte për qëllim të vlerësojë nëse Qeveria përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës përmbushin detyrimet, që dalin nga ligjet ekzistuese, që rregullojnë menaxhimin e buxhetit të alokuar dhe procedurave të prokurimit.

Në të gjitha fazat e punës, grupi punues është mbështetur nga një ekspert i OSBE-së, për ç'gjë e falënderojmë OSBE-në. Gjithashtu, është mbështetur edhe nga DIKAF-i, i cili na ka mbajtur ligjërata të posaçme për mënyrën e mbikëqyrjes së shpenzimeve financiare të sektorëve të sigurisë, për çka edhe i falënderojmë. Gjithashtu, edhe administrata e komisionit tonë bashkë me një falënderim të posaçëm edhe për KRPP-në, e cila ka qenë gjithherë e gatshme dhe në dispozicion për të ofruar ekspertizat e ekspertëve të saj, për metodologjitë e aplikuara më rastin e kësaj mbikëqyrjeje.

Mbikëqyrja e shpenzimeve buxhetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës është bërë sipas dy metodave cilësisht të ndryshme komplementare të njëra-tjetrës, nëpërmjet të analizës së kornizës përkatëse ligjore dhe dokumenteve të ndryshme, si dhe nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me zyrtarë përkatës në institucionet e ndryshme.

Në vazhdim të trajtimit të kësaj çështjeje grupi punues ka kërkuar për ekzaminim nga Departamenti i Prokurimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Departamenti i Prokurimit të Policisë, listën e dokumenteve si në vijim:

1. Një përshkrim të detajuar të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, gjatë tre vjetëve të fundit 2010, 2011, 2012,
2. Kopjet e të gjitha dokumenteve të kontratave të konsulencës dhe dokumentacionit tenderues me vlerë të barabartë ose mbi 10 000 euro, për kompanitë dhe me vlerë të barabartë ose mbi 4 000 euro për individët, për vitet 2010, 2011 dhe 2012.
3. Kopjet e të gjitha kontratave të prokurimit me vlerë të barabartë ose mbi 10 000 euro dhe kopjet e dokumenteve relevante të tenderimit, së bashku me tenderuesit e pasuksesshëm për vitet 2010, 2011, 2012.
4. Kopjet e dokumenteve që lidhen me shitjen e aseteve në vlerë të barabarta ose me shumë më shumë se 3 000 për vitet 2010, 2011 dhe 2012.
5. Përshkrimet e vendeve të punës dhe gradën e pagave të të gjithë anëtarëve të stafit të departamenteve të prokurimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës, duke përfshirë të gjithë personat e punësuar në kohën brenda viteve 2010, 2011, 2012.

Pas ekzaminimit të këtyre dokumenteve, grupi punues kishte caktuar dhjetë lëndë nga Policia e Kosovës dhe një lëndë nga Ministria e Punëve të Brendshme, për trajtim të mëtejshëm si në vijim, të cilat janë figuruar edhe në tabelën prezantuese në raportin, të cilin

e prezanton komisioni, përkatësisht në raportin me shkrim që e kanë të gjithë deputetët pranë vetit.

Duke u nisur nga fakti se këto lëndë vlerësoheshin si sensitive, grupi punues për të pasur vlerësim sa më profesional kishte kërkuar ndihmë nga KRPP-ja që të japin vlerësimin e tyre rreth këtyre lëndëve dhe KRPP-ja ka trajtuar këto lëndë dhe në rekomandimet e saj për këto lëndë të kontraktuara kishte konstatuar se ka mosrespektim dhe shkelje të Ligjit të prokurimit publik.

Grupi punues pasi kishte marrë këto rekomandime nga KRPP-ja ka analizuar dhe trajtuar në takimet dhe vizitat që u ka bërë institucioneve përkatëse. Grupi ynë i ka vizituar institucionet përkatëse, Policinë e Kosovës, përkatësisht prokurimin e Policisë së Kosovës dhe prokurimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, e ka vizituar KRPP-në dhe e ka organizuar një dëgjim publik në lidhje me të gjeturat.

Gjetjet kryesore gjatë procesit të mbikëqyrjes së buxhetit për institucionet e sigurisë kanë qenë:

- Mosrespektim dhe moszbatim i dispozitave të caktuara të Ligjit për prokurimin publik nga autoritetet kontraktuese të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës në rastin e lëndëve të monitoruara,
- Nivel jo i mirë i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kontraktuese, Këshillit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe organit shqyrtues të prokurimit publik,
- Probleme sistematike në sistemin e prokurimit të Policisë së Kosovës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, të cilat mund të rezultojnë me humbjen e fondeve të Qeverisë,
- Buxheti i kufizuar i KRPP-së,
- Stafi jo i mjaftueshëm për monitorimin e lëndëve,
- Kushtet joadekuate të punës së këtij institucioni i vendosur në objekt me qira,
- Mos marrja në konsideratë e rekomandimeve të KRPP-së nga ana e institucioneve përkatëse,
- Personel jo i mjaftueshëm në Departamentin e Prokurimit të Policisë së Kosovës, si dhe
- Mosrealizimi i kontratave sipas mënyrës së paraparë me ligj dhe kushteve të lidhjes së tyre.

Duke marrë për bazë problemet e identifikuara Grupi Punues konkludon se Ligji nr. 04-L/042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës është i zbatueshëm, por ka pengesa, për çka duhet të ndërmerren masa konkrete për ndryshimin e situatës aktuale.

Prandaj, me qëllim të ndryshimit dhe përmirësimit të gjendjes aktuale, me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të këtij ligji dhe rritjes së përgjegjësisë nga ana e institucioneve të sigurisë që menaxhojnë me financa publike, Komisioni FunkSIONAL propozon disa rekomandime, të cilat ia propozon Kuvendit që t'i aprovojë.

Rekomandimet:

1. Kuvendi i Kosovës, përkatësisht komisionet parlamentare të rrisin mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore të ekzekutivit, ku secili komision të bëjë mbikëqyrjen e buxhetit të Ministrisë përkatëse, duke përfshirë në këtë proces që nga faza e planifikimit buxhetor dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e shpenzimeve të tij në përputhje me Ligjin e miratuar për buxhetin.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ndërmarrë masa, që Ministria e Punëve të Brendshme, në veçanti nga Policia e Kosovës të zbatojnë me përpikëri Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe Ligjin për prokurimin publik dhe Ligjin për buxhetin vjetor.
3. Organi shqyrtues i prokurimit brenda afatit prej 90 ditësh të dorëzojë në Kuvendin e Kosovës një raport lidhur me të dhënat e lëndëve të proceduara për vendosjen në OSHK, për të cilat ka pasur mendim këshillëdhënës nga Këshilli Rregullator i Prokurimit Publik përkitazi me lëndët, në të cilat autoritetet kontraktuese është Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës.
4. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, duhet të dorëzojnë në Komisionin Parlamentar Funkcional për Siguri për shqyrtim të gjitha projektet për pajisje, që janë në vlerë më shumë se 1 milion euro, para dorëzimit të tyre për miratim në Kuvendin e Kosovës dhe atyre që financohen nga donatorët.
5. Departamenti i Prokurimit në Policinë e Kosovës duhet të plotësohet me personel të mjaftueshëm dhe me ekspertizë të nevojshme.
6. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës të hartojnë një plan veprimi në afatin 3 muajor për të planifikuar implementimin e të gjitha rekomandimeve të auditorit të brendshëm dhe KRPP-së.
7. Ministri i Brendshëm dhe drejtori i Policisë të raportojnë në Komisionin Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, gjashtë muaj pas miratimit të rekomandimeve nga Kuvendi lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e tyre.

Më lejoni që edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të propozoj për miratimin e këtyre rekomandimeve dhe për aprovimin e raportit të prezantuar nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Forcë të Sigurisë lidhur me mënyrën e shpenzimit të buxhetit në institucionet e sigurisë në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës si organi më i lartë legjislativ luan rol të rëndësishëm në miratimin e buxhetit, por njëkohësisht do të duhej të luante rol edhe në mbikëqyrjen e mënyrës së menaxhimit dhe shpenzimit të tij.

Komisioni në këtë rast ka bërë një punë voluminoze, me qëllim që të shohë nëse shpenzimet të MPB-së dhe Policisë së Kosovës janë bërë në pajtim të plotë me kornizën ligjore. Komisioni ka bërë këtë punë me qëllim që të marrë të dhëna dhe të identifikojë keqpërdorimet e mundshme të mjeteve buxhetore nga ana e institucioneve të sigurisë nëpërmjet analizës së kornizës ligjore, dokumenteve të ndryshme, si dhe nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me zyrtarët përkatës të këtyre institucioneve.

Për të ndihmuar punën e komisionit në këtë rrafsh, komisioni ka pasur bashkëpunim me KRPP-në, në mënyrë që vlerësimet të jenë sa më profesionale. Komisioni pasi ka shqyrtuar një numër dokumentesh të ofruara nga këto institucione, grupi punues ka caktuar dhjetë lëndë nga Policia e Kosovës dhe një nga MPB-ja. Këto lëndë nuk janë përzgjedhur në mënyrë indikative, por në mënyrë spontane dhe vlerësimet e KRPP-së lidhur me këto lëndë kanë rezultuar se ka shkelje të Ligjit të prokurimit.

Të nderuar kolegë,

Në raport të gjithë i keni se cilat lëndë janë përzgjedhur nga grupi punues, andaj nuk do të doja t'i theksoja një për një. Por, ajo që mund të them është që në çdo lëndë të trajtuar, analizuar, ka shkelje të Ligjit të prokurimit diku më të mëdha, diku më të vogla.

Problemet janë sistematike, që në raport është thënë, do të thotë kemi thënë ne vet, sepse edhe unë jam pjesë e grupit punues dhe e komisionit, se këto probleme çojnë në mundësinë e humbjes së fondeve të Qeverisë. Por, unë them, që në njërin anë është humbje e fondeve të Qeverisë, por në anën tjetër ku shkojnë këto humbje? Natyrshëm, shkojnë në xhepa të grabitqarëve, që çdo ditë po e varfërojnë vendin.

Në shumicën e rasteve zyrtarët kompetentë nuk kanë mundur të arsyetojnë shkeljen e neneve të caktuara të Ligjit të prokurimit. Një rast po ju përmend, në një nga lëndët e analizuara tek mirëmbajtja, servisimi dhe kalibrimi i pajisjeve për kontrollin e dokumentacionit, ku autoriteti kontraktues, ka kërkuar sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 10%, mirëpo në dokumentacion mungon sigurimi i ekzekutimit. Kësaj nuk mund t'i thuhet ndryshe, përveç keqpërdorim, vjedhje, grabitje e parave publike.

Institucionet që kanë mandat luftimin e krimit, korrupsionit, pikërisht në këto institucione zhvillohet apo më mirë të thuhet, kultivohen në mënyrë sistematike këto gjëra, gjë që kanë filluar të bëhen fenomen në vendin tonë. Ky është shembulli më i keq i mundshëm.

Kjo nuk do të duhej të ndodhte, andaj edhe qytetarët e Kosovës, dita-ditës po e humbin besimin në Policinë e Kosovës.

Në bërthamën e institucioneve të sigurisë, që ne i quajmë të sigurisë dhe ato më së paku po shërbejnë tani për siguri, ndodhin gjëra më të liga të mundshme - afera milionëshe, e çfarë mund të themi për institucionet tjera?

Korrupsioni funksionon në mënyrë vertikale, si piramida kur në dijeni për çdo marrje të mitos janë punëdhënësit apo eprorët e zyrtarëve të prokurimit, në të shumtën e rasteve. Andaj, luftimi i korrupsionit në Kosovë është i pamundur përderisa mbrohet nga ata që e marrin ajkën.

Edhe për të bërë skema të vjedhjes së parave publike duhet goxha shkathtësi, por natyrisht edhe pafytyrësi dhe për këtë gjë jemi në krye të listave për aftësinë e llojit të tillë. Pikërisht nëpërmjet këtyre tenderëve, kemi njerëz që me familje e më gjerë jetojnë me të gjitha të mirat në kushtet kur në Kosovë gjysma e popullatës vuan nga varfëria.

Vendi ynë ka mekanizma aq të shumtë për të luftuar korrupsionin, por këto institucione kanë vetëm retorikë, nuk po e bëjnë punën e tyre. Dukuria korruptive ka marrë përmasa shumë shqetësuese, të cilat vendin tonë e vënë në krye të vendeve më të korruptuara në rajon dhe më gjerë.

Pavarësisht se kryeministri pat premtuar kësisoj zero-tolerancë ndaj korrupsionit, ai po e përfundon mandatin e tij duke krijuar hapësirë e mundësi për lulëzim të këtij fenomeni, si në “bahçe të babës”, e adresa e së cilës duhet drejtuar për këtë gjendje, qytetarë të nderuar, është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Edhe ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ftojmë deputetët që t'i miratojnë rekomandimet e lexuara nga kryetari i grupit punues, zotëri Xhelili. Faleminderit!

KRYETARI: Nga “Vetëvendosje”, fjalën e ka kryetari i Grupit, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” është pro këtyre rekomandimeve të paraqitura këtu nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së. Natyrisht, që po e mbulojmë jo vetëm një çështje e cila është shumë e rëndësishme, po edhe një Ministri e cila ka qenë jashtëzakonisht problematike për sa i përket prokurimit publik me afera të shumta, të cilat kulmuan pastaj me aferën e pasaportave biometrike dhe 1.4 milionëshin e famshëm që ende nuk u gjet se kush e mori nga buxheti i Kosovës dhe në xhep të kujt hyri.

Mendoj që rekomandimet në përgjithësi janë të mira, por disi janë të pagjak disa prej rekomandimeve. Pra, po na paraqitet prapë ky sindromi, kisha me e quaj, shumë rekomandime që i kemi pasur në Kuvend, ku Kuvendi kërkohet që të votojë një rekomandim me të cilin e thërret Qeverinë ta respektojë ligjin, që mendoj se është në

kundërshtim me logjikën e funksionimit institucional të secilit vend normal, e edhe të Kosovës, që po pretendojmë ta bëjmë një vend demokratik. Pra, nuk ka nevojë që Qeveria të thërritet për ta respektuar ligjin, por meqenëse jemi në këtë gjendje në çfarë jemi, atëherë mendoj që nevoja për rekomandime të tilla nga Kuvendi e shpërfaq në njëfarë mënyre edhe se në çfarë forme po funksionojnë këto institucione, pra ku duhet t'i kujtojmë Qeverisë që ta zbatojë ligjin.

Po ashtu, disa prej rekomandimeve nuk janë, konsideroj unë, të drejtpërdrejta sa duhet të ishin dhe çështja tjetër, e treta që kisha dashur ta ngre për këto rekomandime është që me rekomandimin një edhe pse pajtohem, mendoj që në njëfarë mënyre kjo thërret për një përgjegjësi pak më të madhe të Kuvendit në këtë proces dhe nuk e di nëse Kuvendi do t'i ketë kapacitetet, në mënyrë që ta bëjë këtë mbikëqyrje të financave dhe të buxhetimit për një Ministri të caktuar, në nivelin e duhur. Dhe, nëse Kuvendi nuk i ka këto kapacitete e ndërkohë voton për t'i marrë këto përgjegjësi, atëherë ajo nuk është asgjë tjetër përveçse ndarje e fajit në Kuvend, për diçka që Ministria e ka bërë dhe për diçka që Ministria do ta bëjë në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Rekomandimet e ofruara për votim janë rekomandimet e dala nga komisioni, i cili ka kryer punën e vet sa i përket përgjegjësisë, që i ka në bazën ligjore dhe po ashtu, grupi i cili ka përpiluar këtë material i ka shfaqur të gjitha të gjeturat, të cilat kanë qenë devijime ligjore apo keqpërdorime ose vjedhje në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ne konsiderojmë se prezenca e ministrit do të ishte e nevojshme në këtë rast, sepse ai duhet ta dëgjojë fjalën e deputetëve, sidomos kur ka të bëjë me shkeljet dhe ato që kanë qenë keqpërdorime në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në mënyrë që të mund të ndryshohet gjendja në këtë Ministri dhe në Policinë e Kosovës, imazhi i të cilës ka rënë pikërisht për shkak se janë bërë abuzime dhe keqpërdorime të shkallës më të lartë.

Këto rekomandime normalisht janë për Qeverinë, sepse Qeveria sot menaxhon me buxhetin dhe ajo ose e mban buxhetin ashtu si duhet, në vijat e parapara ligjore ose tregon se është e paaftë për ta menaxhuar Buxhetin e Republikës së Kosovës. Të gjitha të gjeturat janë në materialin e ofruar dhe rekomandimet pikërisht kanë të bëjnë me ndryshimin e gjendjes në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përkatësisht edhe në Policinë e Kosovës, që vërtetë kemi një dëmtim të këtij imazhi.

Prandaj, duke mos i përsëritur edhe kolegët, në emër të grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, konsiderojmë se këto rekomandime duhet të votohen në mënyrë që të kemi një angazhim shumë më të madh dhe më serioz të prokurimit dhe të niveleve të tjera, të cilat duhet ta ndryshojnë këtë praktikë të deritashme të sjelljes në institucionet tona. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh diskutimin apo analizimin e këtij raporti me rekomandime për mbikëqyrjen e buxhetit të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës, nga Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në rast se e shohim Rregulloren e punës së Kuvendit dhe besoj se kryetari është në dijeni më shumë, për arsye se është deputet në legjislaturat edhe të mëparshme, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri, Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duhet të jetë një komision, i cili merret me çështjen e politikave dhe ligjeve brenda Ministrisë së Punës, Ministrisë së Forcës së Sigurisë. Ndërsa, çështja e këtyre rekomandimeve, të cilat janë nxjerrë po nga ky komision, unë prapëseprapë them se ne e kemi një Komision për Buxhet, i cili funksionon brenda Kuvendit të Kosovës dhe kemi një Komision për Mbikëqyrje Financiare, të cilin e udhëheq zoti Ali Sadriu. Dhe, kemi raporte të auditimit, kemi raporte të Auditorit Gjeneral, të cilat unë kisha kërkuar që ky komision t'i kërkojë nga Komisioni për Mbikëqyrje Financiare, ndoshta edhe nga vetë ministri një raport dhe t'i sillet Komisionit për Punë të Brendshme.

Me sa më duket, rekomandimet të cilat kanë dalë nga ky komision janë si ndërhyrje e Komisionit për Mbikëqyrje Financiare, kur dihet se ne funksionojmë nga të gjitha të hyrat nga një buxhet i Kosovës dhe ai buxhet i Kosovës ndahet në linja buxhetore, të cilat po ato linja buxhetore kontrollohen apo mbikëqyren nga Komisioni për Mbikëqyrje Financiare.

Unë nuk e di sa janë valide këto rekomandime të këtij komisioni. Prapëseprapë, unë kërkoj nga kryetari i Kuvendit, si personi kryesor për zbatimin e Rregullores së punës së Kuvendit, mos është një ndërhyrje brenda Komisionit për Mbikëqyrje Financiare. Faleminderit!

KRYETARI: Përgjigje, deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FAMIR XHELILI: Ndoshta, pa qëllim të keq edhe mund të nënkuptohet si ndërhyrje, nuk është qëllimi i kurrfarë ndërhyrjeje. Në shtetet me traditë demokratike, qysh prej fillimit të planifikimeve buxhetore participojnë edhe anëtarët e komisionit të sektorit përkatës prej fillimit të planifikimeve të buxhetit e deri te zbatimi i shpenzimeve të projekteve, për mjetet të cilat aprovohen prej buxhetit për t'u mbikëqyrë.

Një mbikëqyrje më adekuate prej komisioneve adekuate për resorët adekuat, qysh është në këtë rast Komisioni për Mbikëqyrje të Punëve të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë, është komision adekuat, që din për ta shfrytëzuar edhe ekspertizën prej ekspertëve, po edhe njohuritë e veta për mënyrën e mbikëqyrjes së shpenzimeve të mjeteve të dedikuara për resorët në fjalë.

Në shumë shtete komisionet e tyre bëjnë edhe hulumtime dhe mbikëqyrje më të detajuara për shpenzimin e parave të taksapaguesve, bile shkojnë edhe më tutje dhe bëjnë edhe hetime për mënyrën e shpenzimeve. Kështu që mbikëqyrja është diçka që ua lehtëson punën resorëve në fjalë për ta përmirësuar vetveten dhe për të identifikuar më lehtë të metat dhe dobësitë e tyre, që në shumicën e rasteve janë procedurale, por ndoshta edhe

ato lëshime procedurale varet a janë të qëllimshme dhe të paqëllimshme, për të krijuar ndonjë konkurrencë jolojale për konkurruesit që i shfrytëzojnë paratë e buxhetit, gjegjësisht për kontraktorët apo nënkontraktorët e tyre.

Kjo bazohet edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenin 125, paragrafi 5, Ligjin për Policinë e Kosovës neni 51, Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës, neni 4 dhe në Rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 65, pika 5. Bile, në Ligjin për forca të sigurisë është edhe neni adekuat, që asnjë projekt i cili është i kushtueshëm mbi 1 milion euro nuk mund të shpenzohet, gjegjësisht të aprovohet shpenzimi i tij, pa lejen e komisionit përkatës, përkatësisht komisionit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën për replikë e ka kryetarja e Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Me gjithë respektin për rekomandimet apo sugjerimet, që u dhanë nga kolegu, unë prapëseprapë them, në rast se komisionet parlamentare bëjnë planifikimin e ministrive mbikëqyrëse, atëherë është diçka tjetër. Në rast se do t'i të bësh monitorimin apo çështjen e auditimit të këtyre subjekteve apo linjave buxhetore, mirëpo çështja e menaxhimit të financave publike dhe çështja e prokurimit publik, ju e dini mjaft mirë që shkojnë nëpërmjet Komisionit të Mbikëqyrjes Financiare dhe nëpërmjet raporteve të auditimit OSHP-së, KRPP-së.

Dhe, të nderuar, ne jemi përgjegjës të gjithë për menaxhimin e financave publike, pa marrë parasysh deputetë të opozitës apo opozitës, se është buxheti i qytetarëve, mirëpo në fakt unë prapëseprapë e them se është një ndërhyrje brenda Komisionit për Mbikëqyrje Financiare. Faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

E para çka dua të them është për t'u vlerësuar puna e grupit punues brenda komisionit që e ka bërë këtë mbikëqyrje, edhe pse fusha është specifike dhe mund të ndërlidhet edhe me komisionet tjera, që apostrofohen. Por, e rëndësishme është që komisioni tenton ta mbikëqyrë resorin përkatës edhe në këtë fushëveprimtari.

Unë mendoj që Kuvendi duhet të jetë i vëmendshëm në rekomandimet që i jep për Qeverinë dhe Ministrinë e caktuar, sepse pikërisht edhe nga ky komision kemi pasur para pak kohësh një raport pune të mbikëqyrjes së Ligjit për Inspektoratin Policor dhe i cili ka kaluar në heshtje dhe nuk kemi ndonjë përgjigje as nga Ministria e Punëve të Brendshme, por as nga Inspektorati Policor i Kosovës.

Të gjeturat që i bën komisioni në këtë resor të rëndësishëm, unë mendoj që duhet jo të kalojnë kështu, në këtë mënyrë ad hoc dhe me një jo vëmendje, as nga Kuvendi dhe as nga Qeveria, sepse po rezulton me një keqpërdorim të vazhdueshëm që ndodh në institucionet e sigurisë të vendit tonë. Kur të them në vazhdimësi, keqpërdorimet jo

vetëm të buxhetit, por edhe një zhvleftësim të punës së ndershme të njerëzve që mund të bartin pozicione të ndryshme dhe që punojnë për ruajtjen dhe jetën e qytetarëve të vendit.

Andaj, unë kisha dashur të vlerësoj që këto rekomandime ndoshta mund të konkretizohen, edhe pse faza e kërkesës për raport kthesë nga KRPP-ja duhet t'i adresohen konkretisht Ministrisë së Punëve të Brendshme, sepse organ i sigurisë është Policia, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme është bartës i politikave të sigurisë në vend.

Dhe, nuk duhet që ne sot të anashkalojmë faktin se këto të gjetura në mënyrë të pavarur dhe shumë profesionale të bëra nga deputetët, sot të kalojnë kështu në heshtje dhe pa ndonjë përgjigje nga ekzekutivi i vendit. Andaj, unë mendoj që komisioni duhet të dalë edhe me një rekomandim, që të përkufizohet afati kohor i kthimit të përgjigjeve dhe marrja e masave për eliminimin e këtyre defekteve të paraqitura. Përndryshe, çdo raport që miratohet dhe kalon nga Kuvendi i Kosovës, me rekomandime do të jetë vetëm harxhim kohe për deputetët, për Kuvendin dhe do të shkojë në vesh të shurdhër. Faleminderit!

KRYETARI: Pasi u bë një thirrje në Rregullore, neni 57 i Rregullores përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve. Kush nuk e ka të qartë, le ta lexojë nenin 57 të Rregullores. Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke u thirrur edhe në Kushtetutën edhe në Ligjin mbi policinë, po ashtu në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, mund të them se Komisioni bazuar në këto akte ka kryer punën e vet dhe ne kemi jo vetëm mbikëqyrjen e politikave të Ministrisë, ose në përgjithësi të institucioneve të sigurisë, po gjithë funksionimin e Ministrisë, sepse kemi pasur raste kur opinionimi është alarmuar me ato që kanë ndodhur në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Prandaj, duke pasur parasysh se duhet të jemi shumë më të interesuar që të përmirësohet gjendja, komisioni e ka marrë përsipër edhe shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e financave publike brenda një ministrie.

Është obligim kushtetues dhe ligjor, jo vetëm i komisionit, por edhe i deputetëve veç e veç, në mënyrë që institucionet tona të përmirësohen dhe të mos lejojmë këto institucione të devalvohen në shkallën që janë devalvuar. Faleminderit!

KRYETARI: Meqë të lajmëruar për diskutim nuk kemi, atëherë përgatitemi për votim.

Prania elektronike është 94 deputetë, ndërkaq prania fizike 77 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 61 vota për, 4 kundër, 1 abstenim, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për mbikëqyrjen e buxhetit të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raportuese e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Dola këtu, sepse kujtoj që vëmendjen ta tërheq se tash pasdite jemi lodhur.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, duke u nisur nga neni 53 i Rregullores së Kuvendit të Kosovës, ka marrë në shqyrtim dhe monitorim Ligjin për aftësimin dhe riaftësimin profesional të personave me aftësi të kufizuara.

Është një ligj i rëndësishëm dhe kur u aprovua hyn në mesin e ligjeve drejt integriteteve evropiane dhe të gjithë ishim të lumtur që ky ligj më në fund erdhi në Kosovë dhe del në mbrojtje të një kategorie shumë të ndjeshme që janë personat me aftësi të kufizuara dhe të cilëve duhet t'u mundësohet që të jenë të barabartë në tregun e punës.

Nisur nga kjo Komisioni së pari vendosi grupin punues i cili me konkluzionet e tij gjatë disa muajve, me punën në terren, në bazë të anketave të bëra në terren dhe shumë punëve të tjera, kontakteve të drejtpërdrejta erdhi në konkluzion që të parashtrojë këto kërkesa për ndryshim-plotësim të ligjit.

Unë do t'ju kujtoja edhe një herë se cili është qëllimi kryesor i kësaj mbikëqyrje. Vlerësimi i ligjit për aftësimin - riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, pastaj si po zbatohet ky ligj në praktikë, vlerësimi i shkallës së përmbushjeve të obligimeve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në lidhje me zbatimin e ligjit, vlerësimi i akteve dhe nxjerrja e akteve nënligjore nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e ligjit, vlerësimi në përmbushjen e obligimeve që nga ky ligj rrjedhin për Inspektoratin e Punës, pastaj mirëvajtja ose jo e qendrave të punësimit dhe qendrave për aftësimin profesional për personat me aftësi të kufizuara, vlerësimi i zbatimit të ligjit nga institucionet publike dhe ndërmarrjet private që gjithashtu dalin nga ky ligj, vlerësimi i efekteve dhe pasojave në moszbatimin e këtij ligji.

Metodologjia e punës për ta monitoruar këtë ligj, ishte thash, formimi i grupit punues, pastaj kontaktet e drejtpërdrejta në formë të pyetësorit u shpërndanë në të gjitha komunat dhe institucionet publike dhe disa institucione private dhe për këtë na ndihmoi NDI - UNDP dhe ne jemi shumë mirënjohës. Gjithashtu në bashkëpunim me Grupin e Grave

Parlamentare u organizua një tryezë e rrumbullakët ku morën pjesë shumë organizata joqeveritare dhe e familjarëve që organizohen në mbrojtje të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe nga këto gjithashtu i përkrahëm konkluzionet e dala.

Puna në terren. Në terren ne vizituam disa komuna siç janë: Prizreni, Peja dhe Gjlani. Në këto komuna bashkëpunuam me drejtorët komunalë të cilët merren me zbatimin e këtij ligji, domethënë drejtoritë për punë dhe mirëqenie sociale, pastaj vizituam qendrat për aftësimin profesional dhe institucionet edukative që merren me qëndrim ditor të personave me aftësi të kufizuara, është fjala për fëmijët, ose që janë shkolla për aftësim profesional siç është shkolla për të verbrit, për shurdhmemecët në Prizren ose shkolla speciale “Lef Nosi”, gjithashtu në Prizren.

Puna në terren u kombinua edhe me një vizitë studimore që patëm në Shqipëri për të mundur të krahasojmë nivelin e mbrojtjes institucionale të personave me aftësi të kufizuara me një vend tjetër që të dimë se ku ndodhemi.

Të drejtën të them, mund të konstatojmë se edhe pse në fillim, ne kemi bërë disa hapa në nisje që mund të na çojnë drejt një suksesi në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Megjithatë, zbatueshmëria e Ligjit për aftësimin - riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, has në disa pengesa duke u nisur se me ligj këtyre personave u garantohen të drejta të caktuara dhe ligji nuk funksionon si duhet.

Grupi punues ka ardhur në këto konkluzione se me ligj ka qenë dashur të nxirren 5 nën akte nënligjore ndërkaq janë nxjerrë 4. Nuk është formuar komisioni për përcaktimin e shkallës së paaftësisë profesionale të personave me aftësi të kufizuara. Për shkak të implementimit buxhetor nuk është zbatuar neni 12, 16, 18 dhe 19. Nuk është formuar fondi i veçantë ku do të derdheshin mjete për tu zbatuar neni 12 i këtij ligji, gjë që ka shkaktuar probleme në zbatimin e ligjit.

Mjetet e ndara nga Ministria për zbatimin e politikave dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të destinuara për këtë nevojë nuk janë shfrytëzuar nga Ministria ashtu siç janë dedikuar, përkundrazi ato janë alokuar në një fond tjetër dhe kjo është shumë e dhembshme.

Evidentimi i personave me aftësi të kufizuara të punësuar dhe atyre që kërkojnë punë nuk është bërë në përputhje me nenin 16. Personat me aftësi të kufizuara nuk janë të njoftuar me të drejtat e garantuara me këtë ligj dhe me mundësinë që ata mund të aftësohen, riaftësohen dhe të jenë të barabartë në tregun e punës.

Mungon bashkëpunimi institucional i nivelit qendror me institucionet e nivelit lokal, madje-madje ne kemi hasur në këto komuna që i kemi vizituar se niveli lokal është edhe më i interesuar në përkrahje të kësaj kategorie se sa niveli qendror.

Inspektori i punës nuk ka mundësi ta mbikëqyrë zbatimin e ligjit dhe të shqiptojë gjoba të caktuara për shkak se nuk është krijuar fondi, asnjë linjë ose kod buxhetor ku mund të derdheshin mjetet e mbledhura, edhe ashtu me një përqindje shumë të vogël që duhet

korrigjuar që të mblidheshin këto mjete dhe të dedikoheshin për aftësimin profesional të këtyre personave.

Kur personi me aftësi të kufizuara 100% është punësuar në ndonjë rast, sipas ligjit, përcjellësit e tij i takon asistenca personale e ndihmës në punë. Përkundrazi, ata - përcjellësit nuk kanë fituar nga ky ligj.

Dhe të gjitha këto nisur edhe nga fakti se edhe gjatë aprovimit të këtij ligji është folur, është caktuar se në çdo 50 të punësuar duhet të ketë 1 person, ndërmarrja është e obliguar qoftë domethënë institucioni qeveritar, qoftë privat, është i obliguar që të punësojë personin e aftësuar për punë në Kosovë edhe pse në vendet tjera kjo ndodh në çdo 25, ne kemi bërë një ndryshim duke dashur që t'i kursejmë ndërmarrjet, sidomos ndërmarrjet private, është bërë gabim sepse në Kosovë nuk ka ndërmarrje të mëdha që punësojnë 50 punëtorë, por ndërmarrjet janë të vogla dhe të mesme, prandaj këtu duhet korrigjuar këtë ligj.

Prandaj, në fund duke i falënderuar të gjithë që na përkrahën dhe sidomos duke i mbështetur publikisht ata që kanë të drejtën e garantuar me këtë ligj, që janë personat me aftësi të kufizuara, dhe kërkojnë aftësimin - riaftësimin e tyre dhe punësimin profesional, në mbështetje të të gjithëve, komisioni rekomandon:

- Qeveria e Kosovës të përfshijë në strategjinë legjislative plotësim-ndryshimin e Ligjit numër 3/L-019 që është Ligji për aftësimin - riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

- Të bëjë planifikimin buxhetor dhe të parashohë rritjen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Përmbledheni nëse doni më shpejt. Edhe dy minuta...

FLORA BROVINA: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të krijojë një fond apo kod buxhetor ku do të derdheshin mjetet e punëdhënësit të cilët nuk i përmbushin obligimet ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

- Ministria të bëjë informimin e personave me aftësi të kufizuara për mundësinë e aftësimit - riaftësimit dhe punësimit të tyre.
- Të shtohet numri i qendrave për aftësimin profesional dhe të shtohen profilet e aftësimit profesional brenda këtyre qendrave.
- Të rritet bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë dhe qendrave të punësimit dhe të komunave në lidhje me aftësimin e këtyre personave, dhe do të kisha shtuar - pse jo edhe të shtohet bashkëpunimi regional për aftësimin profesional.

- Kompanive që punësojnë personat me aftësi të kufizuara t'u ofrohet edhe përkrahja e benificioneve të parapara me ligj.
- Të rriten kapacitetet e mbikëqyrjes në zbatimin e këtij ligji përmes inspektoratit të punës, i cili deri tash nuk ka pasur fare punë në lidhje me këtë temë.
- Të bëhen evidenca të sakta të numrit të personave të aftësuar për punë dhe numrit të saktë të atyre që janë të punësuar.
- Kur punësohet një person i aftë për punë me aftësi të kufizuara 100% atëherë pensioni i tij duhet t'i kalojë asistentit personal për ndihmën në punësim.
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet t'i raportojë Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale një herë në vit për zbatimin e këtij ligji mjaft të rëndësishëm.

Ju lus që t'i apromoni këto konkluzione. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e kryetarëve të grupeve ose përfaqësuesit të grupeve parlamentare. Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah raportin dhe rekomandimet e dala nga ky raport.

Mendojmë që ky ligj do të duhej të jetë në agjendën legjislative të Qeverisë për ndryshim dhe plotësim, sepse gjatë monitorimit të këtij ligji janë vërejtur disa mangësi gjatë zbatimit të tij.

Gjatë monitorimit të ligjit është vërejtur se në disa nga komunat që i kemi vizituar si Prizreni, Gjilani dhe Peja, po bëjnë përpjekje për zbatimin e ligjit dhe po mundohen për të krijuar raporte për përmirësimin e jetës së kësaj kategorie, bile në disa nga këto komuna janë krijuar edhe qendrat e qëndrimit ditor të personave me aftësi të kufizuara.

Në shumicën e qendrave të aftësimin profesional janë të krijuara kushtet për aftësim të personave me aftësi të kufizuara, por ne mendojmë se duhet të bëhet më shumë në informimin e kësaj kategorie për mundësinë e aftësimin – riaftësimin dhe punësimit të këtyre personave. Andaj, Grupi Parlamentar i PDK-së ju rekomandon që t'i votoni rekomandimet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Bahri Thaçi.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale nga nëntori i vitit 2012 deri në korrik 2013, ka monitoruar Ligjin për aftësimin - riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi ka qenë të vlerësohet niveli i zbatueshmërisë së këtij ligji, a ka mangësi në këtë ligj të cilat pengojnë zbatueshmërinë e tij.

Komisioni ka konstatuar se ligji nuk po zbatohet në mënyrë të kënaqshme. Janë gjetur edhe mangësi në ligj. Institucionet përgjegjëse të niveleve të ndryshme nuk i koordinojnë veprimet në mes veti që të përmbushin obligimet që dalin nga ligji për të ndihmuar aftësimin - riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Kjo kategori kërkon më shumë vëmendjen dhe përkujdesjen tonë, andaj Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës përkrah rekomandimet që i ka propozuar Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputetja Albana Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Ligji për aftësimin - riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara është miratuar në Kuvend në. Pra, ky ligj është miratuar në Kuvend që 5 vjet dhe ende nuk po gjen zbatim.

Duke filluar që nga neni 12, sipas të cilit punësimin në tregun e hapur të punës ku ligji obligon organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare si dhe kushtet e përshtatshme të punës të punësojnë persona me aftësi të kufizuara dhe atë në çdo 50 punëtorë të punësojnë një person me aftësi të kufizuara, siç e cekën edhe shumë kolegë paraprakisht.

Deri më tani kjo nuk po respektohet askund e më së paku në organet e administratës shtetërore dhe në sektorin publik në përgjithësi.

Përveç nenit 12 që ka të bëjë me punësimin e kësaj kategorie nuk po respektohet as neni 16, i cili parasheh evidentimin e personave me aftësi të kufizuara të punësuar dhe atyre që kërkojnë punë, si dhe nenet 18 dhe 19 që kanë të bëjnë me beneficionet financiare në rastin e punësimit, si dhe stimulimit material në të holla ku përmes këtyre neneve do të përfitonte si punëdhënësi ashtu edhe i punësuar duke iu mundësuar në këtë mënyrë avancimi i pozitës sociale-materiale dhe integrimi në jetën e përditshme të personave me aftësi të kufizuara.

Raporti i Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e paraqet gjendjen reale se sa po zbatohet ky ligj dhe ne i përkrahim rekomandimet e dala nga ky raport. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, fjalën e ka deputetja Time Kadriaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Qëllimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për aftësimin- riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara është të vlerësohet ky ligj si dhe të konstatohet niveli i zbatueshmërisë së tij në praktikë. Ky vlerësim është synuar të arrihet përmes vizitave në terren me qëllim të marrjes së të dhënave në lidhje me funksionimin dhe zbatimin e tij si dhe të vlerësojë nëse Qeveria, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është duke i përmbushur obligimet që dalin nga ky ligj.

Grupi punues, bazuar në autorizimet e tij ka arritur me sukses të përmbyllë aktivitetet e planifikuara në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Gjatë periudhës nëntor 2012 - korrik 2013, Grupi punues ka realizuar 13 takime dhe vizita në terren. Gjithashtu janë mbajtur takime të rregullta të grupit, qëllimi i të cilave ishte koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve.

Me miratimin e Ligjit për aftësimin-riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara është krijuar baza ligjore për aftësimin dhe riaftësimin për punë të kësaj kategorie të popullatës dhe janë krijuar mundësi ligjore për punësimin e këtyre personave.

Miratimi i ligjit ka obliguar Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që t'u dalë në ndihmë këtyre personave.

Me ligj janë paraparë të nxirren pesë akte nënligjore, katër akte janë nxjerrë, ndërsa një akt nënligjor nuk është nxjerrë. Nuk ka komision të veçantë për verifikimin e shkallës së aftësisë profesionale të personave me aftësi të kufizuara. Për shkak të implikimeve buxhetore nuk janë zbatuar shumë nene të këtij ligji, nuk ka fond të veçantë ku do të derdreshin mjete për zbatimin e nenit 12. Mjetet e ndara në Ministri për zbatimin e politikave për persona me aftësi të kufizuara janë ridestinuuar për nevoja tjera të Ministrisë.

Duke u bazuar në punën e bërë në procesin e mbikëqyrjes së Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nga grupi punues, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka arritur të bëjë një analizë për të arriturat dhe mangësitë e ligjit.

Komisioni konsideron se ligji për aftësimin - riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara e ka avancuar riaftësimin dhe punësimin e këtyre personave, por përkundër sukseseve të arritura, janë identifikuar edhe probleme në zbatim të ligjit si dhe disa mangësi që ka ligji.

Andaj, një prej rekomandimeve kryesore të Komisionit Parlamentar është që në këtë vit të silllet në Kuvend për plotësim-ndryshim Ligji për aftësimin dhe riaftësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Grupi Parlamentar i Aleancës, duke e ditur rëndësinë e këtij projektligji, e përkrah raportin dhe rekomandimet e dhëna nga Komisioni Parlamentar.

KRYETARI: Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për aftësimin - riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Koalicioni për Kosovë të Re ka marrë pjesë në Grupin punues me anëtarin e vet, deputetin Gëzim Kelmendi i cili na ka informuar për qëllimin e mbikëqyrjes së ligjit me ç'rast kam pasur shumë takime dhe vizita dhe Komisioni ka ardhur në përfundim se përkundër sukseseve të arritura janë identifikuar edhe probleme të ndryshme për çka kanë paraqitur pra edhe rekomandime të cilat Koalicioni për Kosovë të Re i përkrah në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: Nga grupe të tjera nuk ka të paraqitur. Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë e mora fjalën pikërisht për rekomandimin e parë në të cilin thuhet se Qeveria e Kosovës duhet të përfshijë në strategjinë legjislative plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 03-L/19 për aftësimin – riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Zoti kryetar, është bërë traditë që secili ligj i cili nuk po gjend zbatim nga ana e Qeverisë të vijë në plotësim-ndryshim në Kuvendin e Kosovës dhe kjo po i bie që gjoja ligji nuk është i hartuar si duhet dhe për atë arsye nuk po implementohet aq sa duhet.

Sa u përket pikave të zbatueshmëria e ligjit dhe konkluzionet, ka një disproporcion ndërmjet këtyre dy pikave, sepse të zbatueshmëria e ligjit thuhet se ligji nuk zbatohet, ndërsa të konkluzionet thuhet 'prej që ka ardhur ky ligj, kjo kategori ka gjetur një mbështetje nga Qeveria'.

Paradoksi tjetër që ekziston në këtë ligj është se, apo Ministria e cila nuk e zbaton ligjin, është se ekziston fondi i cili ndahet çdo vit për këtë kategori dhe po ai fond ridestinoiher për çështje tjera e që nuk shfrytëzohet për qëllimin e njëjtë. Dhe kjo i bie që ka mjaft buxhet dhe ka mjaft pare, ndërsa arsyetimi i Ministrisë është që nuk ka mjaft pare dhe nuk ndahen paret, përderisa të njëjtat para ridestinohen për projekte tjera apo për çështje tjera.

Dhe unë konsideroj që të harrohet kjo praktikë, edhe nga ana e komisioneve parlamentare, që të mos bëjnë raporte me rekomandime të cilat do të kërkonin vetëm plotësim-ndryshimin e ligjeve, por të kërkonin nga ministritë përkatëse, nga resorët

përkatëse që ligjet konkrete të cilat janë të punuara e të cilat nuk është arsyetim se nuk janë punuar si duhet të zbatohen në përpikëri. Faleminderit!
KRYETARI: Replikë, deputetja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Unë do të replikoj me kolegen, pasi ligji realisht kërkon plotësim-ndryshime dhe vetëm i tillë bëhet më funksional. Pse? U tha këtu edhe nga diskutuesit se me ligj parashihet në çdo 49 persona, i 50-ti duhet të jetë person me aftësi të kufizuara dhe i aftësuar për punë dhe nëse nuk është i tillë atëherë kjo ndërmarrje për personin që s'e ka punësuar duhet të ndajë mjete në fond. Pra, duhet të përmirësohet sepse në Kosovë nuk ka ndërmarrje të tilla të mëdha që punësojnë 50, e këtu është edhe ministri dhe e din, nuk ka aq ndërmarrje sa ne të grumbullojmë mjete të mjaftueshme për të hapur qendra për aftësimin profesional të këtyre personave.

E dyta, të hapet kodi i veçantë ose të formohet fondi. Edhe ky është një ndryshim rrënjësor nga ligji i mëparshëm, pastaj të hapen sektorë të ndryshme që nuk ekzistojnë dhe ajo kërkon një buxhet të shtuar.

Mjetet e ndara për këtë fond janë shumë simbolike dhe duhet të shtohen , të shqyrtohen dhe të analizohet se si do të bëhet ndryshe.

Pastaj, kolegja tha se ky ligj nuk zbatohet. Realisht, ne jemi befasuar se ligji ka nisur të zbatohet dhe ky është një sukses i Ministrisë sonë në zbatimin e këtij ligji krahasuar me regionin ku më përpara se ne kanë pasur këto konventat ndërkombëtare dhe ligjin e tillë, por janë shumë pas nesh.

KRYETARI: Kundër-replikë, Rita Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Ta plotësoj zonjën Florë dhe normalisht ta kundërshtoj, sepse nenet 12, 16, 18 dhe 19 që komisioni i ka cekur, janë nenet kyçe të këtij ligji që do të duhej të zbatoheshin e nuk zbatohen. Edhe vetë e kanë cekur këta.

Fondi që paska dallim prej parave të buxhetit, të cilat ndahen pikërisht për këtë destinim, e që e thotë neni 12 atëherë mund të themi se pse kërkon Komisioni të jetë një fond tjetër i veçantë për derisa paratë të cilat ndahen për zbatimin e këtij ligji ato para ridestinojnë. Pra, ekzistojnë paratë, ne kërkojmë prapë ta bëjmë një kod të veçantë – fond të veçantë i cili do ta përmbushte apo do ta zbatonte ligjin.

Sa i përket punësimit të personave me aftësi të kufizuara, ju e dini shumë mirë, le të dalë ministri me statistika të sakta se sa persona me aftësi të kufizuara sot punësohen në Kosovë dhe këtë e thotë edhe Ligji i punës, por fatkeqësisht as ligji i punës, as ky ligj për aftësimin profesional...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Replikat po i kryejmë dhe shkuan ato, e tash fjalën e ka Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është një punë e mirë që komisioni e ka përzgjedhur që ta monitorojë zbatimin pikërisht të këtij ligji për shkak se ky ligj ka të bëjë me një shtresë të njerëzve të cilët janë jashtëzakonisht të ndjeshëm.

Se ky ligj ka raste kur nuk zbatohet dhe dëshiroj të sjell shembullin e Spitalit Regjional të Gjilanit ku edhe pse në dhjetor të vitit të kaluar janë selektuar 2 kandidatë për punësim, njëri prej të cilëve e ka emrin Rinor Rrahmani, ata edhe më tutje vazhdojnë të jenë në pritje dhe nuk janë selektuar, nuk janë futur në skemat e punësimit.

Duhet edhe një herë ta theksoj faktin se këta janë persona të ndjeshëm. Ministria e Shëndetësisë është dashur së paku ata t'i mbajë të informuar dhe të mos i lëndojë, edhe pse ndoshta ka arsye pse të tillët nuk po ka mundësi t'i përfshijë në skemat ndoshta për shkak të mungesës së fondeve.

Dëshiroj ta përmend edhe faktin se neni 12 i këtij ligji thotë se punëdhënësit janë të obliguar që në çdo të 50-in person, siç u tha edhe këtu, ta punësojnë një person me aftësi të kufizuara. Kjo ka të ngjarë që në shumë vende nuk po ndodh dhe kjo është një shkelje e ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: S'kemi të lajmëruar për fjalë. Shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Të pranishëm janë 83 deputetë.

Me 72 vota për, 1 kundër, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin me rekomandimet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin - riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit qeveritar për privatizimin e 75% të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës

Raportin e Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri deputetin Zenun Pajaziti që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e rregullt të datës 30 korrik me shumicë votash ka vendosur që Kuvendit t'i parashtojë rekomandim që të miratohet Raporti i Komisionit qeveritar për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së.

Më lejoni të shfrytëzoj rastin t'ju njoftoj se komisioni, me një mbledhje të mëhershme të datës 4.6.2013, të njëjtin raport e ka diskutuar dhe po ashtu ka vendosur që të kërkojë material shtesë nga Qeveria për këtë raport, në ndërkohë që pas kompletimit të materialit shtesë kemi organizuar një dëgjim publik ku kanë qenë të ftuar edhe ministrat e Qeverisë, ministri Beqaj, ministri Ismajli, ministri Rashiq dhe po ashtu kanë qenë të ftuar edhe përfaqësues të Ambasadës së Britanisë së Madhe, të Gjermanisë dhe po ashtu këshilltarë të transaksionit. Ndërkohë që kemi kërkuar po ashtu që në seancë t'ju sjellim edhe materialet - transkript edhe të këtij dëgjimi publik, e po ashtu edhe materialet shtesë nga këshilltarë të transaksionit.

Pra, po e përsëris, në mbledhjen tjetër të radhës komisioni me shumicë votash i ka rekomanduar Kuvendit që të miratojë këtë raport të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Fadil Ismajli.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Të nderuar anëtarë të Kryesisë së Kuvendit, Të nderuar kolegë ministra, Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Shteti i Kosovës është i përcaktuar për një sistem ekonomik, të bazuar në treg të lirë dhe konkurrencë ku sektori privat gjithnjë do të jetë në qendër të zhvillimit ekonomik.

Ne jemi të përcaktuar që të ofrojmë kushte të mira për investime të huaja dhe vendore dhe të krijojmë një ambient të tillë që në vitet në vijim numri i investimeve, si të jashtme ashtu edhe vendore, të shumëfishohet. Krejt kjo me qëllim të zhvillimit ekonomik të vendit dhe përmirësimit të kualitetit të jetës së qytetarëve të Kosovës.

Posta dhe Telekom i Kosovës për privatizimin e të cilës po flasim sot është një ndër ndërmarrjet më të rëndësishme publike në Kosovë.

Vendimi për të privatizuar 75% të këtyre aksioneve të kësaj kompanie, i marrë nga ju deputetë të nderuar, tregon se ne jemi të hapur për investimet private në njërën anë dhe për bashkëpunim publiko- privat në anën tjetër.

Sot, para jush e keni një raport të përgjithshëm të procesit të privatizimit që nga nisja e tij deri në fazën e tanishme përfundimtare të projektit të privatizimit 75% të aksioneve të Telekomunikacionit të Kosovës.

Më lejoni t'ju rikujtoj, deputetë të nderuar, dhe qytetarëve të Kosovës se në procesin e privatizimit të PTK-së në konsultim me këshilltarë të transaksionit ishte hapur mundësia

për konkurrim për 3 lloj të kompanive apo konzorciumeve dhe atë për operatorë të telekomit, për fonde investimeve me përvojë në telekom dhe fonde investive në partneritet me operatorë të telekomit.

Procesi i privatizimit të PTK-së ka kaluar nëpër dy faza, në atë të parakualifikimit dhe në atë të tenderimit final.

Në fazën e parakualifikimit janë përzgjedhur pesë kompani të cilat i kanë plotësuar kriteret e vendosura nga Komiteti qeveritar i privatizimit, ndërsa në fazën tjetër, do të shihni se lajmërohen vetëm dy.

Konkurrenca ka qenë e mbajtur në të gjitha fazat e procesit, edhe pse në fund, siç thash mbesin vetëm dy oferta, ato në vazhdimësi e kanë pasur presionin e një konkurrence të fortë të përbërë nga së paku katër ofertues seriozë, gjë që ka ndikuar edhe në pranimin e një çmimi adekuat nga ofertuesi më i lartë.

Pas hapjes së ofertave financiare të kompanive pjesëmarrëse në tender, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datën 13 prill 2013 ka miratuar vendimin e Komisionit qeveritar të privatizimit për të shpallur konzorciumin e kompanive “AXOS&Najafi”, me mbështetje teknike nga ‘British Telekom’ dhe Telekomin italian si operatorë ekonomikisht më të favorshëm për blerje të këtyre aksioneve. Ky konzorcium i ka ofruar 277 milionë euro për blerjen e 75% të aksioneve të PTK-së.

Është me rëndësi të ceket se konzorciumi i kompanive “AXOS&Najafi” në këtë transaksion është në partneritet me British Telekomin dhe Telekomin italian dhe e përsëris se KQP-ja kishte lejuar pjesëmarrjen në tender të fondeve investuese me kusht që ato të jenë në partneritet me operatorë me përvojë të telekomit siç janë në këtë rast British dhe italian telekom.

Ne konsiderojmë se fuqia financiare e konzorciumit të tillë, e mbështetur nga përvoja teknologjike e gjigantëve të telefonisë siç janë ‘British Telekom’ dhe ‘Italian Telekom’ do të mundësojnë zhvillim të vazhdueshëm të sektorit të Telekomit në Kosovë, e veçmas të PTK-së dhe që ky investim do të përbëjë një nga investimet e huaja më të mëdha e të suksesshme të deritanishme në Kosovë.

Siç e dini punëtorët e PTK-së do të jenë të garantuar për së paku tri vjet dhe do të mbrohen plotësisht nga Ligji i punës, që është ndër ligjet më të përparuara në rajon dhe në mbrojtje të punëtorit.

Gjithashtu, në bazë të analizave fillestare, të bëra nga vetë kompania investuese, PTK-ja do të mund të gjenerojë edhe vende të reja të punës në vitet në vijim, potencialisht 1 000 vende të reja pune nëpër vitet e ardhshme.

PTK-ja edhe pas privatizimit do të vazhdojë normalisht t’i paguajë taksat dhe dividendën për shtetin e Kosovës nga pjesa e aksioneve 25% dhe sigurisht që dividendat do të merren në pajtueshmëri me përqindjen e këtyre.

Për më shumë, vlera 25% e aksioneve të PTK-së do të rritet më tutje. Hyrja e një kompanie me fuqi financiare dhe potencial të madh të mbështetjes teknologjike nga dy gjigantë të telekomit do të jetë indikator për potencial zhvillues dhe për investitorë tjerë të mëdhenj në Kosovë. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e numrit dhe kualitetit të shërbimeve e po ashtu medoemos edhe në ofrimin e ofertave më të përshtatshme në lidhje me çmimet.

Në bazë të analizave të bëra për Komitetin Qeveritar të Privatizimit nga këshilltarët e angazhuar në proces, konsiderojmë se oferta e pranuar nga ky konsorcium përbën një ofertë serioze dhe përmbajtësore që është në pajtueshmëri me vlerësimet e bëra për biznesin e Kompanisë.

Çmimi i ofruar për privatizim të aksioneve të PTK-së është prej më të lartëve në rajon krahasuar me privatizimet e ngjashme, gjë që tregon për atraktivitetin e PTK-së si kompani, por edhe mundësitë investuese të shteteve në Kosovë.

Kisha dashur në këtë moment vetëm për ta parë një tabelë, nuk di a mund të shihet, domethënë kemi dy raste të ngjashme në rajon të privatizimeve të telekomunikacionit dhe ai është rasti i Kosovës pas përmbylljes dhe është rasti i Telekom Sllovenisë, me rastin e blerjes në Maqedoni, ndërsa e kemi Shqipërinë, Serbinë dhe Malin e Zi, të cilat janë dukshëm domethënë me çmime më të ulëta, nëse krahasojmë vlerën e vlerësuar të kompanisë së Telekomit, e cila shitet me të ardhura vjetore që i bën. Këto më janë gjëra mund të shihen dhe të gjenden edhe në internet. Mund t'i gjeni lirisht.

Këtu kemi të bëjmë me një fond të regjistruar në Gjermani, në konsorciumin e një kompanie investuese amerikane, i cili në bazë të dokumentit zyrtar ka në dispozicion fonde të ngritura, të mjaftueshme, që përmbushin kriteret e dhëna nga ne. Ai, me dokumente ligjore të nënshkruara, merr përgjegjësinë që çdo send i derdhur në arkën e shtetit të Kosovës nga ky transaksion është i pastër dhe vjen nga burime legale.

Më lejoni t'ju informoj juve, deputetë të nderuar, se procesi i privatizimit të PTK-së është ndjekur me kujdes nga partnerët tanë ndërkombëtarë dhe është mbështetur nga ata dhe sigurisht që deklarata e dhënë për publikun nga ambasadorët e Shteteve të Bashkuara, nga Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar, është tregues i mbështetjes së vazhdueshme që kanë dhënë për procesin e privatizimit të PTK-së këta partnerë jashtëzakonisht të rëndësishëm për shtetin e Kosovës. Kjo mbështetje konsiston edhe në rregullshmërinë e procesit, deri në përmbylljen e tij finale. E shfrytëzoj rastin gjithashtu ta përsëris edhe praninë e ambasadave respektive në këtë dëgjim.

Vlen të ceket se konsorciumi i kompanive fituese është në negociata serioze me Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim dhe i ITC për mbështetje financiare të saj dhe është në partneritet me një nga 3 operatorët më të mëdhenj botërorë të telekomit në transaksionin tonë. Përfshirja e IBRTS, Bankës për Zhvillim domethënë, ITC, 'British Telecom' dhe 'Italian Telecom', në një transaksion të përbashkët me fondet e ngritura nga AXOS me konsorciumin me "Najafi Companies", është po ashtu një tregues për seriozitetin e këtij fondi.

Procesi i përfshirjes të sektorit privat në PTK është i një rëndësie të veçantë për vendin tonë. Nga ky proces do të gjenerohen të hyrat për shtetin e Kosovës dhe do të krijohet një partneritet me investitorë të rëndësishëm në këtë fushë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Tani është radha e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Më lejoni që në fillim të fjalës sime t'ju përshëndes të gjithë juve,
Zoti kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Ju të pranishëm dhe të gjithë qytetarët e Kosovës,
Në fillim të këtij sesioni vjeshtor të kësaj legjislature uroj që të kemi pushuar mjaft dhe to t'i përmbledhim së bashku të gjitha energjitë pozitive për ta sjellë Kosovën më përpara, aty ku e meriton vendi, si në zhvillimin ekonomik, edhe në të tjerat.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, më lejoni të ritheksoj edhe një herë dhe t'i ripërkujtoj se Kosova është përcaktuar për treg të lirë, për konkurrencë të mirëfilltë, është përcaktuar për mbështetje të sektorit privat. Madje Kosova ka jashtëzakonisht nevojë edhe për investime të huaja, mënyrë që të gjitha këto përcaktime dhe këta faktorë të shkojnë në favor të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale.

Gjithmonë duke e çmuar faktorin kohë, më lejoni ta citoj një fjalë të profesorit Ali Jakupi që pati thënë në një tryezë në lidhje me privatizimin se më mirë është një privatizim i keq, por i shpejtë, se sa një privatizim i mirë por i vonuar. Ne jemi vonuar pak a shumë në këtë proces dhe i kemi këto ngërçe që po na përcjellin vazhdimisht.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet raportin e Komisionit Qeveritar për privatizimin e aksioneve të Postës dhe ju ftoj, të nderuar kolegë deputetë, ta mbështetim të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotëri kryetar!

Para se të vazhdoj me fjalën në emër të Grupit Parlamentar, edhe unë dëshiroj ta përshëndes praninë ndërkombëtare, por sigurisht ata nuk kanë ardhur për ta shitur Postën dhe ky është absurditeti ynë që në një Kuvend të Kosovës, para përfaqësuesve të popullit, ta krijojmë përshtypjen sikur ata po merren me shitjen e PTK-së. Edhe kjo ndodh te ne. Ose, siç po thotë Profa, po u marrkan, se ashtu po thotë ministri.

Të nderuar kolegë deputetë,

Që në fillim po e lexoj vetëm një nen, në të cilin gjoja është thirrur gjoja ky dokument që e kanë bërë, se Kushtetuta dhe neni 9 i Ligjit për ndërmarrje publike e përcakton bazën ligjore. Po ju them që në këtë ligj, ndër të tjera, thuhet se aksionet në ndërmarrjet publike qendrore mund të shiten lirisht nëse Qeveria e miraton një vendim me shkrim, me të cilin autorizohet një komision qeveritar për privatizim, për të vazhduar me tenderimin dhe shitjen e aksioneve, me kusht që ky vendim të miratohet me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Kosovës. Pas miratimit të këtij vendimi nga Qeveria dhe Kuvendi, Komisioni qeveritar është i autorizuar ta kryejë një tender dhe t'i shesë aksionet në fjalë.

Ju e dini, kjo nuk ka ndodhur kështu dhe sot po vjen në këtë Kuvend, pasi realisht është kryer puna, nëse mund të thuhet, i kanë bërë ato dallavere të cilat i kanë bërë, dhe sot tentojnë ta marrin legjitimitetin nga ky Kuvend. Kjo është post mortum, do të thotë. Pa e respektuar këtë procedurë, sot është sjellë në Kuvend.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si subjekt politik e kemi thënë vazhdimisht, edhe sot po e përsëris, se asnjëherë nuk kemi qenë kundër privatizimit, por gjithmonë kemi qenë dhe do të jemi kundër privatizimit në mënyrën siç është bërë, ose po tentohet të bëhet kjo me PTK-në, pa vendim të Kuvendit të Kosovës. Ju nuk keni bazë ligjore, të nderuar qeveritarë, për privatizimin e këtyre 75% të aksioneve, sepse ky Kuvend, as kjo legjislaturë, as ajo e kaluara, asnjëherë nuk ju ka dhënë leje për privatizimin e PTK-së, dhe e dini pse. Sepse ju nuk keni mundur ta arsyetoni asnjëherë shitjen e PTK-së dhe sepse ne besojmë se nuk do të duhej të shitej aset që i sjell buxhetit të vendit dhjetëra miliona euro vetëm e vetëm që ju t'i paguani asfaltet dhe të paguani diçka tjetër, që veç ju mund ta dini për llogari të kujt. Pra, pa vendim të Kuvendit dhe pa kurrfarë transparence.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo Qeveri sot e ka sjellë këtë raport, mund të thuhet ndoshta një apo dy arsye. E para, se e ka kuptuar, apo bëhet se e kupton kjo Qeveri nuk kanë bazë ligjore për të proceduar më tutje në shitje të PTK-së, përkatësisht të 75% të aksioneve. E vërteta është se nuk kanë pasur bazë as për ta filluar procesin e privatizimit, e lëre më shitjen e këtyre aksioneve, kurse tani, me aprovim të këtij raporti, dëshirojnë ta marrin aprovimin e këtij Kuvendi, apo më mirë të themi ta kontrabandojmë këtë proces, këtë shitje të PTK-së.

E dyta, kompania famoze "AXOS&Najafi" nuk po mund të paguajë dhe Qeveria po dëshiron të arsyetohet se kinse procesin e dështon Kuvendi, e jo Qeveria. Po pse jo?! Në të vërtetë, ne edhe dëshirojmë dhe duhet të punojmë që kjo të ndodhë. Dështoi ky proces, sepse është proces i paligjshëm, është proces në dëm të qytetarëve të Kosovës dhe ne si Lidhje Demokratike e Kosovës nuk dëshirojmë të bëhemi pjesë e një vendimi të paligjshëm, të papërgjegjshëm dhe të dëmshëm karshi interesave të qytetarëve dhe të Kosovës.

Lidhja Demokratike e Kosovës, të nderuar kolegë deputetë, edhe një herë e rithekson se kjo Qeveri nuk ka bazë ligjore për këtë privatizim. Se kjo është kështu dëshmon edhe fakti se është tërhequr një herë, e dini, edhe me kërkesë të kryeministrit. Në prill të vitit

2011, është kërkuar që të tërhiqet strategjia për privatizimin e Postës, sepse arsyetimi, e dini, ka qenë po ashtu qesharak, se është baza ligjore në Ligjin për buxhet të vitit 2011, i cili po ashtu nuk ua ka dhënë këtë bazë ligjore, sepse është futur ashtu siç nuk do të duhej të futen në atë ligj, por edhe i ka dalë më 31 dhjetor 2011 edhe atij tentimi që kanë thënë e kemi të bazës ligjore, i ka skaduar afati.

Ky ligj, të nderuar deputetë, do të thotë Ligji për buxhetin i vitit 2011 nuk ia ka mundësuar, por tani jemi në vitin 2013. Besoj se kjo mjafton për të treguar se absolutisht nuk keni bazë ligjore për të proceduar tutje. Këtu ka bazë për hetuesi, këtu ka bazë për t'i ndjekur ata që kanë gishtë në këtë punë. Këtu ka bazë Prokuroria dhe publikisht po e them le te hetojnë. Le të shohin se kush ka gishtë në këtë plaçkitje që po i bëhen një aseti të vendit tonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria prej se e ka shpallur fitues këtë konsorcium, ka pasur disa data për nënshkrim të kontratës. E fundit ka qenë 13 gushti i këtij viti dhe për aq sa ju jeni transparentë, asnjëherë nuk keni thënë se nënshkrimi nuk po ndodh, sepse nuk keni aprovim të Kuvendit, por keni thënë se kompania është në proces për të marrë kredi nga BERZH-i, e arsyetime të tjera të paqëndrueshme. Por, tash, në materialin që e kemi para vetës, në shkresën e ministrit të ri për nga detyra, ai thotë se kemi vendosur që kontrata të nënshkruhet ndërmjet 15 dhe 30 shtatorit dhe se duhet patjetër që raporti i Qeverisë të aprovohet në Kuvend para 15 shtatorit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Gjatë këtij mandati, Qeveria i ka bërë shumë dëme këtij vendi. Këta mund edhe ta shesin e PTK-në, por pa votën e Lidhjes Demokratike të Kosovës, pa votën e deputetëve, besoj edhe të tjerëve që janë në sallë, që janë të ndërgjegjshëm, që e kanë kundërshtuar së paku me fjalë dhe që nuk janë të Grupit Parlamentar, në këtë rast po flas të LDK-së, që të njëjtën gjë ta bëjnë dhe nuk do të bëhen pjesë e këtyre pazareve që janë të dëmshme dhe i bëjnë dëm të madh këtij vendi dhe këtë synim, si duket, e ka Qeveria e Kosovës.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, as nuk dëshirojmë të votojmë, e as nuk dëshirojmë t'ua bëjmë kuorumin. Nëse e kanë këta si pozitë, le ta bëjnë, por pa ne. Ne e lëshojmë seancën dhe nuk marrim pjesë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Pa dashur ta përsëris atë që e tha parafolësi, është e qartë që Qeveria e Kosovës tash me këtë sjellje të këtij vendimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës, edhe vetë po e pranon se nuk ka pasur fare bazë ligjore asnjëherë për të proceduar me këtë proces privatizimi. Kur ne thoshim që nuk keni bazë ligjore, këta thoshin se kemi bazë ligjore, ndërkohë që tash e sollën vendimin këtu në Kuvend dhe tash, në kundërshtim me ligjin, në mënyrë indirekte po e pranojnë se në fakt paska munguar baza ligjore dhe po kërkojnë një

rilegjitimim të një procesi, të cilit tashmë i ka dalë boja dhe të cilit, më falni në shprehje, po i vjen edhe era.

Kjo tregon shumë për seriozitetin e kësaj Qeverie. Kjo është Qeveri qesharake, mirëpo në këtë tentim komedie që po do ta krijojë me këto institucione, natyrisht Qeveria po bëhet edhe shumë e dëmshme dhe rrjedhimisht është detyrë e këtij Kuvendi që t'ia pamundësojë këtë dëm Qeverisë së Republikës së Kosovës ndaj ekonomisë së vendit, në këtë rast, që po e bënë me këtë tentim të privatizimit të PTK-së.

Në rastin e PTK-së, në mënyrë shumë të pashpjegueshme, kisha për të thënë, është sjellë edhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, i cili, ç'është e vërteta e ka organizuar një dëgjim publik sa i përket këtij vendimi të Qeverisë dhe pastaj, pas këtij dëgjimi publik, është futur në rend dite pa qenë paraprakisht i miratuar si rend dite, ose i propozuar si rend dite, në të njëjtën ditë kur është mbajtur mbledhja e komisionit, dhe kështu, shpejt e shpejt, është kaluar vendimi pa e pasur edhe një debat tjetër, i cili është dashur t'i pasprijë, të them ashtu, dëgjimit publik, që është mbajtur me ministrat, për të cilin foli edhe kryetari i komisionit, Zenun Pajaziti. Dhe, në atë dëgjim publik, është shumë e qartë, transkripti i të cilit nuk u është shpërndarë deputetëve, sa për informatë, kemi pasur shumë pyetje ndaj ministrave dhe shumë pak përgjigje nga ata. Për shembull, pyetja kryesore natyrisht ka qenë se kush është AXOS-i.

Këta nuk kanë ditur të na tregojnë, përveçse ka qenë hera e parë që e kanë pranuar publikisht që AXOS-i nuk është kompani, siç thoshin më herët se është kompani, por që është fond investiv. Nuk kanë ditur, apo nuk kanë dashur të na e thonë se kush qëndron prapa AXOS-it, pra mjetet e kujt, të cilit person ose të cilës kompani janë të investuara në këtë fond investiv që po e blen PTK-në. Këtë asnjëherë nuk e kanë publikuar dhe nuk e publikojnë as sot.

Çështja tjetër për të cilën i kemi pyetur është se si u bë që dallimi është kaq i madh në vlerësimin e kompanisë në zhvlerësimin që ia ka bërë AXOS-i dhe vlerësimin që ia ka bërë konkurenti i dytë 'M1 International', që ka qenë 150 milionë euro për kompaninë e gjithëmbarshme, ndërkohë që AXOS-i e ka vlerësuar 277 milionë euro. Pra, si u bë që ky dallim për të njëjtën kompani është kaq i madh. Pastaj, kemi pyetur sa ka qenë i interesuar 'M1 International' realisht për ta blerë PTK-në, pra i kanë dërguar ekipet e ekspertëve për ta vlerësuar kompaninë, a i kanë bërë ndonjë vlerësim financiar kompanisë, shëndetit operacional të kompanisë. As për këtë nuk ka pasur përgjigje nga ministrat.

Pastaj, i kemi pyetur ministrat a ka dhënë vlerësim Banka e Evropës për Zhvillim dhe Rindërtim, pra BERZH-i, EBRD-ja për këtë proces. Këta kanë thënë që po, por nuk e kemi parë kurrë letrën vlerësuese të kësaj banke sa i përket procesit të privatizimit të PTK-së. Pastaj kemi pyetur kush janë partnerët tjerë të AXOS-it dhe na kanë thënë që, edhe atë e kanë publikuar për herë të parë, është edhe "Telekom Italia", pa dhënë kurrfarë shpjegimi tjetër, gjë që e tha edhe sot ministri në fillim.

Ju kujtohet të gjithëve, kurrë nuk është përmendur që Telekom i Italisë të jetë partner, dhe ai befasisht pastaj u bë partner në këtë proces të privatizimit.

Pastaj i kam pyetur, a e dini rolin e saktë të Telekomit të Britanisë në këtë proces privatizimi, kanë thënë po. Cili është roli i saktë, ministër? Është roli këshillues natyrisht, për shkak se ne e dinim këtë, sepse vetë përfaqësuesit e Telekomit britanik patën ardhur dhe në komisionit dhe kanë treguar se cili është roli i saktë i kësaj kompanie në procesin e privatizimit. Ata janë kompani këshilluese, nuk janë partnere. Janë kompani këshilluese, e cila jep këshilla dhe përgatit raporte dhe vlerësime të ndryshme për AXOS-in, me kërkesë të AXOS-it dhe me pagesë nga AXOS-i. Pra, nuk janë partnerë i AXOS-it dhe nuk janë pjesëmarrës në procesin e privatizimit. Duhet ta bëjmë një gjë shumë të qartë këtu dhe ta kemi një dallim të qartë dhe të kuptueshëm sa i përket rolit dhe pozicionit të Telekomit britanik.

Pra, Telekom i britanik nuk po e blen Postën dhe Telekom i britanik nuk do të jetë investitor në Postë. Ata do të punojnë sipas kërkesave të AXOS-It. Dhe, kur kanë qenë përfaqësuesit e Telekomit britanik në komision, i kam pyetur nëse nuk i përfill AXOS-i rekomandimet tuaja, çfarë mundësie ligjore keni të ndërmerrni ju diçka, ata kanë thënë asgjë, 'sepse nuk është detyrë jona. Ne i këshillojmë, nëse duan t'i marrin këshillat, i marrin, nëse nuk duan, vazhdojnë me të veten'. Pra, Telekom i britanik në këtë proces të privatizimit është impotent, sepse roli i tij dhe marrëveshja që e ka me AXOS-in është një marrëveshje e tillë.

Pra, ministër, mos i dezinformoni, edhe deputetët, edhe qytetarët e Republikës së Kosovës për sa i përket këtij procesi të privatizimit.

Në një letër që ka ardhur në mbledhjen e Kryesisë, që është mbajtur të enjten e kaluar, pra sot një javë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në paragrafin e fundit, kisha pasur dëshirë ta lexoj një pjesë të tij, thotë: Në rast të mosshqyrtimit të këtij raporti, pra e ka fjalën për raportin ose vendimin e Qeverisë për privatizimin e PTK-së brenda afatit të përcaktuar, Qeveria e ka përcaktuar afatin kur duhet ta diskutojë Ku vendi një gjë të tillë, konsiderojmë se Kuvendi i Kosovës mjaftohet me shqyrtimin e raportit në Komisionin Funksional Parlamentar.

Pra, tash, Qeveria po konsideron që një Komision i Kuvendit e paska kryer punën që i dedikohet dhe i përcaktohet me ligj ekskluzivisht Kuvendit, sepse Kuvendi duhet të marrë vendim për privatizimin e ndërmarrjeve publike, siç u tha edhe nga kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, dhe tash Qeveria po thotë që nëse ju nuk e diskutoni brenda afatit që e kam përcaktuar unë, pra që i bie javën e ardhshme, kur ata e kanë kërkuar vetë, atëherë unë do ta marrë këtë si një përgjigje pozitive, pra afirmative, sepse komisioni ka vendosur kështu, e në komision është vendosur me 4 deputetë.

Pra, i bie që Qeveria do të mjaftohet për privatizimin e kompanisë më të rëndësishme, po e përsëris më të rëndësishme në ekonominë e Kosovës, me votat e 4 deputetëve, prej 120 sish, dhe kjo po thonë është rregull demokratike.

Ministër, ju nuk mund të caktoni këtu ligjshmëri! Pra, mos u mundoni ta ndryshoni ligjin edhe ta vendosni Kuvendin para një pozicioni, ose para një akti të kryer, ku ose do të na dëgjoni çfarë po themi ne, ose ne do të veprojmë edhe ashtu si po na e merr neve mendja, pavarësisht juve. Ky proces natyrisht që është antiligjor, është shumë i dëmshëm dhe është jashtëzakonisht i korruptuar, në mënyrë që të lejohet madje edhe të diskutohet në Kuvend, e lëre më që të votohet për të.

Rrjedhimisht, Lëvizja “Vetëvendosje” refuzon që të marrë pjesë edhe në këtë debat, refuzon që të marrë pjesë edhe me këtë votë dhe do ta bojkotojmë këtë seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ka diku ndoshta rreth dy muaj prej se i kam bërë pyetje publike ministrit Beqaj në atë kohë lidhur me privatizimin e 75% të aksioneve të Postës dhe Telekomit. Informatat të cilat i kemi ne na tregojnë se ky proces ka dështuar. Arsyeja, pse? Qeveria e Kosovës nuk e ka nënshkruar kontratën deri më tani, nuk ka të bëjë me vendimin e Kuvendit, për shkak se kanë konsideruar se ky vendim vetëm është marrë dhe mendoj se sot e kemi një dilemë këtu: A është Qeveria e interesuar ta heqë fajin prej vetes edhe të thotë që Kuvendi nuk na ka lejuar ta nënshkruajmë dhe ta pranojë dështimin në këtë proces, apo çfarë është halli?

Po më duket se këtu kemi probleme të mëdha. Është e vërtetë që janë përcjellë me korrupsion, është e vërtetë se kanë mbërri deri në një fazë që ndoshta nëse nuk privatizohet tani, edhe vetë vlerësimi i aseteve dhe i vlerës së kësaj ndërmarrjeje publike mund të përgjysmohet. Domethënë, çka do që ka ndodhur deri më tani, edhe sikur Kuvendi sot të vendosë të shkojë më tutje, edhe sikur ta kthejë këtë vendim, mendoj se Qeveria e Kosovës e ka bërë një dëm jashtëzakonisht të madh në këtë proces.

Aleanca ka kohë që ka treguar se nuk e lëshon sallën, mirëpo të paktën do të votojmë kundër, që të mos jemi pjesë e kësaj pune, e cila do ta shihni edhe vetë shumë shpejt edhe ju, deputetë të nderuar, se nuk do të sjellë diku tjetër, përpos në një degradim edhe më të madh, në një dëm edhe më të madh që i bëhet këtij aseti publik. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër Grupit Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Duke marrë parasysh prezantimin e ministrit, i cili në këtë rast është në fund të procesit të privatizimit të këtij aseti, dhe duke marrë parasysh se një vendim për privatizimin e 75% të aksioneve ka ardhur me Buxhetin e Kosovës në vitin 2011 dhe ky proces në atë kohë ka filluar, mirëpo nuk ka përfunduar, e kemi pasur disa debate brenda Kuvendit të Kosovës për çështjen e privatizimit të Distribucionit-Furnizimit dhe për çështjen e privatizimit të PTK-së dhe prapë në këto raste nuk është vendosur që të ndërpret ky proces i privatizimit, as në Distribucion, as në PTK.

Mirëpo, në fakt, Ligji për ndërmarrjet publike thotë që Komisioni Ndërmarrës ta nxjerrë një vendim për shitjen e asetëve për ndonjë ndërmarrje publike dhe ky vendim t'i delegohet Kuvendit të Kosovës. Në një vendim strikt nuk e kemi pasur, mirëpo në këtë rast e kemi vetëm çështjen e transaksionit, i cili ka mbetur ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Investiv për Telekomunikime dhe tash, ta themi të drejtën, ne po dalim edhe si partner joserioz brenda investitorëve, të cilët dëshirojnë të investojnë në Kosovë.

Cila është mundësia? A ta humbim edhe këtë investitor, i cili do të investojë në shërbimet e telefonisë në Kosovë, apo ta lëmë që të degradohen prapë edhe 75% të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës? Kjo është mundësia që Kuvendi me votën e t'i japë mundësi investitorit, ndoshta jonë mënyrë të rregullt, po e them prapë, se ministri Ismajli tash gjendet në fund të transaksionit dhe duhet të ketë kujdes në prononcimet e tij. Gjendet në fund të transaksionit, i cili duhet të realizohet, dhe transaksioni realizohet atëherë kur ministri Ismaili e ka një vendim të Kuvendit.

Ne do t'u japim përkrahje investitorëve që të vijnë në Kosovë, jo vetëm në këtë rast, por edhe me Ligjin për investime, edhe me taksat të cilat ministri Beqaj i realizoi brenda kësaj jave, që Kosova të zhvillohet, përndryshe me Buxhetin e Kosovës ne nuk mund ta zhvillojmë atë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër dhe
Kabinet qeveritar,

Kjo është një seancë e Kuvendit të Kosovës, në të cilën unë nuk do të doja të merrja pjesë. Me improvizime të tilla dhe me manipulime faktesh, me të vërtetë po e degradojmë rolin e kësaj shtëpie, e cila duhet të imponojë sjellje serioze, duhet të imponojë respektimin e interesit publik.

Interesi publik ka të bëjë me një privatizim transparent, të menaxhuar mirë dhe në mënyrë serioze. Ky proces ka më shumë se dy vjet që është komprometuar tërësisht. Prandaj, edhe unë pajtohem që ndoshta vlera e PTK-së në rundin e ardhshëm do të bjerë për ndonjë milionë euro, ose edhe mund t'i rritet. Këtë nuk e dimë. Sot mundemi të spekulojmë. Por, ta marrim se edhe mund t'i bjerë, por a duhet ne t'i amnistojmë sot sjelljet jashtëligjore, sjelljet joserioze, improvizimet e tejskajshme me një supozim se ndoshta vlera mund t'i bjerë? Unë jam kundër kësaj.

Unë jam që Kuvendi ta tregojë seriozitetin e vet dhe të ftoj të gjithë aktorët e kësaj shoqërie, në rend të parë Qeverinë, që e kemi këtu përpara, që të veprojë sipas ligjit. Ligji kërkon që të vijë një vendim në Kuvend, që Kuvendi të votojë për shitje. Unë gjithmonë kam qenë në favor të shitjes dhe në favor të privatizimit. Ndoshta kisha pasur vërejtje që të shiten 75% , kisha thënë të shiten 60%, se Kosova megjithatë duhet ta ruajë një kontroll, një paketë më të fortë kontrolli në një aset të tillë strategjik, por ne e kemi shtruar këtë problem në dy vjetët e fundit, edhe publikisht, edhe këtu. Kemi thënë 'ku është vendimi, eja ta diskutojmë vendimin'. Jo, ka vendim?

Më vonë, kryetari i Kuvendit e dha evidencën e saktë se vendim nuk ka. E tash, nëse nuk ka vendim, ne duhet të nisemi prej vendimit dhe në bazë të vendimit të zhvillohet procesi. Nuk mund të mbulojmë shkelje të rënda procedurale në lidhje me rolin e Kuvendit.

Nën një, nuk ka privatizim të mirë në qoftë se hiqet roli i Kuvendit - marginalizohet roli i Kuvendit. Kjo është çështje serioze, kolegë deputetë! Nuk mund të pajtohemi me një situatë, ku roli i Kuvendit marginalizohet. Kuvendi është organi kryesor. Kuvendi ia imponon sjelljet Qeverisë, prandaj unë kërkoj nga kryeministri, se e di që ai është në favor të ekonomisë të tregut, dhe e di që është njeri serioz, prandaj kërkoj që ai ta respektojë rolin e Kuvendit. Ta sjellë këtu një vendim, me të cilin do ta fillojmë një proces transparent të shitjes të pavarur 60%. Le të vendosë Kuvendi sa, le të jetë edhe 75%, në qoftë se do. Unë jam për 60%. Të ecim me një konsensus minimal, me një konsensus bazik të të gjithë faktorëve këtu.

Në qoftë se privatizohet ky aset me një kundërshtim të tillë, me një tension të tillë politik social në Kosovë, ne komprometohemi para investitorëve, komprometohemi para të gjithëve, por kjo po ndodh për shkak të menaxhimit të keq dhe unë e kam tërhequr vërejtjen dy vjet se kjo mënyrë e menaxhimit nuk na çon askund. Po e komprometojmë një çështje shumë të rëndësishme. Na sot po flasim për proces transparent, por nuk është proces transparent kur kemi së paku tre investitorë seriozë tërhequr për shkak të vërejtjeve të tyre. Ne e kemi tërhequr Medlin Ollbrajt prej procesit. Ajo e ka dhënë një arsyetim, por është manipuluar shumë keq me emrin e saj, gjoja se ajo do ta fitonte, andej-kënde, ne duhet shkuar ligj e pa ligj. Unë ju kam thënë ‘mos luani me emrin e asaj zonje, mos luani me emrin e asaj zonje të nderuar që ka dhënë aq kontribut për Kosovën’, sepse po të jetë e vetëdijshme se nuk ka bazë ligjore, tërhiqet vetë dhe është tërhequr. Normalisht që tërhiqet.

Çdo investitor serioz tërhiqet prej një procesi të tillë. Prandaj, të bëhemi seriozë, t’i zbatojmë ligjet, ta respektojmë Kuvendin. Edhe ministrit, mos u mundoni të na e shitni partneritetin me Britishin! Ju lutem, e dini ju, keni përvojë në biznes, çka është partneriteti. Po të ishin partneritet, ata do të ishin konsorcium. Ata janë partnerë me kontratë. Në qoftë se AXOS-i i paguan shërbimet e tyre, ata do t’i japin shërbimet, por nuk janë partner tash, nuk do ta menaxhojnë.

Gjithkush mund të jetë partner me kontratë, në qoftë se kërkon konsulta, por mos futni sende, mos futni diçka që diçka që nuk është ajo. Ju lutem, silleni një vendim serioz, të jua përkrahim privatizimin, të bëhet privatizimi, por mos u sillni në këtë mënyrë jashtë ligjit dhe jashtë kornizave ligjore. Kjo është kërkesa ime dhe është kërkesa ime që Kuvendi ta ndërpresë trajtimin e këtij raporti dhe të kërkojë nga Qeveria që të procedojë shumë shpejt me vendim dhe me një proces të rregullt dhe transparent. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra

I nderuar kryeministër,

Kam qenë skeptik në këtë proces prej fillimit, plor sinqerisht kam dëshiruar që të dëshmohet se e kam gabim. Kam dëshiruar të bindem se është në interesin e Kosovës kjo që po bëhet. Për fat të keq, gjithçka që ka ndodhur vetëm ma ka forcuar bindjen se nuk është në rregull diçka me këtë proces.

Kemi shumë dilema dhe unë po i theksoj vetëm disa. Janë edhe ligjore, edhe procedurale, dhe janë të dyja këto të paanashkalushme. Po ndalem vetëm te kjo e fundit.

Në raportin që na e ka sjellë komisioni, së pari nuk janë respektuar afatet siç duhet në shqyrtim. Është bërë gati rregull kjo te ne të luhet me afate. Megjithatë, në çështje të ndjeshme nuk bënë të lejohet kjo, por po e përpij. Çështja tjetër, në raport thuhet që, pas një vonese, komisioni, të cilin e respekton natyrisht për punën që bën, se bën punë të madhe, ka kërkuar një material shtesë nga Qeveria dhe e ka marrë, e ka shqyrtuar. Nuk na është sjellë ne deputetëve. Pse nuk na është sjellë? Ne jemi të mangët në informacionin, i cili, ç'është e vërteta, edhe po ta kishim, nuk do të mjaftonte që ta krijojmë një tablo reale se është krijuar një sistem, njëfarë mënyre e një qasje që duket si manipulative, duket si e mbështjellë me gazetë dhe kur nuk e kuptojmë mirë ne deputetët këtu çka po ndodh, si do ta kuptojnë qytetarët?

Edhe po të jenë gjithçka në rregull, krijohet përshtypja se diçka po kundërmon këtu. Thonë, nuk është puna vetëm të mos bësh keq, por edhe mos të lësh vend për t'u kuptuar keq.

Zonja e zotërinj,

Edhe vetëm kjo, për mendimin tim, do të ishte arsye e mjaftueshme që ky shqyrtim të ndërpritet për të mos shkuar në ndarje në çështje të tilla, që për të mos shkuar edhe në dështime, se dështim është kjo qasje parciale e tjera. Por, unë kam edhe dilema tjera dhe po i përmend vetëm kalimthi. Ndoshta ata që i dinë mire, mund të na ndihmojnë. Dilema ime kryesore është që po dua ta përsëris. Unë nuk e marr vesh se kush po shet e kush po e blen këtë pazar. Për shembull, kur i dëgjoj përfaqësuesit e Kosovës, që në njëfarë mënyre nuk e fshehin njëfarë avokatlleku për ata partnerët që blejnë, njëfarë bindje që ata kanë paguar më shumë se sa që meriton, kjo po na përsëritet vazhdimisht. Them, mor tash, nëse ju keni qenë që keni shitur, e pse pra u lejua ky far raporti? Nëse është tani me miqtë strategjikë, e qysh pra miqtë strategjikë nuk po e dinë se çka është interesi e tjera. Dhe, e duhet t'i ruajmë ata e tjera? Nuk bind kjo qasje, zonja e zotërinj.

Thuhet se Posta, sikur edhe asetet tjera të Kosovës janë zhvlerësuar, nuk janë menaxhuar mirë, prandaj duhet të shiten, sido që të jetë. Nuk mund të pajtohem me këtë logjikë. Së pari, nga ky mosbesim ne të gjitha kapacitetet tona dhe a thua, pastaj, nëse ia japim dikujt, sido që të jetë, pastaj do të konsolidohen? E ku u konsoliduan asetet tona që i shitëm? Ne kështu e dhamë "Ferronikelin" e tjera. Çka pamë prej saj dhe çka do të bëjmë nëse, ta zëmë, e përsëritim këto në vazhdimësi, derisa të mos kemi çka të shesim.

Nëse është keqmenaxhuar, kush e ka fajin? A kemi bërë një analizë? A e keni dhënë gishtin mbi? Jo! Po, a mos ndodh që ndonjëherë që ata e kanë syrin t'i blejnë dhe i zhvlerësojnë me qëllim dhe, po ndodhi kjo, a nuk është e tmerrshme, zonja e zotërinj?

Ose, nuk ka perspektivë... Po kush e ka bërë atë analizë që të na bindë që nuk ka perspektivë? Kurrëgjë te ne nuk ka perspektivë. E pse të tjerët në kushte të ngjashme po kanë perspektivë? A nuk u tha kështu për 'Bankkosit' dhe çka ndodhi? 'Bankkosi' që ishte ndër bankat më rentabël në ish-Jugosllavi dhe ishte për shkak të mërgatës së madhe dhe lidhjes së tyre me vendin, u bë rrush e kumbulla, me Bankën e Re të Kosovës, pastaj me ato ndryshime. Dhe, çka ndodh tash? Banka e Lubjanës ka krizë gjithandej, me sa e di unë, por në Kosovë është shumë rentabël. E tash nuk mërzitet kush pse nuk e kishim ne parasysh dhe këtë minierë parash t'ia linim Kosovës, jo patjetër t'ua jepni, qoftë edhe miqve, se edhe miqtë duhet ta dinë që edhe ky vend i varfër duhet të ketë diçka. Duhet t'i mbetet diçka.

Nuk paska perspektivë Banka e Kosovës, kurse thuhet se janë 1 milion klientë të saj. Po si, ju lutem, sa duhet ata të japin për t'u bërë pronarë të asaj. A nuk mund ne t'i mbledhim të gjitha ato kapacitete që i kemi në mërgatë dhe ekspertët e tjera dhe ta bëjmë një projekt që t'i jemi zot kësaj. Por, nëse krijojmë argumente që na nuk jemi të zotët për kurrëgjë, atëherë pse po kërkojmë pra që jemi të zotë? Nëse nuk qeveriset mirë, një aset yni nuk menaxhohet mirë, po ne nuk e kemi bindjen që po na menaxhohet mirë as Qeveria, as institucionet tjera. Çka t'u bëjmë? Do t'i shesim ato?

Pastaj, nuk më bind edhe kjo që e dëgjova, zoti ministër, respekt. Por, fakti që ambasadorët e vendeve që kanë blerë, e kanë përkrahur, a është ndonjë argument? Ata paguhen për t'i mbrojtur interesat e vendeve të tyre. Normale që edhe do t'i përkrahin dhe do t'i lavdërojnë në ato që janë në interesa tyre. Shumë respekt për ta, e bëjnë punën e tyre, por nuk është ndonjë argument që duhet të ma ndryshojë mua mendjen.

Nuk dua ta vazhdoj, por i druaj edhe asaj se jam në një fushë që, siç thonë, 'nuk dua të hyjë në mal pa sakicë', se nuk jam profesionist në këtë fushë.

Por, e di një gjë që në procesin që ka filluar, nëse dështon projekti, ka një përgjegjësi që shkon me një haraç edhe milionësh. Për mendimin tim, është edhe me interes të shikojmë kujt po i mbetet 'kile'. Nuk do të bënte t'i lihet 'kilja' Kuvendit dhe një farë mënyre pastaj t'i amnistojmë, t'i mbulojmë edhe ata që, se di me çfarë motivesh, kanë hyrë në këtë proces.

Nuk më duket në rregull që Kuvendi, në njëfarë mënyre, të bëhet si, qysh i thuhet, 'cung i kovaçit'. Nuk pyetet, injorohet, instrumentalizohet, por kur vjen puna te përgjegjësia thuhet 'ju deputetët e keni miratuar'. Le të jetë kjo edhe një vërejtje për deputetët që miratojnë me porosi e me instruksione, se pastaj marrin ata përgjegjësi. Askush nuk ju thotë që unë ju kam porositur, ju kam thënë.

Megjithatë, është fjala për çështje të rëndësisë së veçantë për vendin dhe le të vendosim me ndërgjegjen tonë dhe në interesin e votuesve, me parime demokratike, me të cilat

thirret bota demokratike, drejt së cilës synojmë. Unë nuk mund ta mbështes kështu siç është. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Çështja për të cilën po diskutojmë sot është nga më të hershmet, mund të them që në ditën e parë të kësaj legjislature, kur nëpërmjet Ligjit për buxhetin na erdhi një nen shumë i çuditshëm në këtë ligj, që kishte të bënte me privatizimin e PTK-së. I mbështjellë me atë dramën e deficitit buxhetor, në mënyrë të vazhdueshme ka ardhur dhe riardhur, është diskutuar e stërdiskutuar këtu në Kuvendin e Kosovës.

Megjithatë, që nga fillimi i mandatit kanë kaluar pothuajse tre vjet, por Kosova nuk përfundoi në kolaps buxhetor, ashtu siç përpiquej Qeveria ta paraqiste gjendjen atëherë, në rast se nuk privatizohej PTK-ja.

Unë shtroj pyetje se pse kjo këmbëngulje e jashtëzakonshme e Qeverisë për ta privatizuar apo për ta shitur PTK-në, dhe jo pak, por 75% të aksioneve? Unë personalisht jam pro privatizimit, pro ekonomisë të lirë të tregut, pro konkurrencës së lirë dhe të drejtë, por jam plotësisht kundër ndaj konkurrencës së komprometuar dhe jo të lirë dhe, ashtu siç duket, ky proces në fakt garanton mungesën e konkurrencës së lirë. Në fakt, i vjen era korrupsion.

Personalisht mendoj që një aset kaq i rëndësishëm, siç është Postë-Telekomi i Kosovës duhet të miratohet me ligj të veçantë. Nuk mjafton asnjë nen, as dy nene, as tre nene, asnjë vendim, asnjë komision, por duhet të përgatitet ligj i veçantë për shkak se është i një rëndësie të veçantë. Të mos harrojmë, ky lloj institucioni prodhon profit të jashtëzakonshëm dhe pa harxhime për këto kompani. Pra, nuk harxhojnë asgjë, e nxjerrin profitin më të madh nga të gjitha llojet e kompanive, ose të prodhimeve.

Personalisht mendoj që përpara se të hyhej në këtë proces është dashur që të shihen modelet e shumë vendeve të Evropës Lindore, të cilat vijnë nga sistemet komuniste, ku shteti ishte pronar i këtyre ndërmarrjeve. Për shembull, ka plot vende që nuk kanë privatizuar më shumë se sa 49% të aksioneve. Kjo do të thotë që sërish 51% mbetet e kontrolluar nga shteti apo kompani publike, gjë që do të thotë që nuk bëhen eksperimente deri në fund për t'ua dhënë kompanive private në kushtet e një mungese të stabilitetit të këtyre vendeve.

Kosova është shumë më keq në aspektin e stabilitetit. Korrupsioni është shumë i lartë, institucionet e drejtësisë nuk garantojnë drejtësi, kështu që ne do të duhej në fakt të tregoheshim shumë më të kujdesshëm. Gjithashtu këtij procesi prej fillimit i ka munguar transparenca. Plotësisht mungesë transparenca, ashtu sikur i ka munguar transparenca kontratës me "Behtel&Enka" për ndërtimin e autostradës.

Kujt i ka premtuar kjo Qeveri, e cila me çdo kusht kërkon të privatizojë? Sa do të përfundojnë në xhepat e Qeverisë, se ndoshta i ka premtuar vetes?

Analizat për privatizimin, së paku nga ato që është raportuar në media, janë bërë nga ekspertë të huaj, të cilët gjithashtu kanë marrë ose janë paguar me miliona nga buxheti i PTK-së. Të njëjtët persona, të njëjtët ekspertë na janë shfaqur më vonë si aksionarë ose punonjës nëpër kompani, të cilat kanë marrë pjesë në tenderë. A nuk ju shkon mendja se vlera e PTK-së nga këta ekspertë është degraduar në mënyrë të qëllimshme?

Më bëri gjithashtu madje shumë përshtypje, që zoti ministër, i ri si duket në profesionin e zyrtarëve publikë, iu drejtua këtu ambasadave të huaja. Çfarë është ky veprim? Unë nuk besoj se këto ambasada pajtohen me procese korruptive. Ndoshta i mbështetin proceset në parim, por proceset e korruptuara unë nuk besoj, sepse këto janë ambasada të vendeve ku funksionojnë rendi dhe ligji.

Prandaj, ju lutem, zoti ministër, herën tjetër lëreni propagandën se askujt, as ju dhe as kryeministri dhe as Qeveria nuk mund t'ia shisni sapunin për djathë. Faleminderit!

KRYETARI: Halit Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ambienti që u krijua pas diskutimeve në këtë temë më imponoi edhe mua ta marr fjalën dhe të them disa impresione dhe mendime, të cilat mund të jenë të dobishme në këtë proces dhe në këtë temë, dhe të cilat nuk i quaj shumë me kompetencë, por mbase kompetentëve do t'ua ngjall inspirimin dhe meditimin për ta trajtuar këtë temë me përgjegjësi dhe kompetencë çfarë e meriton edhe tema, edhe situata nëpër të cilën po kalojmë tani, edhe vendimi të cilin e presin qytetarët, punëtorët e PTK-së, partnerët në ekonomi, që i ka Qeveria dhe të interesuarit për vendimin e Kuvendit të Kosovës, por edhe për arsyet e shkallës së përgjegjësisë të këtij Kuvendi, që e meriton kjo.

Dhe, nga krejt këto inspirime dhe nga krejt këto motive, unë vendosa që ta marr fjalën dhe t'i them disa mendime. Është e vërtetë se telekomi dhe telekomunikimi për ne është një temë astronomike. Në familjet tona dhe në jetën tonë, kjo temë është e freskët, ka histori të shkurtër dhe ne shërbehemi nga mjetet e telekomunikimit shumë më vonë dhe, natyrisht, tash janë bërë pjesë e pandashme e jetës sonë të përditshme.

Është e vërtetë që në këtë Kuvend, kjo temë është trajtuar disa herë dhe kemi marrë vendime të rëndësishme këtu. Të rëndësishme për Kuvendin, për shkallën e përgjegjësisë së këtij Kuvendi, të rëndësishme për Qeverinë dhe të rëndësishme për ekonominë e Kosovës. Të gjitha këto motive na përmbledhin edhe në diskutime dhe na koncentrojnë në vendimin tonë që tani sot duhet ta marrim që ta kemi në fokus, jo vetëm për këto motive, por edhe për konsensusin e shoqërisë.

Një pjesë e opozitës, e tërhequr tani nga punimet e këtij Kuvendi, do të ishte shumë me rëndësi që ta thotë fjalën dhe me votën e tyre ta deklarojnë edhe para opinionit të gjerë, edhe para votuesve të tyre, por edhe të ndikojnë në performansën simbolike të kësaj vote, përgjithësisht.

Unë tani do të përpiqem t'i respektoj edhe mendimet e disa ekspertëve që i dëgjuam këtu. Kam shumë respekt për profesorët e ekonomisë, nga të cilët kam lexuar edhe tekste, pavarësisht që nuk e kam pasur as në fokus të studimeve të mia, e as inspirim këtë fushë, por më është imponuar që të lexoj e të shfletoj për arsye pragmatiste dhe për nevojat e jetës sonë, por edhe për ta vlerësuar performansën e Qeverisë sonë.

Tani, njëri nga ekspertët, profesorin tonë të nderuar, që nuk e vlerësoj se është motivuar për shkak të ambientit elektoral që po krijohet tash para fushatës, në të cilën gjendemi, por natyrisht se e vlerësoj edhe propozimin e tij. Por, nuk mund ta çmoj shumë tërheqjen e një pjese të opozitës në prag të fushatës zgjedhore dhe për motive elektorale, ta hendikepojë Kuvendin tash dhe ta sfidojë Qeverinë para një vendimi të rëndësishëm dhe natyrisht që mund të përfitojnë para kësaj fushate elektorale, para zgjedhjeve lokale që i kemi, por nuk e besoj që do të ishte mendim i mençur dhe do të ishte vendim i qëlluar dhe që do të shkonte në favor të një subjekti, cilido qoftë ai, qoftë edhe Lidhja Demokratike, që tani e justifikoi dhe arsyetoi tërheqjen e saj.

Prandaj, unë e çmoj shumë edhe deklaratën e kryetarit të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, subjekt i cili për herë poperformon një performansë institucionale dhe një vetëdije e një ndërgjegje të funksionimit institucional. Natyrisht që nuk mund të mbetem pa inspirim timin dhe nuk mbetem pa vlerësim timin. Gjithashtu nuk do të ju mungojë as vlerësimi i opinionit të gjerë, jo vetëm i elektoratit të tyre, por i rritjes së këtij elektorati, gjithsesi.

Gjithashtu i çmoj të gjithë ata deputetë që kanë mendim të kundërt me Qeverinë, por e thonë hapur këtu para këtij auditoriumi dhe në këtë Kuvend. Kështu do të duhej të vepronin edhe subjektet tjera që tërhiqen nga punimet e këtij Kuvendi dhe nuk do të duhej të ishte moto, të ishte qëllim i punës së tyre, i veprimt të tyre. Ky hendikepim i Kuvendit dhe ky sfidim i Qeverisë me këto vendime, që gjithsesi do të jenë në dëm të ekonomisë së Kosovës, në dëm të vendimeve për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës dhe natyrisht që do ta dëmtojnë performansën edhe të këtij Kuvendi dhe gjithsesi dhe me bindje e them se nuk do të përfitojnë elektoratin e gjerë të Kosovës para zgjedhjeve lokale, në të cilat gjendemi tani.

Do të mundohem që të mos e zgjas më tepër. Besoj që ata që janë duke negociuar me Lidhjen Demokratike dhe me ata që u tërhoqën, e morën pak kohë këtu në dispozicion nga fjala ime, e jo nga ndikimi i saj për të influencuar në vendimet që ata do të marrin dhe do të rikthehen, por desha që edhe ta jap një kontribut në mbledhje të kësaj seance, por edhe të krijoja pak kohë edhe të fitonim në këtë kohë për të përfunduar bisedimet dhe negociatat që ata të kthehen këtu në këtë sallë, të na ndihmojnë në vendimet tona, të na korrigjojnë në çka do që është e mundur dhe, natyrisht, të marrim një vendim të përbashkët me interes për këtë vend dhe për institucionet tona në zhvillim. Faleminderit!

KRYETARI: Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Privatizimi i PTK-së, edhe pse ka qenë një pjesë e debatit të gjerë, që u bë për një kohë të gjatë, për fat të keq po vazhdon edhe më tutje.

Ministria përgjegjëse nuk arriti ta transformojë autostradën virtuale në autostradë rrugore me paratë e shitjes së saj. PTK-ja nuk ka më vlera, ajo tashmë e shkriu dhjamin e vet. Vlera që ishte e parashikuar në vitin 2008, rreth një miliard euro, tash shkon në 277 milionë, me 35 milionë më pak.

Po të ishte privatizuar me kohë, Kosova me ato para do ta kishte tashmë të përfunduar autostradën Hani i Elezit - Prishtinë, bashkë me segmentin Ferizaj - Dheu i Bardhë. Tashmë jo vetëm që humbi kjo rrugë, por është në prag të falimentimit edhe vetë PTK-ja, e cila tash nuk ka asnjë vlerë. Ajo mbeti si 'çekërk' te niveli i dytë teknologjik dhe nuk u lejua për arsye të panjohura për mua të avancoj te niveli i tretë, derisa për këtë nivel ishin mundësitë tona, e bota ka avancuar te niveli i katërt teknologjik.

Kualiteti i shërbimeve e bën atë jokonkurrense dhe këtë kompani gjigante për fat të keq e pret gjendje shumë e keqe. Edhe po privatizohet tash kjo, për një afat prej dy vjetësh nuk do të arrin që ta shërojë këtë mangësi teknologjike dhe do të jetë shumë e rëndë që kjo të bëhet konkurrense për një afat shumë të shpejtë.

Më duhet ta theksoj faktin se këtë debat e ka iniciuar vetë Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Në të vërtetë as unë nuk e kuptoj pse. Sikur dëshiron që ta ndaj përgjegjësinë për këtë në njëfarë mënyre dështim për herë të dytë rreth privatizimit të PTK-së. Nuk kemi pse të hamendemi e të themi që kjo kompani nuk është më konkurrense. Kjo kompani duhet të rehabilitohet me qëllim që ta marrë rrugën e vet kah zgjidhja më e dëshiruar për të gjithë ne.

Siç jeni në dijeni, PTK-ja që nga fillimi ishte e ngulfatur për shkak të ndalimit të investimeve të kapitalit nga Ministria, me arsyetimin se po e privatizojnë. Kështu ajo u zhvlerësua si gjeneratë e dytë, siç e thashë. Tash ka mbetur te ky nivel. Më dua të them se kësaj gjendjeje i kanë kontribuar edhe bordet, të cilat kanë qenë të pakualifikuara e të cilat janë trajtuar. Njerëzit që kanë punuar në të e kanë trajtuar të qenët në bord si një vend punësimi, derisa në ato vende është kërkuar një kualifikim profesional për ta ndihmuar këtë kompani që të jetë konkurrense.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik dy herë me radhë nuk ka arritur që të tërheqë në privatizimin e PTK-së partnerë seriozë dhe strategjikë për këtë natyrë specifike të biznesit. Ajo që nga fillimi ka pasur qasje joserioze dhe jokreative. Për më keq, ajo nuk mësoj nga dështimi i parë, por përkundrazi e kamufloi atë edhe me dështimin e dytë, për të cilin ne sot duhet që të bëjmë debat.

Ne mund të votojmë si të duam, por këtë gjendje e kemi shumë të zorshme që ta rregullojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Për kohëzgjatje, sot ishte edhe në lajme privatizimi i Postës së Britanisë së Madhe 'Rojal Mel', por edhe atje kishte një lloj kundërshtimi nga punëtorët, mirëpo arsyeja e kësaj ishte se kjo do ta sigurojë një të ardhme të shëndetshme për kompaninë dhe nganjëherë është normale që të kundërshtohet, sepse hezitimi që i bëhet të jep të kuptosh se në Postë që nga kjo legjislaturë ne kemi kritikuar dhe formën e stimulimit të punonjësve. Punonjësit në Postë, përkatësisht një pastrues e ka pasur pagën më të madhe se sa një drejtor i Departamentit të Administratës Civile të Republikës së Kosovës.

Pavarësisht asaj se si kanë ndodhur të gjitha procedurat, qasjet me të cilat ne po i qasemi privatizimit në Kosovë dhe kërcënimit që i bëjmë me mesazhet publike dhe jopublike, jo vetëm investitori aktual, por asnjë investitor serioz nuk do ta inkurajojmë që të vijë në Kosovë, të menaxhojë dhe ta sfidojë konkurrencën në fushën e telekomunikacionit.

Ne e kemi një operator, i cili është duke u zgjeruar çdo ditë me teknologjinë dhe i cili është duke e shfrytëzuar edhe legjislacionin në fuqi për ta shtrirë edhe formën e zhvillimit 5 GJ dhe 4 GJ dhe prandaj kjo mënyrë e marrjes së tregut të jep të kuptosh se operatori privat IPKO, i cili është momentalisht duke u shtrirë, në një moment të caktuar do t'ia humbë vlerën komplet Telekomit të Kosovës dhe do t'i marrë mundësitë e tjera, të cilat në treg nuk do të gjenden.

Format e komunikimit që janë sot, dhe free communication, siç janë edhe Viber, e-mail e SKYPE dhe të gjitha tjera që në botë nuk po mund t'i taksojnë me forma të ndryshme, janë çdo herë duke ua humbur vlerën këtyre institucioneve, të cilat nuk kalojnë me ndonjë vlerë konvertibile. Shqetësimi tjetër është që opozita në Republikën e Kosovës nganjëherë për inat vetëm sa të flitet diçka, për shembull kryesuesi i Lidhjes Demokratike, tha 'ato lekë ne nuk do t'i lejojmë të futen në asfalt'. Nëse thuhet se lekët që janë futur në asfaltin e Republikës së Kosovës me këtë Qeveri nuk janë zhvillim ekonomik, atëherë kjo është shumë shqetësuese, është një mesazh shumë i keq për publikun që këta persona duan të na kthejnë të lëvizim me qe, jo me automjete, do të thotë në kohën para 200 vjetësh dhe me kuaj, prandaj mos janë në një formë të tillë të stagnimit, ose të refuzimit.

Ne e kemi ndërtuar një autostradë, e cila sot është krenari për gjithë ne dhe i ka dhënë formë dhe erë zhvillimore dhe moderne Republikës së Kosovës. Ne duhet ta ndërtojmë çdo ditë infrastrukturën e rrugëve, siç janë duke u ndërtuar edhe në shtetet tjera.

Kolegët tanë nga “Vetëvendosje” dërgojnë letër kërcënuese apo rrufe, me të cilën çdo investitor do të ishte i dyshuar dhe i kërcënuar se nesër do të ketë edhe atakime fizike me forma të sistemit të bombahedhësve, të cilët kërcënohen se ‘kur të vijmë ne në pushtet, me çdo formë ne do të ju largojmë ju’. Prandaj, këto forma dhe këto mesazhe që ne po i çojmë normalisht do t’i shqetësojnë të gjithë njerëzit.

Disa të pavarur që i dëgjojmë këtu në emër të “edukimit të lartë të ekonomisë” apo mësim si mësimdhënësi është për t’u shqetësuar, sepse mënyra e prononcimit të tyre kaotik dhe vetëm refuzues, pa udhëzim, është një shqetësim i cili nuk mund ta gjejë asnjë bazë përkrahëse.

U përmend këtu nga disa për privatizimin në rajon. Ne duhet të tregojmë hapur, në Republikën e Maqedonisë është privatizuar po ashtu me përqindje dhe Qeveria e Maqedonisë është detyruar që edhe atë përqindjen të cilën e ka mbajtur për disa vite ta largoj nga vetvetja, sepse vetë forma e legjislacionit në fuqi në administratën publike po jep mundësi të ndryshme të cilat janë abuzive dhe me mundësi të keqpërdorimit.

Prandaj, këto forma të cilat ne sot nuk po duam t’i realizojmë janë forma të cilat do të na hakmerren me një çmim, kur ndoshta në tezgat e Ulpianës po të dalë Posta nuk do t’ia japë askush asnjë lekë, sepse të gjithë ata punëtorë, të cilët po vendosen në lajthitje, nuk do të ketë asnjë investitor që t’i mbajë me atë formë të financimit, sa të zvarritet kjo formë duke u dhënë mundësi zhvillimeve teknologjike të operatorëve konkurrentë dhe të cilët në avancimin e teknologjisë së re nuk do të kenë kurrfarë vlere nesër si aset ekonomik për biznesmenët, të cilët mendojnë të privatizojnë.

Unë që nga fillimi e kam përkrahur privatizimin e Postës dhe jam përkrahës i privatizimit të saj, pa dashur të hyjë të komentoj se kush janë ata ose këta. Në Komisionin për Zhvillim Ekonomik e kemi pritur edhe ambasadorin e Britanisë së Madhe, ku së bashku me këshilltarët e ‘British Telekom’-it e kanë përshëndetur dhe i kanë inkurajuar që sa më shpejt të bëhet një privatizim i tillë, i cili do të jetë në frymën e zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Ne nuk kemi parë, përveç që hipotetikusht, mundësitë e paragjykimeve të cilat janë duke u dhënë. Është në detyrën e atyre të cilët i kanë obligimet ligjore edhe të hetojnë nëse ka keqpërdorime, por jo të paragjykojnë dhe të vihet në frenim situata e cila nuk është problem nëse këta do ta blejnë apo jo; ne a do ta votojmë apo jo, por është problem që ne po e çojmë një mesazh jashtëzakonisht dekurajues tek investitorët tjerë, të cilët për asete tjera në Kosovë ose për partnerizma tjerë, apo për forma të tjera të bashkëpunimit.

Prandaj, ne çdo herë do t’i dalim përballë edhe publikut, edhe do ta arsyetojmë pozitën tonë pse duhet ta refuzojmë, apo pse edhe duhet ta përkrahim. Sa më shpejt të realizohet privatizimi i Postës në Republikën e Kosovës, arkivat do të na mbajnë edhe me prononcime. Kurrë nuk do ta arrijë vlerën e ditës sotme Postë-Telekomi i Kosovës, ndërsa edhe Posta nesër a pasnesër do të jetë edhe ajo e lëkundur. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi e ka fjalën.

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Nuk do ta lexoj, por për kureshtjen tuaj dhe të opinionit dua të tregoj se kohë më parë blerësit e të gjitha bankave, ku kanë menduar që do të marrë kredi, ambasadave që ju i përmendët, Bashkimit Evropian ia kam dërguar një letër me 18 pika dhe secila pikë tregon për procesin e parregullt dhe të paligjshëm të privatizimit të Postë-Telekomit të Kosovës dhe këtë rikthim sa për të pastruar diçka të pistë e shoh tani vendimin e Komisionit qeveritar.

Shikuar realisht, tani kjo nuk është dashur të vijë në Kuvend. Nëse Qeveria dëshiron ta legjitimojë shitjen e Postë-Telekomit të Kosovës procesin duhet ta kthejë në pikën zero - duhet të merret vendimi këtu për t'u shitur.

Vendimi për t'u shitur nuk është marrë në Kuvendin e Kosovës. Kështu siç ka ardhur, ne tash veç ta legjitimojmë dhe të arsyetohemi para atyre që kanë kërkuar që ky proces ta ketë një legjitimitet. Kuvendi, ose duhet t'i ketë vendimet autonome, ose duhet ta ketë thënë fjalën e vet në kohën e duhur, por kësaj i thonë si 'kufini pas të vjelave'.

Pse Qeveria, kur e ka shitur Distribucionin nuk e ka sjellë vendimin nga Komisioni për ta legjitimuar atë vendim në Parlament? Kështu që kjo procedurë që po zhvillohet në Kuvendin tonë, edhe kështu siç ka ardhur ky dokument, absolutisht s'e ka pasur vendin, dhe dëshmon se ky proces, ose i tërë procesi, ka qenë jolegjitim.

Tash, ne e kemi një opozitë që doli nga pjesa më e madhe e saj, nga Kuvendi. Dhe mund të them që shumica, që e ka përgjegjësinë më të madhe për perspektivën e këtij vendi, është kundër.

Është një shumicë parlamentare, edhe ajo e diskutueshme në këtë proces, që dëshiron ta marrë këtë vendim të paligjshëm. Gjithnjë të paligjshëm, pasi gjithë procesi është i paligjshëm dhe ky vendim i sotëm nuk mund të jetë i ligjshëm.

Nuk dua të ndalem shumë, por dua të ndalem te arsyetimi pse duhet të shitet Posta. Pse nuk po e menaxhojnë mirë! Po ne, zonja dhe zotërinj deputetë, nuk po qeverisim mirë.

Hajt ta qesim një tender për ta shitur Qeverinë dhe të na vijë njerëz që dinë të qeverisin me këtë vend.

Më e nevojshme është që ne ta nxjerrim në shitje ose në tender qeverisjen e këtij vendi sesa pasurinë e këtij vendi, se së paku pasuria ruhet dhe një ditë e shfrytëzon ky popull. Kjo është pasuri publike, nuk është pasuri private e askujt. Dhe, nëse duhet shitet, duhet të shitet për interesin e publikut. Unë nuk shoh interes të publikut në këtë proces. Ato të holla që pretendohen të merren, ku do të shkojnë? S'e kemi të qartë kah do të shkojnë ato të holla? A do të hyjnë më shumë në xhepat e njerëzve, apo do të shkojnë në interes të

publikut? Këtu, realisht, praktika e deritashme ka treguar se mjetet publike dhe paraja publike vazhdon të keqpërdoret për çdo ditë.

Dhe, tash, ne si përfaqësues të qytetarëve duhet të legjitimojmë diçka që është e pa legjitimueshme. Do të thotë, nëse Qeveria e do legjitimitetin e Kuvendit duhet ta mbyllë këtë proces, se edhe ashtu është vonuar. Ne të gjithë e dimë se për një 2-3 vjet janë ndaluar dhe nuk është investuar në ngritjen e vlerës së Postë-Telekomit të Kosovës, kurse tash, pasi është shitur, investohet për t'ia ngritur vlerën. Dhe, me të drejtë Hyda shtoi: “Kush po shet dhe kush po blen në krejt këtë proces?”.

Sigurisht që asnjë përfaqësues këtu nuk e ka lehtë për ta lëshuar sallën, sepse ka ardhur për ta përfaqësuar vendin dhe popullin e vet. Po, pse po detyrohen këta njerëz ta lëshojnë sallën? Askush në Kosovë s'po lufton për komunizëm, as për socializëm. Të gjithë, bile shumica e partive politike, edhe kështu janë përcaktuar si të djathta. Do të thotë s'kanë lidhje me drejtësinë shoqërore apo sociale të shoqërisë njerëzore, e kjo dihet, nuk është e paditur. Por, pse vërtet ka shumë dyshime, ka shumë parregullsi dhe mbi të gjitha ky proces, duke e mbyllur fjalën time, është i paligjshëm, dhe si i tillë nuk është dashur të rikthehet në Kuvendin tonë.

Ata që duan ta marrin përgjegjësinë për të shitur le të shesin, por atë përgjegjësi të mos e ndajnë për ne, se ne nuk jemi dakord me këto procedura. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ka diskutues të tjerë. Me kë dëshiron replikë? Halit Krasniqi, replikë vetë me vete.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Unë u jam mirënjohës që ma dhatë fjalën, sepse këtë fjalë që e dëgjuam tash nga kryetari i nderuar, nga cilido deputetë po do ta dëgjonim, nuk do të mund të ishim indiferent. As Qeveria nuk do të duhej të ishte indiferente dhe do të duhej të reagonte dikush nga të pranishmit, edhe as të pranishmit deputetë këtu nuk do të mund të heshtnin. Por, edhe më tepër ngjall reagim fjala e kryetarit të nderuar të Kuvendit të Kosovës.

Ne jemi të sfiduar përditë në këtë foltore dhe përditë flaskohemi nga opinionin ynë në media, po aq më tepër e përjetojmë dhe aq më rëndë na vjen kur në këtë foltore goditemi edhe atakohemi kështu.

Unë për veten time, po të isha në Qeveri, do ta konceptoja ndryshe fjalën time dhe do ta bëja përnjëherë reagimin për ta sqaruar opinionin, jo për t'u ballafaquar me kryetarin e Kuvendit. Por, edhe për ta ndihmuar këtë proces dhe këtë votim, por edhe për të na ndihmuar neve këtu që jemi tani me vullnet që Kuvendi të performojë më ndryshe dhe për ta ndihmuar Qeverinë në vendimet e saj.

Unë nuk e dëgjova ndonjë apostrofim në fjalën time, por natyrisht që edhe po të mos flisja fare, vetëm mënyra e votimit, vetëm mënyra e qasjes sonë, gatishmëria për të kontribuar në punimet e këtij Kuvendit u atakua, por u atakuan edhe shumë vlera të këtij Kuvendi, edhe të neve gjithsecilit, veç e veç.

Prandaj, desha ta bëj një nënvizim që fjalën e kryetarit të Kuvendit, të kushës tim të dashur, e kam përjetuar në mënyrën time të veçantë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Debati ka mbaruar, prandaj unë jam i vetëdijshëm dhe nuk kërkoj fjalë. Por kërkoj vetëm për procedurë, meqë propozova, pasi ky debat ka qenë i mangët nga aspekti procedural, materiali që i është shpërndarë Komisionit, pas kërkesës së tij, ka ndikuar në vendimarrjen aty e nuk u është shpërndarë deputetëve, që për mua është arsye e mjaftueshme që të ndërpritej kjo seancë dhe të plotësohej.

Ky ishte propozimi im dhe s'do ta bëja se jemi mësuar që të mos jemi çikërrimtar e të gëlltitim. Është bërë praktikë që çka do të propozosh, ajo injorohet. Është një rregull parlamentare, deputeti ka të drejtë ta marr fjalën për procedurë, të propozojë, pastaj nëse voton apo jo Kuvendi është çështje tjetër. Por, nuk bën të injorohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj që sidoqoftë i kemi futur mocionet e grupeve parlamentare deri më tash, propozimet e deputetëve si kemi futur në votim asnjëherë gjatë seancës.

Megjithatë, ne nuk kemi kuorum për të votuar. Këtu është problemi. As për njërën çështje, as për çështjen tjetër. Prandaj, duhet ta shtyjme seancën për një ditë tjetër.

Atëherë unë propozoj, meqë i kemi edhe dy pika për votim, pasi as për ato nuk kemi kuorum, që ta shtyjme dhe Kryesia të vendosë se kur do ta mbajmë seancën dhe si do procedojmë. Ju lajmërojmë nëpërmjet shefave të grupeve parlamentare. Faleminderit! Mirupafshim!

* * *

Më 19 shtator 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 12 shtator

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zonja deputete,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 12 shtator 2013.

Ju kisha lutur të votojmë për praninë. Votojmë tash!

Butonin e kanë shtypur 56 deputetë, kurse realiteti në sallë është se të pranishëm janë 72 deputetë.

Fillojmë me pikat në vijim:

- Votimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së

Diskutimet për raportin e Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 12 shtator 2013, mirëpo në mungesë të kuorumit raporti nuk është proceduar për votim.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së.

Në mbledhje janë të pranishëm 72 deputetë.

(Ndërhyrje)

A dolën disa? Atëherë, sa deputetë janë tani të pranishëm? Në sallë janë 64 deputetë.

(Ndërhyrje)

Përsëri nuk ka kuorum për të votuar. Tani janë 56 deputetë.

Unë do ta jap një pauzë prej 30 minutash dhe i lus kryetarët e grupeve parlamentare që të bisedojnë, nëse mund të gjejnë rrugëzgjidhje apo marrëveshje kompromisi që gjatë procesit të votimit të jemi të gjithë në sallë. E drejta e të gjithëve është të votojmë për ose kundër. Pra, pas gjysmë ore do të vazhdojmë me seancën e mbetur në gjysmë. Domethënë, në orën 10:50 do të vazhdojmë seancën.

* * *

(Vazhdimi i seancës, pas pauzës.)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Ju kërkoj falje! Jam i detyruar vetëm të ju komunikoj që seanca shtyhet për në orën 12:00. Faleminderit!

* * *

(Vazhdimi i seancës, pas pauzës.)

KRYESUESI: Vazhdojmë me seancën. Dua të sqaroj diçka, para se të futemi në votim.

Skenari i seancës më ka ardhur se diskutimet janë shteruar. Nuk ka diskutime dhe unë s'mund t'ia marr fjalën dhe s'kam mund t'ia marrë fjalën askujt. Megjithatë, unë e kam respektuar, sepse këto janë rregulla dhe kështu kam vepruar.

Tani kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së po insiston ta marrë fjalën. Dhe, prapë po them, e drejta ime nuk është t'ia marr fjalën askujt, apo të mos ia jap fjalën në Parlament kur e kërkon, veçanërisht kur deputetët duan të shprehën për çështje të caktuara.

Prandaj, jam në situatë jo të këndshme, do ta quaja kështu.

(Reagime)

Unë jam tash duke folur! Mos bëni zhurmë, sepse absolutisht s'keni nevojë të reagoni. Unë po flas edhe për opinionin, edhe për ju. Dy palë rregullore nuk janë në Kuvend, është vetëm një. Unë po ia jap fjalën zotit Gjini dhe po e hap debatin për ata që duan të diskutojnë për këtë çështje, para se të hyjmë në votim. Faleminderit!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Sidoqoftë, situata nuk është e tillë që të mos diskutojmë. Po e shihni edhe vetë, është hera e tretë apo e katërt që dalim në pauzë për të njëjtën temë të rendit të ditës.

Ajo që duhet thënë këtu tepër qartë është se me gjithë faktin se herën e fundit ne kemi votuar kundër raportit të Qeverisë, duhet sqaruar se e kemi mbështetur procesin e privatizimit në parim, si Aleancë.

Është parim yni, qëndrim yni edhe ideologjik, edhe praktik. Sidoqoftë, mendojmë se është e palogjikshme që koalicioni qeverisës të mos i ketë 61 deputetë në sallë dhe të presë prej një partie në opozitë që ta bëjë kuorumin.

Mendoj se është e saktë kjo çfarë po ju them. Mendoj që duhet të kuptohet si e tillë. Aleanca nuk e ka në plan ta mbajë atë pjesë të kuorumit, të cilin nuk është në gjendje ta bëjë Qeveria me deputetët e vet.

Nëse i ka 61 deputetë Qeveria, Aleanca nuk do të jetë e pranishme në sallë. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ka tjerë të paraqitur. Unë e kisha lutur edhe kryetarin e Grupit Parlamentar, edhe Qeverinë, respektivisht kryeministrin që të deklarohen, edhe pse nuk ka kuorum për ta marrë mendimin e tyre, se çfarë duhet bërë më tutje lidhur me këtë çështje.

Meqë nuk dëshironi të deklaroheni dhe meqenëse nuk kemi kuorum, kjo pikë apo çështje shtyhet për t'u diskutuar në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit ditën e hënë, përveç nëse kryetari vendos ndryshe.

* * *

Më 26 shtator 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 12 dhe të vazhduar më 19 shtator

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 12 dhe 19 shtator 2013, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, fjalën e ka kërkuar deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministra, ministra, zëvendëskryeministër, deputetë,

Unë kam një çështje të Ligjit nga Komisioni që ne kemi shqyrtuar dhe të gjitha komisionet funksionale kanë shqyrtuar Ligjin për Inspektoratin, mjedisin në natyrë, ujëra dhe planifikim hapësinor dhe është një kohë e gjatë që mund të zgjatet kjo deri në mbledhjen e ardhshme. Prandaj, është e nevojshme që ky ligj të hyjë në lexim të dytë si pikë e rendit të ditës, pra vërejtje nga komisione tjera nuk kemi pasur, amendamentet i ka bërë Komisioni Funksional.

Prandaj, kërkoj që deputetët ta miratojnë si pikë të rendit të ditës këtë pjesë ose këtë projektligj dhe ta miratojmë se nevojat e Kosovës dhe nevojat që ky Inspektorat të jetë më i suksesshëm dhe i avancuar në rrethanat të cilat po kalojmë, na duhet neve ta miratojmë si ligj me prioritet.

Prandaj, kërkoj nga deputetët që ta përfshijmë si pikë të rendit të ditës edhe ta votojmë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe pse ne jemi në seancë për miratimin e ligjeve, nëse ekziston gatishmëria për ta shtuar këtë pikë të rendit të ditës Kuvendi, unë s'kam gjë kundër. Por, duhet një votim formal.

Janë të pranishëm 64 deputetë. Komisioni është dakord. Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, me të marrë informatën se është radhitur raporti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për shqyrtim, raporti vjetor, ka analizuar dhe ka ardhur në një vendim që t'i kërkojë seancës që të shtyhet për seancën e radhës në kuptimin që t'i bashkëngjiten tabelat e audituara.

T'ju njoftoj se për shkak të rrethanave që ka ndodhur atje, ne dy vjet më parë nuk kemi shqyrtuar raportet e kësaj Agjencie, prandaj është tepër e domosdoshme që t'i kem edhe tabelat e audituara me rastin e shqyrtimit të raportit vjetor.

Pra, kërkojmë që të hiqet nga rendi i ditës dhe të vihet në një mbledhje të radhës. Ky është mendimi i Komisionit dhe i lus grupet parlamentare që ta përkrahin. Në Komision janë pajtuar që të gjithë në mënyrë unanime.

KRYETARI: Mirë, atëherë i kemi dy mocione, njërin për ta hequr, tjetrin për ta shtyrë. Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Kryetar, sa i përket zotit Hasani, propozimi që është e vërtetë nuk di qysh voton kur se kemi materialin.

KRYETARI: Është shpërndarë!

ISMET BEQIRI: Nuk është futur në rend të ditës, kur është shpërndarë.

KRYETARI: Seanca është në vazhdim, ne i kemi krye dy pika të rendit të ditës dhe sa u përket pikave të tjera të rendit të ditës edhe mund të shtohen edhe mund të hiqet. Duhet të vendosë seanca, nuk vendosi unë, vendos seanca, po kemi të drejtë ta bëjmë këtë në seancë. Materialet janë. Edhe të gjithë anëtarët e Komisionit janë dakord, ne mendoj që i votojmë kërkesën e komisioneve përkatëse.

Shkojmë me një votim formal. Kush është për ta hequr pikën- Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012? Kush është për? Faleminderit! Kundër 1,2. Shumica absolute janë për, që të hiqet nga rendi i ditës. Pra, kjo pikë hiqet nga rendi i ditës.

Është kërkesë e kryetarit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural që të futet në shqyrtim të dytë Projektligji për inspektimi e mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Edhe këtu na duhet një votim formal. Kush është për? Faleminderit! Kundër, shumica absolute janë për. Mirë më falni me shumicë, po e tërheq fjalën. Me shumicë radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës.

Tash vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Formimi i Komisionit ad hoc për shqyrtimin e aplikacioneve lidhur me përzgjedhjen e anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 5 shtator 2013, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri më 12 shtator 2013, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Komisioni duhet të përbëhet prej 9 anëtarëve. Radha është e kryetarëve të grupeve për t'i përcaktuar emrat e kandidatëve.

Do të thotë Partia Demokratike i ka dy kandidatë. Fjalën e ka kryetari i Grupit, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, si anëtar të Komisionit i propozon Xhevahire Izmakun, si kryetare, ndërsa Ganimete Musliun, anëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lidhja Demokratike, kryetari i Grupit Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!
Ne propozojmë për anëtarë zonjën Lirije Kajtazi dhe zotin Armend Zemaj.

KRYETARI: Faleminderit! “Vetëvendosja”, një anëtar. E ka fjalën kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Nga “Vetëvendosja”, do të jetë deputeti Afrim Kasolli.

KRYETARI: Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën kryetari i Grupit Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!
Nga Grupi i Aleancës do të jetë Teuta Haxhiu.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Nga Koalicioni për Kosovë të Re, për Komision propozohet zonja Suzan Novobërdaliu.

KRYETARI: Faleminderit! Nga SLS-ja.

Saša Milosavljević: Hvala gospodine predsedniče!
Za ovu adhoc Komisiju mi predlažemo danas član bude Jelena Bontić.

KRYETARI: Nga “6+”, Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!
Grupi Parlamentar “6+” propozon deputetin Enis Kervan. Faleminderit!

KRYETARI: Një sqarim po e bëj. Sot për në Komision radhën e ka grupi i SLS-së, radhën e kaluar e ka pasur “Zajednička Budućnost”, kështu që i ndërrojnë vendet, sot është Grupi i SLS-së.

Na duhet një votim formal për këtë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Të pranishëm janë 71 deputetë dhe votojmë tash me votim elektronik.
Të pranishëm janë 69 deputetë, 57 vota për, një kundër, nuk janë bërë 61, por, megjithatë...

Ju lutem, a ka pa kartela? Një. Edhe një herë të shkojmë në votim.

Shtypni butonat. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatoj se Kuvendi me 68 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, emëroi Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës që të veprojë në përputhje me nenin 26.2.3 të Ligjit numër 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës.

Nëse jeni dakord, e kemi pikën e dytë dhe pikën e dhjetë, që duhet të votojmë me votim të fshehtë, t'i bëjmë bashkë dhe të votojmë përnjëherë. A jeni dakord? Kush është për? Faleminderit! A ka kundër? Shumica absolute mund të them ishte për.

2. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Kurse pika tjetër - dhjetë, që e bëmë bashkë, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar propozimin e Panelit të Bordit të Bankës Qendrore për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për zgjedhjen e njërit prej katër kandidatëve të propozuar.

Megjithatë, pasi kemi dy përzgjedhje na duhet një Komision, po për t'u bërë një Komision i përbashkët duhet pajtimi i deputetëve. A jeni dakord që për këto dy votime të jetë një komision i përbashkët? Kush është për? Faleminderit! A ka kundër? Nuk ka. Me shumicën absolute jemi dakord që ta kemi një Komision zgjedhor.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet formimi i një Komisioni votues në përbërje nga deputetë prej secilit grup parlamentar në mbështetje të zyrtarëve të administratës.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë anëtarët për këtë Komision. Radhën e ka Partia Demokratike e Kosovës, një anëtar, kryetari Adem Grabovci, e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, si anëtare të Komisionit propozon Xhevahire Izmakun.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar! Ne e propozojmë deputeten Afërdita Berisha-Shaqiri.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit të “Vetëvendosjes” Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Nga “Vetëvendosja” do të jetë deputeti Afrim Kasolli.

KRYETARI: Faleminderit! Nga AAK-ja, kryetari Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar! Do të jetë deputetja Teuta Haxhiu.

KRYETARI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar! Nga Koalicioni për Kosovë të Re do të shkon deputeti, Jeton Svirca.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi i SLS-së, Sasha e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!
SLS predlaže Jelenu Bontić.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi “6+”.

MUFERA SHINIK: Albert Kinolli.

KRYETARI: Grupi “Zajednička Budućnost”, Sasha Gjokiq e ka fjalën.

SAŠA DJOKIĆ: Hvala gospodine predsedniče!
“Zajednička Budućnost” predlaže kandidata Milivoje Stojanović.

KRYETARI: Faleminderit! Na duhet një votim formal i deputetëve.
Kush është për këtë Komision? Faleminderit!

Lus anëtarët e Komisionit që u zgjodhën t’i zënë vendet e tyre. Administrata e sjell materialin.

Për njoftim, të nderuar deputetë: Për anëtarë të Komisionit të pavarur kemi dy kandidatë, njëri prej tyre përzgjidhet. Këta janë Besim Zeqiri dhe Driton Qeriqi. Kurse për Bordin joekzekutiv të Bankës Qendrore për një vend i kemi katër kandidatë: Sejdi Rexhepi, Driton Balaj, Enver Krasniqi dhe Ramë Rexha.

Të kuptohemi, pasi kemi të bëjmë me një kandidat, nëse në votimin e parë dy kandidatë kanë më shumë vota, ata shkojnë, të tjerët bien. Domethënë kjo është procedura që duhet të ndiqet.

Fillojmë me votimin: Adem Grabovci, Afërdita Shaqiri-Berisha, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Syla, Bahri Thaçi; Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku; Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami; Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi, Imri Ahmeti, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi, Jasmina Zhivkoviq,

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi; Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Lutfi Haziri, Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Mursel Halili, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyçi, Sasha Millosavljeviq, Petar Miletiq, Rada Trajkoviq, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Asllanaj, Salih Morina, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanoviq, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todoroviq, Sreten Ivanoviq, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Valbona Dibra, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaqu, Xhevdet Neziraj dhe Zenun Pajaziti.

KRYESUESI: Zoti deputet,

E ftoj kryesuesen e Komisionit votues që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë raportin për rezultatin e votimit, së pari për një anëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media. Urdhëroni, ju lutem!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne kemi gjithsej 89 votime. Po fillojmë me numërimin. Pra, për anëtarin e KPM-së i kemi dy kandidatë.

Driton Qeriqi, E pavlefshme, Driton Qeriqi, E pavlefshme, E pavlefshme, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, E pavlefshme, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Besim Zeqiri, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, E pavlefshme, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, E pavlefshme,

Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, E pavlefshme, E pavlefshme, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, E pavlefshme, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Besim Zeqiri, Besim Zeqiri, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme, Besim Zeqiri, Besim Zeqiri, Besim Zeqiri, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, E pavlefshme, Driton Qeriqi, E pavlefshme, Besim Zeqiri, E pavlefshme, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, E pavlefshme, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, Driton Qeriqi, Besim Zeqiri, Driton Qeriqi, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme, Driton Qeriqi.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Urdhëro, kryetare e Komisionit!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në bazë të votimit që kemi përfunduar, i kemi këto rezultate.

Në bazë pra të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit numër 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se sot asnjëri nga kandidatët nuk i ka fituar votat e mjaftueshme që të jetë anëtar i Bordit të Komisionit të Pavarur për Media.

Pra, të dy kandidatët i kanë fituar këto vota.

Besim Zeqiri i ka fituar 27 vota, ndërsa Driton Qeriqi i ka fituar 43 vota.

Gjithashtu janë 19 votime të pavlefshme. Pra, vetëm për dy vota nuk kemi arritur numrin e mjaftueshëm që sot të zgjedhim një anëtar të KPM-së, kështu që konkursi duhet të përsëritet. Pra, gjithçka fillon nga fillimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Tash presim të fillojmë votimin për një anëtar të Bordit joekzekutiv të Bankës. Vetëm edhe të përsëris, në emër të kryesuesit, që në bazë të votimeve asnjëri nga kandidatët nuk është zgjedhur, pra duhet hapur konkurs i ri dhe unë po ju informoj që tashmë janë dy vende në këtë bord të zbrazëta, sepse ne e kemi në dorë në Kryesi një dorëheqje të Emrush Kastratit, që po i bie se konkursi duhet të hapet për 2, sepse është bërë odesiadë me këto zgjedhje të këtyre bordeve. Besoj që duhet të procedohet më shpejt. Urdhëro, vazhdo!

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Po fillojmë me numërimin e votave për zgjedhjen e një anëtari ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore.

Ramë Rexha, Driton Balaj, Ramë Rexha, Driton Balaj, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, E pavlefshme, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, E pavlefshme, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, E

pavlefshme, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Driton Balaj, Driton Balaj, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Driton Balaj, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Driton Balaj, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Driton Balaj, Sejdi Rexhepi, E pavlefshme, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Driton Balaj, E pavlefshme, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, E pavlefshme, Driton Balaj, E pavlefshme, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Driton Balaj, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Driton Balaj, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, E pavlefshme, Sejdi Rexhepi, E pavlefshme, Sejdi Rexhepi, Driton Balaj, Sejdi Rexhepi, Driton Balaj dhe, e fundit, Sejdi Rexhepi.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni votues, pas votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur me 26 shtator 2013, konstaton si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 89 deputetë. Të pavlefshme janë 10 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar, janë si në vijim:

Sejdi Rexhepi ka fituar 34 vota,

Driton Balaj ka fituar 13 vota,

Enver Krasniqi nuk e ka fituar asnjë votë, dhe

Ramë Rexha ka fituar 32 vota.

Komisioni konstaton se përsëritet rundi i dytë i votimit për dy kandidatët të cilët kanë fituar më shumë vota, pra për Sejdi Rexhepin dhe Ramë Rexhën.

(Ndërprerje e incizimit)

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

Të nderuar deputetë, anëtarët e Komisionit le t'i zënë vendet e tyre dhe vazhdojmë me votimin e dytë për anëtarin në Bordin joekzekutiv të Bankës Qendrore të Kosovës. Pra, lus që t'i zënë vendet anëtarët e Komisionit dhe vazhdojmë me votimin.

Adem Grabovci, Afërdita Shaqiri-Berisha, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Quni; Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj; Aurora Bakalli, Azem Sylja, Bahri Thaçi; Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat Buzhala; Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu; Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra; Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj; Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica; Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani; Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku; Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca; Flora

Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca; Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli; Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni; Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami; Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi; Imri Ahmeti, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi; Jasmina Zhivkoviç; Jelena Bontiq, Justina Pula; Kymete Bajraktari, Latif Gashi; Liburn Aliu, Lirije Kajtazi; Lumnije Morina; Lutfi Haziri, Lutfi Zharku, Fikrim Damka; Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik; Muhamet Mustafa, Mursel Halili, Myzejene Selmani; Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyçi; Sasha Milosavleviq, Petar Miletiq, Rada Trajkoviq; Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi; Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj; Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala; Sali Asllanaj, Salih Morina, Salihe Mustafa; Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanoviq; Sevdije Lama; Shaip Muja; Skender Hyseni, Boban Todoroviq, Sreten Ivanoviq, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova; Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri; Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani; Valbona Dibra, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku; Xhevdet Neziraj dhe Zenun Pajaziti.

Fjalën e ka raportuesja e Komisionit zgjedhor, deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU:

Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, E pavlefshme, E pavlefshme, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Ramë Rexha, E pavlefshme, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, E pavlefshme, Sejdi Rexhepi, E pavlefshme, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, E pavlefshme, (Jo veç e ka bërë, se s'është e pavlefshme), E pavlefshme, realisht s'është e pavlefshme... E pavlefshme, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, E pavlefshme, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, E pavlefshme, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, E pavlefshme, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Sejdi Rexhepi, Sejdi Rexhepi.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Komisionit zgjedhor.

TEUTA HAXHIU: Komisioni votues, pas votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 26 shtator 2013, konstaton si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 87 deputetë. Të pavlefshme ishin 12 fletëvotime. Votat e fituara për kandidatë të propozuar, janë si në vijim:

Sejdi Rexhepi i ka fituar 42 vota, Ramë Rexha i ka fituar 33 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, pra në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 38 pikë 2 të Ligjit numër 03/L-2009 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se asnjëri nga kandidatët nuk e ka fituar numrin e mjaftueshëm të votave për t'u zgjedhur anëtar i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës. Konkursi duhet të përsëritet. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe pse ligji e jep një lehtësi për zgjedhjen e këtyre anëtarëve me shumicën e votave të atyre që votojnë, që në fakt votat e fshehta do të duhej të kërkonin gjysmën e deputetëve, do të thotë 61 vota, megjithatë edhe me këtë lehtësim që është në ligj, asnjëri nga kandidatët për herë të dytë nuk i fiton votat e mjaftueshme për të qenë anëtar në Bordin joekzekutiv të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*